UNIVERSITETI I EVROPES JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЦНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY FACULTY OF

FAKULTETI I DREJTËSISË
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
LAW

STUDIME PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

TEZA:

NARKOMANIA, NDIKIMI I SAJ NË SHTIMIN E VEPRAVE PENALE DHE MUNDËSIA E PARANDALIMIT TË TYRE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

KANDIDATI :

Fatmir DAUTI

MENTORI:

Prof.Dr. Jeton SHASIVARI

Tetovë, 2018

PËRMBAJTJA

HYRJA……7

KAPITULLI I PARË……..9

KUPTIMI DHE LLOJET E DROGAVE……..9

1. CFARËËSHTË DROGA……...9

2. DROGAT DHE EFEKTET E TYRE……13

3. KLASIFIKIMI I DROGAVE……..14

3.1. DEPRESANTËT……16

3.2. OPIOIDET (DRGAT NARKOTIKE)……17

3.3. MORFINA……18

3.4. HEROINA……19

3.5. METAFORMINA……19

3.6. BARBITURAT……20

3.7.STIMULATOR NA CNS……20

3.7.1. AMFITAMINAT……20

3.7.2. EKSTAZA (MDA, MDMA)……20

3.8. KOKAINA……21

3.9. KREK……21

3.10. DROGAT (HALUCINACIOIDE)……22

3.10.1 LSD (LYSERGIC ACID DIETHYLEMIDE)……22

3.10.2. PHENCYCLIDIN PCP……22

3.10.3. MESKAN DHE PSYLOCIBIN……23

3.10.4. TATULA (DATURA STRAMINIUS)……23

3.11. KANABIS……..24

3.11.1 MARIHUANA……24

3.12. VOLANTINI (INHALACINE, NGJITËS)……24

3.13. STEREOIDE……25

KAPITULLI I DYTË……26

SHKAQET KRYESORE DHE FAKTORËT QË NDIKOJNË NË KONSUMIMIN E LËNDËVE NARKOTIKE DHE EFEKTET E PËRDORIMIT TË TYRE……26

1. ASPEKTI ETILOGJIK I KONSUMIMIT TË LËNDËVE NARKOTIKE……26

1.1. PËRDORIMI I DROGËS NË MESIN E POPULLATËS SË PËRGJITHSHME DHE TË RINJVE……28

2. TEORIA E FAKTORIT……30

3.FAKTORËT E JASHTËM QË NDIKOJNË NË KONSUMIMIN E LËNDËVE NARKOTIKE……31

3.1. KRIZAT EKONOMIKE DHE KRIMINALITETI……32

3.2. PAPUNËSIA DHE KRIMINALITETI……33

3.3. ARSIMIMI DHE KRIMINALITETI……36

3.4. FAMILJA DHE KRIMINALITETI……38

3.4.1. KARAKTERISTIKAT E FAMILJEVE NGA TË CILAT DALIN KEQPËRDORUESIT E LËNDËVE NARKOTIKE……40

4. FAKTORËT E BRENDSHËM QË NDIKOJNË NË KONSUMIMIN E LËNDËVE NARKOTIKE……41

4.1. KARAKTERI DHE KRIMINALITETI……42

4.2. INTELEGJENCA DHE KRIMINALITETI……43

4.3. MOTIVET SOCIALE……45

5. EFEKTET PERSONALE TEK VET PËRDORUESI I LËNDËVE NARKOTIKE ……48

5.1. PAMJA E JASHTME……48

5.2. ZËNKAT ME PRINDËRIT……49

5.3. NDËRPRERJA E SHKOLLËS……50

6. SIGURIA SHOQËRRE, ULJA E DËMEVE DHE SHKALLA E RREZIKSHMËRISË NGA PËRDORUESIT TË LËNDËVE NARKTOTIKE……51

6.1. EFIKASITETI I PROGRAMEVE PËR ULJEN E DËMEVE NGA PËRDORIMI I DROGËS……52

6.2. ARSYETIMI FINANCIAR……53

6.3. DROGA, VDEKSHMËRIA NË MESIN E PËRDORUESVE TË DROGËS SIPAS STATISTIKAVE ZYRTARE……53

KAPITULLI I TRETË……55

ROLI I ORGANEVE PPOLICORE, GJYQËSORE DHE INSTITUCIONEVE TË TJERA NË VLERSIMIN DHE PARANDALIMIN E VEPRAVE PENALE SI PASOJ E KONSUMIMIT TË LËNDËVE NARKOTIKE……55

1. ROLI I POLICISË SË MAQEDONISË NË VLERSIMIN DHE PARANDALIMIN E KRIMINALITETIT……55

2. OBJEKTIVAT DHE DETYRAT……56

1.3. GRUPET E ORGANIZUARA KRIMINALE……56

1.4. TREGTIMI I PALIGJSHËM I DROGËS……57

1.4.1. TREGU I HEROINËS……57

1.4.2. TREGU I KOKAINËS……57

1.4.3. TREGU I MARIHUANËS……58

1.5. HEROINA……58

1.6. GRUPET E ORGANIZUARA KRIMINALE……59

1.7. KOKAINA……60

1.8. KANABIS……62

2. MËNYRA E ORGANIZIMIT DHE STRUKTURA E POLICISË SË MAQEDONISË……65

3. ROLI I POLICISË NË INFORMIMIN DHE RISOCIALIZIMIN E PERSONAVVE VECANËRISHT TË RINJVE PËRDORUES TË LËNDËVE NARKOTIKE……68

3.1. DEFINICIONI I FJALIS, RIINTEGRIMI SOCIAL……68

3.2. MËNYRA OSE METODA E TRETMANIT TEK PERSONAT ME PROBLEME TË PËRDORIMIT TË LËNDËVE NARKOTIKE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË……70

4. BASHKËPUNIMI INSTITUCINAL I ORGANEVE NACIONALE ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE KUNDËR TRAFIKIMIT TË LËNDËVE NARKOTIKE……73

4.1. STRATEGJIA NACIONALE 2006-2012 DHE PLANI I VEPRIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË……73

4.2. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR……74

4.3. ZBATIMI I STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT……76

4.4. VLERSIMI I STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT……77

4.5. KOMISINI SHTETËROR NDËRMINISTROR……79

4.6. NJËSIT REGJIONALE……81

5. MJEKIMI DHE TRAJTIMI SHOQËROR I PERSONAVE, KONSUMUES TË LËNDËVE NARKOTIKE……82

5.1. RREGULLIMI LIGJOR PËR MJEKIMIN E PËRDORUESVE TË LËNDËVE NARKOTIKE DHE ANALIZA E DKUMENTAVE LIGJOR ME TË CILAT RREGULLOHET E DREJTA E MJEKTIMIT TË PERSONAVE TË VARUR NGA DROGA……82

5.2. E DREJTA PËR MJEKIM E PERSONAVE TË VARUR NGA DROGA……83

5.3. STRATEGJIA E REALIZIMIT……85

5.4. VENDI I TRAJTIMIT……85

5.5. LLOJET E TRAJTIMEVE……86

5.6. PËRFUNDIMI……88

KAPITULLI I KATËRT……90

VEPRA PENALE TË NARKOMANËVE SIPAS LEGJISLACINIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË……90

1. ANALIZË E PËRGJITHSHME……90

1.2. DILEMAT ETIKE DHE SOCIALE TË KRIMINALIZIMIT……92

2. PRODHIMI DHE SHITJA E NARKOTIKËVE DHE VËNJA NË QARKULLIM NË MËNYRË TË PAAUTORIZUAR SI FORMË E RËNDË E VEPRËS PENALE……93

3. BASHKËPUNIMI I TË AKUZUARIT APO TË DYSHUARIT SIPAS KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË……95

4. KLASIFIKIMI DHE KONTROLLIMI I DROGAVE NARKOTIKE, SUBSTANCAVE PSIKOTROPE DHE SUBSTANCAVE BIMORE……96

KONKLUZIONET……98

Hyrja

Janë më teper arsyet se pse pikërisht është kjo tema qe kam zgjedhur për ta punuar. Gjatë punimit të kësaj teme do të mundohem qe të sjell faktorët kryesor që sjellin deri tek prodhimi dhe përdorimii substancave narkotike kryesisht nga moshat e reja, dhe ndikimii këtyre substancave në shtimin e veprave penale. Përvec trajtimit të veprave penale qe janë si rezultat i përdorimit të substancave narkotike një rendësi të vecant do ti jepet dhe aspektit moral, familjar dhe etik si tri kontigjent kryesor në jetën e cdo njeriu dhe në shoqëri si tërësi, qe preken domosdorisht gjatë sjelljeve të shfaqura nga ana e përdoruesve të substancave narkotike. Pjesë tjetër me rëndësi të këtij punimi shkencor do të jetë mundësia dhe format që mund të ndihmojnë në parandalimin e veprave penale qe kanë si burim përdorimin e substancave narkotike, trajtimi adekuat të përdoruesve si dhe nivelii profesionalizmit iorganeve kompetente që merren me këtëproblematik. Duke u ndikuar nga këta faktorë si dhe rrezikimii sigurisë së shoqerisë që po i ndodh për cdo ditë dhe më shumë në Republikën e Maqedonisë , do të mundohem që me anë të këtij punimi shkencor të ndihmoj sadopak në sensibilizimin e shoqërisë pse jo dhe në rritjen e vigjilencës dhe profesionalizmit tëorganeve që merren me parandalimin , ndjekjen dhe dënimin e veprave penale që janë si rezultat i substancave narkotike.Problemet e mprehta sociale u bënë shkak që nga viti në vit abuzimi me drogën po rritej me ritme të larta duke u shëndrruar dalëngadal në një fenomen mjaft shqetësues për njeriun dhe vetë shoqërinë. Filluan të zbuloheshin dhe prodhoheshin nga drogat klasike nënprodukte të tyre me efekt veprues shumë të fortë dhe rrjedhimisht mjaft të dëmshëm për shëndetin e njeriut si : morfina, heroina , kokaina etj. Në këtë situate e cila po degradonte nga dita në ditë disa shtete të ndryshme filluan të mernin masa ligjore duke parashikuar në ligj si vepra penale të gjitha veprimet qe kishin të bënin me kultivimin, prodhimin, transportimin,shitjen, përdorimin e drogave të ndryshme. Por përseri kjo nuk qoinë parandalimin e këtij fenomeni megjithëse parashikoheshin në legjislacionet përkatëse vepra të ndryshme penale[1].Si rezultat i gjithë kësaj që përmendëm më lartë Organizmat Ndërkombëtare

[1]Ban.H '' Ekzektuimi i Vendimeve Penale me Burgim '' Tribunë Jurikde viti 2004, Tiranë, nr 46,fq.58

nënshkruan marrveshje në këtësektor u bënë mjaft shqetësuese.[2] Organizata e Kombeve të Bashkuara që nga data 26 qershor 1988 e ka cilësuar këtë datë si Ditën Ndërkombëtare të luftës kundër përdorimit dhe shpërndarjes së drogës. Në një takim special të OKB në shkurt të vitit 1990 dekada e fundit e këtij shekulli u shpall ''Dekada e Luftës kundër Drogës''.

Duke parë dinamikën e përhapjes së një dukurie kriminale mjaft të dëmshme e cila quhet DROGË problemtaikat që solli ky fenomen jo vetem në aspektin mjekësor e social por edhe në aspektin juridik kanë bërë që të tërhiqet vëmendja edhe e juristëve dhe të opinionit për të luftuar dhe parandaluar atë, në të gjitha format e mundëshme, në mënyrë të organizuar.Njerëzit që abuzojnë me drogën përvecse dëmtojnë rëndë shëndetin e tyre ata shëndrrohen në persona asocial, duke qënë kontigjenti shoqëror më prirur pë të kryer krime të ndryshme.Përzgjedhja e kësaj teme ka marrë shtysë nga problemtaikat e shtimit të veprave penale dhe problemet e shumta që dalin si shkak i këtij fenomeni. Punimi trajton problemtaikat e shumta të shkaktuara nga përhapja e veprave penale në fushën e drogës apo narkomanisë midis të cilave një vend të rëndësishëm zë edhe trafikimi ,importimi tregtimi, eksportimii substancave narkotike dhe psikotrope , trjatimii tyre jo vetem sipas legjislacionit, por duke u munduar të analizojmë shkaqet apo faktorët si ato të jashtëm dhe atë të brendshëm , ndikimii shoqëris statusi ekonomik dhe ai social etj. Dukuria e trafikut të drogës në realitetin e shoqëris së R.Maqedonisëështë demonstruar në mënyra të ndryshme edhe nga krimii organizuar. Ky punim mund të jete një kontribut në fushën e mundësisë për ti analizuar drogat e ndryshme, arsyet përse ato konsumohen, cilat janë pasojat që ato mbartin me vete , sa janë organet kompetente të afta për ta parandaluar këtë fenomen, sa ndikon përdorimii substancave narkotike në shtimin e verave penale në R.Maqedonisë me theks të vecant në komunën ë Strugës.

[2] Nushi.S ''Mbrojtja me Avokat e Personit gjatë Kohës së Shoqërimit , Ndalimit ose Arrestimin në Flagrancë'', Tribunë Juridike,viti 2004, Tiranë nr.46, fq.51.

KAPITULLI I PARË

KUPTIMI DHE LLOJET E DROGAVE

1.Cfarëështë droga

„Shitësite drogave jetojnë duke shitur vdekjen, ndërsa narkomanët prej tyre blejnë vdekjen“

Termi narkomani rrjedh nga fjala greke „narko“ që dmth dehem dhe „mania“ që dmth tërbim me të cilën shprehen epshet për kënaqësi, dëfrim etj. Me drogë nënkuptojmë mjete natyrore me preardhje bimore të cilat veprojnë në sistemin nervor vegjetativ dhe autonom që shkakton ndryshime në përjetimet tona emocionale. Para se të përshkruajnë ndikimin e drogave të vecanta në vetëdije, është e nevojshme të theksojmë se ai ndikim nuk është gjithnjë i njëjtë. Veprimii një droge varet nga personalitetii cili e merr, nga konstitucioni fizik dhe gjendja e shëndetit, nga disponimi momental, nga dituria dhe shpresa lidhur me ndikimin e drogës nga situata sociale. E njëjta drogë mund të krijoj efekte të këndshme te një individ, ndërsa efekt jo të këndshëm tekpersoni tjeter. Madje edhe tek i njëjti efektet mund të jenë të ndryshme , varëisht nga faktorët e përmendur.

Drogat janë përdorur që në lashtësi . Duke filluar që në prehistori, njerzit kanë pëerdorur disa ekstrakte bimore për shkak tëefekteve eksituese apo qetësuese të tyre. Në lindjen e Afërme konsumohej hashashi, në Greqi opiumi, në Kinë marihuana, dhe bima Koka në Amrikën Jugore. Konsumimi mëi hershëm i lëndëve narkotike është lidhur me ritet fetare, por më pas u përdor edhe pë të përballuar mundimet e mëdha fizike si urinë dhe vështirsitë e jetesës. Droga është konsumuar gjatë historisë dhe anembanë botës. Deri në shekullin e XIX në perëndimdrogat nuk kishin përhapje të gjëre, ishin të rrallë njerëzit që përdorin narkotikë. Në këtë kohë dominonte alkoholi dhe duhani më pak lëndët narkotike qëishin të destinuar për rrethet intelektuale. Deri në fund të shekullit XIX nuk kishte asnjë kufizim ligjor pë tregtimin e narkotikëve, gjithcka bëhej legale. Në këtë shekull filloi edhe prodhimi sintetik i drogave. Kimistët u interesuan për përbërjen e narkotikëve, duke arritur sintetizmin dhe më pas fabrikimin e substancave të tjera

të këtij lloji. Këto u emërtuan me fjalen 'Droge' term ky, që në mesjetë nënkuptonte produkte me efekte dëmtuese[3]

Sot në botën bashkohore narkomanët, që janë të varuar më së shumti furnizohen me heroinë , kokainë , marihuanë, LSD dhe llojet të tjera narkotikësh.[4] Të gjitha Drogat dehëseose pijet narkotike, për nga origjina mund të jenë : **natyrore dhe sintetike.**[5]Natyrore janë ato droga dhe pije narkotike që gjenden në natyrë, kultivohen dhe rriten në natyrë, ndërsa drogat dehëse apo pije narkotike sintetike janë ato narkotike të cilat nxirren nga lëndët të ndryshme e jo nga natyra.Krahas drogave të pastra, drogat sintetike kanë marrë një rritje të madhe vecanërisht në vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore. Kjo përhapje është kushtëzuar deri në farë mase nga nivelet e ulëta të zhvillimi të këtyre vendeve dhe për rrjedhoj të pamundësis së njerëzve për të bler dhe konsumuar drogatë pastra, cmimii të cilave është shumë mëi lartë. Lidhur me sasinë e drogave që qarkullojnë në vendet e ndryshme është e vështirë të jepen shifra. Për trafikun e drogës sot flitet në bazë të sasisë së drogës së kapur nga auto. Krahas importeve të drogave, sot shumë vende përballen me fenomenin e kultivimit të drogave ne vendet përkatëse sidomos të Kanabisit. Në vende të ndryshme të Evropës ka një tendencë rritjeje të kultivimit të kanabisit , ndërkohë që ndër prodhuesit kryesor të saj në Evrope janë Spanja , Hollanda së fundmi në këtë list ka hyr dhe Shqipëria[6]. Përmendja e Shqipërisë nëpër raportet ndërkombëtare sa i përket prodhimit dhe eksportit të Kanabisti në mënyrë të drejtpërdrejt kërcënon dhe Maqedonin nga vetë faktii pozitës gjeografike, dhe kjo nuk është vetem një tëori por dhe fakt i vërtetuar dhe me shifra që do mund të shihen në vazhdim. Konstatimii përgjitshëm është se përdorimii drogave është një problem shumë serioz dhëi komplikuar. Edhe perkrah numrit të madh të multikulturalizmit, dhe niveleve sociale të ndryshme të rinjtë në të gjithë botën kanë më pak ose më shumëinteresa të përbashkëta , me këtë arrihet dhe qasja deri tek informacionet e ndryshme a me këtë dhe qasja deri tek drogat e ndryshme. Gjatë shk XX u përhap sistemii globalizmit i kontrollimit kundër keqpërdorimit të drogave në botë, nëpërmjet miratimit apo ratifkimit të ligjeve të ndryshme ndërkombëtare kundër trafikimit dhe konsumimit të lëndëve të

[3]Elezi.A''Droga , nje sfidë intelegjence aspektet penalo juridike''Viti, 2012 , Tiranë, fq.14.
[4] Hysi.V" Kriminlogjia" , Viti, 2006, Tiranë fq. 145.
[5] Halili.R,"Kriminlogjia",Viti,2002, Prishtinë, fq.47.
[6]Latifi.V "Kriminalistika" Viti 2009, Prishtinë, fq,215.

ndryshme narkotike.Sipas një anketë e realizuar mbi popullsinë e përgjithshme në SHBA përafërsisht 2.5 milion persona nga të cilët 1.3 % në moshën 12 vjecare, kanë përdorur Heroin të paktën njëher në jetë. Sipas disa burimeve të tjera 2.3 milion Amerikan nga ku 1% e popullsis së rritur janë tëvarur nga substancat narkotike dhe kanë nevoj për mjekim .

Dhe ne Evropë anketimii popullsis së përgjithshme në disa vende i japin të njëjtat shifra : përafërsisht 1% e popullsis së përgjithshme, ose dicka më pak , të paktën njëher në jetë kanë përdorur Heroin, koncentrim më të madh ka ne qendrat e qyteteve më të mëdha. Në bazë të të dhënave paraprake parashikimet e programit për Kontrollim të Drogës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara përafërsisht 3.1% nga popullsia botërore në vjet ose 185 milion njerëz përdorin droga jo legale. Megjithatë , parashikimiet jo oficiale ky numër mund të jetë mbi 4.1 % e popullsis së botës ose 246 milion njerëz në botë që përdorin substance narkotike të paktën njëher ne vjet, kjo shifër është përafërsisht sa e gjithë popullsia e SHBA-ve. Përdorimii drogave reflekton negativisht në jeten individuale, sociale , kultrurore, dhe atë profesinale me pasoja të rënda ndonjëher dhe të pa riparueshme. Me pasoja më serioze të kësaj problematike përballen më shumë ato shtete ti cilët janë në zhvillim e sipër , ku problemet të tjera bëjnë që të neglizhohen jeta shëndetësore dhe sociale e shoqëris përkatese posacërisht moshës së re. Shtetet në tranzicion ose shtetet e Evropës Lindore ku bën pjes dhe Maqedonia janë shtete më të prekura nga kjo problemtaik. Në botë poashtu dhe në Maqedonidroga më e përdorur ose më shume e kunsumueshme është Kanbisi. Mirëpo shikuar nga aspekti shëndetsor, social dhe shoqëror për shoqerinë tonë Heroina është droga e cila rrezikon më shumë për arsye dhe te viruseve lehtësisht të transmetueshme si psh SIDA . Rreth 5.3 Milion persona në botë përdorues të rregullt të drogës nga ato 200.000 prej tyre përfundojnë me vdekje si pasoj e përdorimit të drogës dhe komplikimeve që janë si rezultat i saj.

Problematika e keqpërdorimit të drogës për herë të parë në Maqedoni do të shfaqet në vitet e fundit të shk XX kur dhe kanë filluar mjekimet e para të personave përdorues të drogave të ndryshme. Në vazhdim numrii tyre rritej në kontuinitet ku arriti shifrat alarmante në vitin 1995 ku nga organizata ndërkombëtare ju dha dhe epiteti si “ Epidemija e Heroinës”. Në mungesëtënjë regjistri shtetëror të drogave, substancat e përdorura apo keqpërdorura janë

vërtetuar në bazë të të dhënave që ka pasuar MPB.Sipas regjistrit Nacional pranë MPB personat e parë si përdorues të drogë në Republikën e Maqedonisë janë regjistruar në 1969. Në periudhën prej 1990-2004 numri u rrit nga 314 në 6583 ku më shumë janë përdorues të Kanabisit 3621 persona, Heroin 2538 persona dhe droga të tjera. Sipas të njëjtit burim banorët e qyteti të Shkupit janë në numër më të madh si përdorues dhe atë 3364, Kumanovë 649, Strumicë 343, Manastir 322, Strugë 248 etj. Në Maqedoni, në vitin 1998 tëregjistruar janë 9 raste ndërsa në vitin 2000,20 raste me vdekje për arsye të përdorimit dhe mbidozimit me Heroin. Duke u bazuar në shifrat e lartë përmendura dhe sipas analizës që bëjnëinstitucionet përkatëse del që në Maqedoni persona përdorues të lëndëve narkotike janë 20.000-30.000 persona, nga ku 6000-8000 persona janë me probleme të rënda shëndetsore nga përdorimii Heroinës. Sipas UNDCP (ProgramitInternacional i Kombeve të Bashkuara për Kontrollimin e Drogës):

TABELA 1 :

Vlersimii numrit të përgjithshëm që përdorin ose më saktë keqpërdorin droga ose substanca të ndryshme narkotike ne botë gjatë dekadës së fundit të shk XX[7] .

Përdorues të drogës të paktën njëherë në 12 muajt e fundit		
Llojii Drogës	Shuma	Përqindja e popullsis së përgjithshme
Heroin dhe narkotik të tjerë	8Milion	0.14%
Kokain	13.3Milion	0.23%
Kanabis (Marihuana)	141.2 Milion	2.24%
Halucinacine	25.2 Milion	0.44%
Stimulant nga Amfetamina	30.2 Milion	0.52%

[7]Dr.Gajdasic-Knezhevic Slavica, Acc.dr. Ignjatova Liljana,Paqoska Natka, „ Tretmani dhe parandaliimi i dëmeve nga keqpërdorimi i drogave“ Viti,2005, Shkup fq.7

2. Drogat dhe Efekte e tyre

Vlersohet se 1 në 20 të rritur , ose një e katërta e një miliardi në mes të moshës 15 dhe 64 vjec, kanë përdorur të paktën një medikament në vit. Ky numër është gati Ekuivalent me banorët e këtyre shteteve Francë,Gjermanisë,Italisë dhe Anglisë edhe pse numri duket jashtzakonisht i lartë ky numër nuk duket në rritje. Diku 29 milion njerëz të cilët përdorin drogë vlersoet të vuajnë me crregullime të mëdha shëndetsore si fizike ashtu dhe psiqike, 12 Milion nga ky numër janë njerëz që injektojnë droga nga të cilët 14% prej tyrë rezultojn me HIV . Përafërisht 207.400 vdekje janë të lidhura drejpërdrejte me drogën në vitin 2014 , kjo shifër korrespondon me 43.5% të vdekjeve për një milion njerëz të moshës 15-64 vjec. Numri i vdekjeve të lidhura me drogën në të gjithë botën ka mbetur i qëndrueshëm edhe pse kjo shifër është e papranueshmë . Vdekjet nga Overdose kontribojnë me një të tretën e numrit të përgjithshëm. Periudha kohore menjëher pas lirmit nga burgu rrit rrezikun e vdekjes nga shkaqe të lidhura me drogën (kryesisht si rezultat i mbidozës të drogës), kjo lloj vdekje është më e larta si shifër nga mënyrat e tjera. Në shumë vende, burgjet mbeten një mjedis me rrezik të lartë të sëmundjeve injektive , problem ky që është mjaftë serioz sa i përket shëndetit në burg. Një numër studimesh raportojnë nivele të larta të përdorimit të drogës në burgje, duke përfshirë përdorimin e opiateve dhe përdorimit injektues. Pavarsisht nga rrezikshmëria e këtyre mjediseve janë bërë prova shkencore në lidhje me parandalimin e këtij fenomeni përsëri ka boshllëqe të cilat pamundësojnë apo pengojnë mbarvajtjen e të gjithë procesin parandalues. Kanabisi mbetet droga më e përdorur apo e keqpërdorurnë nivel global ,ndërsa amfetamina mbetet e dyta. Rreth 33 Milion përdorues të opiateve dhe ndërsa opiatet me recetë janë më pak të përdorura, por Opiodi mbetet droga kryesore për sa i përket dëmeve shëndetsore.

GRAFIKONI 1:

Trendet globale të përdorimit të drogës ne botë 2010-2016[8]



Përdorimi i drejtë dhe për qëllime mjekësore i pijeve narkotike mund të jënë dhe janë ilac, ndërkaq përdorimi jo mjeksor shkakton sëmundjen e varësisë narkomaniane (varsëisht nga përdorimi i drejtë ose jo i drejtë pijet narkotike mund të jenë ilac se helm[9]) ku disa persona janë të prirur të përdorin vazhdimisht narkotikët, me pasoja të rënda për shëndetin dhe për sjelljen e njeriut në shoqërinë normale.

3. Klasifikimi i drogave

Egzistojnë disa definicione në lidhje me atë se cka është Droga:

Drogat të cilat paraqesin rrezikshmëri janë ato droga të cilat kanë aftësi të hynë në interaksionin e organizmave të gjalle, duke paraqitur varësi psiqike ,fizike ose të dyja bashkë[10] .

[8] United Nations Office and Drugs and Crime, "World Drug Report" , Viti 2016, New York fq. 11
[9] Ikonomi.V "Biometria si Metodë Identifikimi", Tribunë Juridike viti 2005, Tiranë nr .55, fq.53.
[10] Definicioni sipas Oganizatës Botërore të Shëndetësis, Zhenevë 1974.

Drogë është cdo substancë me preardhje bimore ose sintetike , ku me përdorimin e tye mund të paraqiten forma të varësis, të cilat mund të paraqesin përkeqësim të shëndetit ose në një mënyr tjetër ta rrezikojnë integrtetit e personit në aspektin fizik, psiqik apo social.

Drogë është cdo substancë me preardhje bimore ose sintetike e cila kur do të konsumhet organizmit mund ti ndryshoe një ose më shumë funksione , dhe nësë ndryshimi do të përsëritet atëher mund të krijohet varësi fizike apo psiqike.

Ndarja e drogave është e mundur në më shumë mënyra, por mënyra më edukative dhe adekute është ndarja sipas pasojave psikofarmaceutike ndaj sistemit qëndror nervor(SQN) , sipas të cilit drogat ndahen në :

1. Depresant të SQN:
    a) ALKOHOLI
    b) OPIUMI dhe derivatet e tij (drogat narkotike)
    c) SEDATIV dhe HIPNOTIZUES

2. STIMULATOR TË SQN (psikostimulant)
    a) AMFETAMINA (benzedrin,deksedrin,metedrin), përfshir dhe grupn e drogave EKSTAZAVE si (MCDMA,MDA,MDE etj)
    b) KOKAINA dhe KREK
    c) KHAT (nga bima Catha edulis)
    d) KFEIN
    e) EFEDRIN
    f) NIKOTIN

3. DROGA HALUCINACIONISTE
    a) LSD
    b) MESKALIN (kaktus PEYOTE)
    c) PSILOCIBIN (këpurdha PSILOCYBA)
    d) FENILCIKLIDIN /pluhuri engjëll

e) TATULA (Datura stramonium)

4. KANABIS (substance asktive të fitura nga Cannabis sativa)
   a) MARIHUANA (përfitohet nga gjethet e bimës femërore)
   b) HASHASH (përfithet nga lulet e bimës)

5. SUBSTANCA TË PËRZIERA
   a) NGJITËS
   b) AEROSOLI
   c) SHPËRNDARËS
   d) BENZINA
   e) BUTAN
   f) NGJYRA
   g) LLAQE

6. STEREOIDE
   a) DIANABAL
   B) NANDROLON
   c) PROVIRON
   d) TESTOSERON etj.

3.1.Depresantët

3.2. Opioidet (DROGAT narkotike) :

Opioidet bëjnëpjesë në grupin e substancave psikoatkive e cila përfitohet nga bima afin e quajtur (PAPVER somniferum). Opiumi është në gjendje të lëngët në ngjashmëri me qumështin e cila përfitohet nga afini e cila përmban përafërsisht 25 allkaloide ndër të tjera : morfin 10%, kodein 0.5%, narcein etj. Në Maqedoni kultivohet një ndër afionet më kualitativ , me 17% morfin ne ekstraktin e opiumit. Emërtimi „opium“gjithashtu përdoret edhe për drogat gjysëm sintetike si droga Heroin e cila prodhohet nga përbërësit e afionit. Opioidet janë substanca të cilat krijojnë varësi me

anëtë efekteve të cilat realizohen pas aktivizimit të receptorëve opiodit në tru. Opioidet konsumohen me anë të gëlltitjes, tërheqjes me hundë, me injektim ose me anë të frymëmarrjes duke thithur tymin qe del pas djegjes së tyre.

Karakteristikat kryesore:

Të gjitha drogat Opioide përmbajnë:

- Efekt të fuqishëm dhe te menjëhershëm kundër dhimbjeve
- Aftësi pë krijimin e tolerancës, varësin fizike dhe psiqike

Potenciali për formimin e varësis është në propocin të barabartë me qetësimin e dhimbjeve. Efekti kryesor dhe farmaceutik është ndikimi i opiadeve në qetsimin e dhimbjeve , efekti është depresiv, euforija është prezente por e papërfillshme. Në aspektin psiqik opiadet i reduktojnë nevojat primare (urin, nevojën seksuale), qetësojnë dhimbjen dhe rëndesat fizike.

3.3.MORFIN

Morfina është alkaloid natyral tek afioni.Në Maqedoni prodhohet një ndër afionët më kualitativ, me 17% morfin.Përfitohet me prerjen e gotës së afionit dhe mblidhet.Gjatë përpunimit kalon në formë pluhuri si Kristal e cila shumë vështir shkrihet ose përhapet në ujë ose alkohol.Në organizëm mund të kaloj nëpërmjet gëlltitjes, thithjes ose me injektim. Në mjeksi përdoret në formë të ampulave si ilac shumë i fortë kundër dhimbjeve të ndryshme, përdoret më shumë tek personat me sëmundje malinje , trauma etj.

Efekti- në fillim shkakton eufori e cila më vonë kalon në relaksim dhe qetsim të dëshiruar , munges të brengave , humbja e ndjenjës së frikës, ndjenjë sigurie dhe padhembshurie, zvoglohet koncentrimi , ngadal shuhet dhe vullneti për të qënë aktiv. Për arsye se ka potencial të madh për të shkaktuar varësi fiziko-psiqike , rekomandohet shumë rrall dhe me një kontroll shumë të rrept nëpërputhshmëri me rregulloren e vecantë ligjore.

3.4.Heroina

Heroina është derivat gjysëm sintetik i morfinës. Për herë të parë është prodhuar në Gjermani në v 1898 dhe është përdorur nëpër spitale për shërimin e kollës dhe dhimbjes. Heroina ka efekt më të madh deri më 25 her më shumë se morfina dhe është dy her me shpejtë për krijimin e varësis. Keqpërdorimi i saj sjell deri tek varësia shumë e rrezikshme psiko-fizike, për vetem disa ditë.Është në formë pluhuri i bardhë më i pastër, dhe me efekt më të fort.

Konsumimi: Heroina mund të knsumohet me anë tëcigarës ku në vend të duhanit vendoset heroinë , me thithje nëpërmjet hundës, me thithjen e tymit pasi digjet heroin , dhe me injektim nëpërmjet ineksimit. Pas konsumimit në organizëm heroina ka efekt vetem 4 deri më 6 or , periudhë kohore ku ndryshojnë fazat e efektit dhe atë:

Faza 1: Efekti apo momenti iashtuquajturi ”HIGH” është faza ku është maksimumi i efektit ose më saktë pirja totale kjo fazë është aktive menjëherë pas konsumimit të dozës me Heroin e cila zgjat 10-15 min, si shenja dalluese jane relaksine të ngadalsuara , mos ndierja e dhimbjes, ngrirja ose STOUN .

Faza 2: Është momenti i koncentrimit psiqik ose rikthimi në “normalitet”, ku personi i cili ka marrë Heroinë nuk dallohet nga persona të tjerë, vecanërisht kjo fazë ndodh tek personat të cilët një kohëtë gjatë janë përdorues të rregullt, kjo fazë zgjat 3 deri më 6 orë.

Faza 3: Është momenti ku ka mbaruar efekti i heroinës në trup dhe organizëm ku paraqitet e ashtuquajtura KRIZA. Aktivizohet pas 8 deri 12 orë nga konsumimi i dozës me Heroin me shenja të : jo i disponuar, nervoz, mungesa e tolerancës, frustrimi,rrjedhje nga hundët, lëvizje të pakontrolluara të disa muskujve, dhimbje të shpinës,rritje të temperaturës,vjellje. Kulminacioni i pasojave të lartëpermendura është 36 deri 48 orë ndërsa ndalesa e pasojave pritet pas 7 deri 15 ditëve.

3.5.METADON

Metadoni është opioid , narkotik sintetik shumë i fuqishëm analgetik, prodhuar për herë të parë në Gjermani në kohën e luftës së dytë Botërore, për dallim nga Morfina dhe Heroina Metadoni ka efekt më të gjatë përafërsisht 24 deri 72 orë. Prodhohet ne kompani të specializura farmaceutike, në formën e tabletave, pika dhe kapsula.Mund të konsumohet me gëlltitje ose me injektim.Mund të përdoret (vetëm në mënyrë dhe doza të udhëzura nga mjeku).Përdorimi i vazhdueshëm mund të krijoj varësi psiko-fizike.Përdoret ne spitale kundër dhimbjes dhe për rehabilitimin e personave konsumues të drogave më të rënda në bazë të programit me metadon.

3.6. BARBITURATI

Barbituratet janë barna të cilat përdoren në mjeksin e përgjithsme për arsye të ndryshme ku një nga arsyet është dhe trajtimi i problematikës së pagjumësisë.Ndahen në bazë të efekteve ato me efekt afatshkurtër dhe afatgjatë.Mund të konsumhoet nëpërmjet gëlltitjes, në formë të tabletave dhe kapsula.Përdorimi i tyre shpejt kanë efekt për rritjen e dozave po ashtu edhe varësis psiko-fizike.Ndalimi i menjëhershëm mund të ketë rezultate fatale deri me pasoja vdekje.Efektet të cilat janë si rezultat i përdorimit janë: lëvizje të penguara, shprehje verbale e pa kuptueshme, ecja nuk është e sigurt,lëvizje të pavullnetshme tëmuskujve , shpesh herë dhe lëndohen pasi nuk mund të dallojn pengesa të ndryshme në rrugë. Për fat të keq të rinjtë shpesh i konsumojnë Barbituratet në shoqërim me pije alkoholike e cila ka një fotografi klinike shumë të keqe.

3.7.STIMULATOR NA C N S (psihostimulato)

3.7.1 Amfetaminat

Amfetaminat janë droga sintetike, për herë të parë janë prodhuar në vitin 1920 dhe si psikostimulator të fuqishëm mënjëherë kanë zënë vend në zbatim në mjeksin e përgjithsme si barna kundër lodhjes dhe përgjumjes. Më vonë për shkak të depresionit si efekt i apetitit të tepruar janë përdorur si barna për shërimin e mbipeshës.Në kohën e luftës së dytë botërore masivisht janë përdorur tek ushtarët kundër lodhjes dhe koncentrimit. Egzistojnë të dhëna se këto substance përdoren masivisht edhe nga studentët , sportistët , shoferët në relacione të gjata etj. Prodhohet në formë tablete, pika, lëng, pluhur etj.

Efektet: Konsumimi paraqet ndryshime si në plan psiqik po ashtu dhe fizik:

Aspekti fizik: rritja e tensionit të gjakut, përshpejtimi i ritmit të zemrës dhe frymarrjes, rritja e aktivitetit muskulor etj.

Aspekti psiqik: eufori, ndjenja e rritjes energjis psiqike, ndjenja e vetbesimit, pagjumësi, humbja e oreksit etj.

3.7.2.Ekstaza (MDA,MDMA)

Ekstazat janë droga sintetike, tableta shumë shpesh dhe masovisht përdoren si droga në organizimet e festava të natës ndryshe njihet si “ëekand” droga.Masovikisht është përdorur në vitet 90 të shekullitk të kaluarduke ndjekur kulturën urbane ose më sakt TEKNO PARTY(rrym muzikore që kërkon adrenalin).Më shpesh konsumohen në formën e tabletave.Efekti përfitohet 30 deri 60 min pas konumimit, më i efektshëm është pas 90 minutash dhe zgjat deri më 3 orë.Pasojat nga kjo drogë akoma po studiohen.Të rinjtë e vendeve

të Evropës perëndimore janë të ekspozuar nga rreziku i kësaj droge pasi në këto vende organizohen më shumë festa ku dhe konsumohet më shumë.Këtë substanca prodhohen nëpër laboratore private në vende të ndryshme.

3.8. KOKAINA

Përfaqëson alkaloidin nga gjethi i bimës ERYTROXYLON COCA, bimë e cila rritet dhe kultivohet më shumë në Amerikën Jugore, nga e cila përfitohet Kokaina, me ngjyrë të bardhë me natyrë si pluhur me shije të idhët.Kokaina është e njohur si drogë për rekreacion e cila konsumohet me gëlltitje , nëpërmjet hundës me thithje ose me injektim. Në mjeksi përdoret si anestezi lokale. Efektet: pas konsumimit të kokainës nëpërmjet hundës efekti fillon pas 15-60 minuta. Paraqitet stimulant i fuqishëm fizik dhe seksual , e shoqëruar me ndjenjën e forcës dhe superioritet , zgjuarsi dhe hiperaktiv.Rritje të energjis psiqike, paraqet eufori e cila zgjat deri më 45 minuta .Në aspektin fizik kjo situatëështë e shoqëruar me rritjen e tensionit të gjakut,përshpejtim të funksonimit të zemrës dhe frymëmarrjes. Pas përfundimit të efektit paraqitet e kundërta, lodhje , përgjumje dhe humbje psiqike. Pas konsumimit të vazhdueshëm sjell deri te varshmëria.

3.9. Krek

Kreku është drogë e cila gjindet në formë të vogël therrimesh ose si kristale të bardha. Në organizëm futet nëpërmjet pirjes sëllullës , inhalim etj. Efekti: shumë shpejt ndikon tek truri paraqet eufori, shumë më të fuqishme se kokaina pas përfundimit të efektit kalon në depresion shumë të fuqishëm. Për këtë arsye mendohet se me hyrjen e drogës KREK në shoqëri paraqet kërcënimi më serioz për qetsinë dhe sigurinë socilae.

3.10. DROGAT HALUCINACIONE

3.10.1. L S D (Lysergic Acid Diethylamide)

LSD është përfaqësues tipik i drogave halucinacione.Ka efekt të madh në procesin e të menduarit dhe ndikimi tek vetëdija.Në tregun jolegal ajo mund të gjindet në formë si tablet,LSD gjindet në paketim të ndryshëm më shpesh të etiketuar me figura të personazheve të filmave vizatimor. Efekti: pas konsumimit të LSD paraqet vështirsi dhe ndryshime fizike dhe psiqike. Efektet e para janë ndjenja e pamtivimit , frikës,dridhjet, vjellja , kokëdhimbje etj. Efekti më i sheshtë paraqitet tek ndryshimi i të ndjerit paraqitja e halucinacionëve në formë shumëngjyrëshe, zëri vjen në formëngjyre .Efekti zgjat me orë ndonjëher dhe me ditë.Efektet mund të jenë shumë serioze dhe te sjellin deri tek ndryshime dhe dëmtime te rënda psiqike.

3.10.2. Phencyclidin (PCP)

Phencyclidin është drogë sintetike me efekt halicunacion.Në tregun jolegal gjindet me emërtime të ndryshme si psh PCP, pluhuri ëngjëllor, pluhuri magjik, HOG etj.Në formë tableta,pluhur dhe në formë të lëngët. Intoksinimi është sindroma më serioze kur keqpërdoret, paraqet sjellje tëdhunshme .Për këtë arsye shumë shpesh persona të cilët konsumojnë përfundojnë me vetvrasje, dhunim etj. Më shpesh konsumohet me thithje , ku përzihet me marihuanë dhe me pak duhan. Në tregun jolegal shumë shpesh shitet në vend tëMarihuanës ,ku përdoruesi nuk e din. Gjendja psiko-fizike e personit përdorues tëRSR varet në bazë të sasisë të konsumuar.

Efektet në aspektin psiqik: jo komunikimi, përshpejtim i ndjenjave, euforik, paraqitja e halucinacineve, depresini, paranoj etj. Efekti i 2-3 mgr PCP paraqitet pas 5 minutash, nivelin mëtë lartë të efikasitet e arrin pas 30 minutash dhe zgjat 4-6 orë , pas 24-48 orë përdoruesi rikthehet në gjendjen normale totalisht.PSP nuk paraqet varësi fizike.Disa konsummues ankohen nga depresioni dhe uria nga PSP.

3.10.3. Meskalin dhe Psylocibin

Meskalin: Gjindet tek kaktusi i emërtuar si lophopfora ëilliamsi. Konsumohet nëpërmjet gojës, efekti zgjat 8-12 orë.Gjindet në formë si pluhur, kapsula, tableta dhe lëng. Meskalini dhe Psilocibini kanë të njëjtin efekt si LSD .

Efektet në aspetin fizik janë: hipertenzion, rritje të temperaturës etj. Efektet psiqike janë : paraqitje e iluzioneve, jo stabilitet emocinal,ndryshme të mendimieve. Ka mundësi të ketë efekte edhe pas ndalimit tëpërdorimit .Mbi dozimi mund të paraqes gjendje në koma ose vdekje të menjëhershme.Nuk paraqet varësi as fizike as psiqike.

Psylocibin: gjindet tek këpurdha e quajtur psylocube cubensus , të cilat mbildhen dhe thahen dhe konsumohen nëpërmjet gëlltitjes dhe me tymosje.

3.10.4. Tatula (Datura stramonium)

Tatula është bimë e cila gjindet më shpesh në afërsi të deponive të mbeturinave.Konsumohet nëpërmjet gojës ose pregatitet në formë si caj.Tatula ka efektin si drogat e tjera halucianacione, në varësi dhe sasi të konsumuar e jep edhe efektet e ndryshme.Pas mbidozimit paraqitet gjendja e komas ose vdekjessë menjëhershme.

3.11. Kanabis

3.11.1. MARIHUANA-Cannabis sativa

Marihuana paraqet llojin e drogave halucianacioniste.Sipas disa ekspertëve dhe autorëve kjo drogë ndahet vecmas si lloji i vecantë. Përfitohet nga gjethja femër e Cannabis Sativa, nga lulet e të cilës fitohet Hashashi. Pjesa aktive e Marihuanës paraqet Tetrahydrocanabiol i cili gjendet tek gjethet me sasi nga 2 deri 10%.Konsumohet me thithje ku efekti fitohet pas 15-20 minuta , organizmi pastrohet mbas 7 ditësh. Pas konsumimit të një cigare me Marihuanëështë e mundur paraqitja e një lloj shqetsimi dhe frike.Efekti psiqik i Marihuanës në tru shkakton depresion.Pas konsumimit të Marihuanës shkaktohen disa crregullime në shëndetin psiqik dhe fizik të personit, eufori momentale, destabilizim i emocioneve, përshpejtimi i mendimeve por njëkohësisht dhe ngadalsimi i funksionimit normal të trurit etj.Konsumimi më i shpeshtë i Marihuanës sjell deri tek crregullimi dhe dëmtimi i funksioneve sidomos ato psiqike.Doza të larta të Marihuanës sjellin deri tek humbja e kontaktit me realitetin ,dëgjimi i zërave të ndryshme paraqitje të ndryshme të halucinacioneve etj. Shumë shpejtë nësë vazhdohet rregullisht të konsumohet kjo llojë e drogës të paraqitet dhe varësia si ajo fizike dhe ajo psiqike.

3.12. VOLANTINI (inhalacione, ngjtës)

Bënë pjesë nëgrupin e drogave të cilat më shpesh përdoren nga fëmijët me moshë nga 12 deri 14 vjec. Pjesa më negative qëndron në faktin se mund të gjinden shumë lirë dhe në tregun legal dhe atë si: dezifektant, desedorant, paisje për ngjyrosje, benzin,ngjitës etj. Më shpesh konsumohen në formë me inhalim më anë të frymarrjes.Pas efekteve përgjithsisht si tek drogat

e tjera një karakteristik e vecant është se përdoruesit e këtyre drogave bëhen shumë agresiv.Një përdorim më i gjatë në kohë sjell dhe varësin psiko-fizike.[11]

3.13.STEREDOIDE

Bëjnë pjesë: Dianabol, Provirn,Testoseron,Metadien, Nandrolon etj.

Gjindet në formë tabletash, kapsulash injeksione dhe mund të gjinden dhe të blihen në tregun legal dhe atë jolegal. Më shpesh konsumohen nëpërmjet gojës, por mundet dhe më injektim muskular.Stereoidet e zmadhojnë masën muskulore, forcën fizike, forcimin e eshtrave etj.Për këto arsye më shumë përdoren nga përsona që merren me peshngritje apo ndërtim të trupit. Efektet negative i ka nësë përdoren një kohë të gjatë dhe të pa kontrolluar mund të sjellë deri tëk dëmtimi i mëlqisë, dëmtimi i spermatozoidëve, shkakton imptotencëetj.[12]

[11] Dr.Gajdasic-Knezhevic Slavica, Acc.dr. Ignjatova Liljana, Paqoska Natka, „ Tretmani dhe parandaliimi i dëmeve nga keqpërdorimi i drogave“ Viti , 2005, Shkup, fq.25

[12] “Qendra Ndërkomunale për punë Sociale Ohër” , Viti 2017, Ohër fq.1-3

KAPITULLI I DYTË

SHKAQET DHE FAKTORËT KRYESORË QË NDIKOJNË NË KONSUMIMIN E LËNDËVE NARKOTIKE DHE EFEKTET E PËRDORIMIT TË TYRE

1. Aspekti Etiologjik i konsumimit të lëndëve narkotike

Përdorimi dhe aktivitete ilegale të lidhura me drogën janë qështje shumë të rëndësisshme nacionale dhe internacionale të cilat duhet të shikohen në kontekstin global.Droga nuk është një problem i thjeshtë sepse është një kërcënim serioz mbi sigurinë, shëndetin, mirëqënien, prosporitetin e popullatës vecanërisht tek të rinjtë.Përfshin një numër të madh të aspekteve të cilat lidhen apo kanë subjekt të përbashkët si: shëndetësore,sociale,penale,etike të cilat vetvetiu paraqesin sfidë më vete. Fenomeni lidhur me drogën dhe aktivitetet të cilat duhet të ndërrmeren janë shumë komplekse të një fushe më të gjërë e cila përfshin, preventivën, tretmanin, uljen e dëmeve, risocializimin, kontrollimi i drejtë, si dhe aplikimin e ligjit, ku duhet pasur një kujdes dhe vëmendje shumë të theksuar pasi përdorimi apo shtija në tregun ilegal i drogave është shumë dinamik dhe shum shpesh i ndryshuar në mënyra dhe forma të ndryshme. Keqpërdorimi i drogës dhe sëmundjet që paraqesin varësi psiko-fizike janë të lidhura me problemet globale të shoqëris sic janë : varfëria, papunësia, kriminaliteti, mungesa e banesës, në ndërkoh xhiroja e parave me preardhje nga tregëtia ilegale me narkotik mund të kete ndikim të madh tek stabiliteti i shoqëris, zhvillimin e shoqëris, proceset demokratike, si një ndër faktorët për vuajtje individuale dhe familjare, vjen dhe deri tek humbja e jetës të qytetarëve.[13] Duke marrë parasysh atë qëështë shkruar mëlartë , radha është që të pyesim me shumë të drejtë se sa Republika e Maqedonisëështë e vetëdishme për këtë probematik, sa ajo kontribon për zgjidhjen apo parandalimin e kësaj problematike si në aspektin nacional edhe atë ndërkombëtar, dhe sa është e aftë Republika e Maqedonisë që të garantoj apo përpiloj politika adekuate kundër drogës me qëllim për të garantuar shëndet, siguri dhe stabilitet për njeriun dhe shoqërin në përgjithësi.Keqpërdorimi

[13] „Strategjia Nacionale për drogën e Republikës së Maqedonisë“ Viti, 2017-2020, Shkup, fq.6

i drogës, dhe sëmundjet që dalin nga kjo ndikojnë tek të gjithë shtresat e shoqërisë, dhe etnitetet për këtë arsye si qëllim kryesor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara është ulja e kërkesës dhe mundësis për furnizim me drogë, dhe me këtë ruajtjen e vlerave themelore të shoqërisë, familjes, personit. Si strategji kryesore e Republikës së Maqëdonisëështë ulja e kërkesës për drogë dhe njëkohësisht ulja e mundësis së furnizimit, preventimi tek tëvarurit nga drogat, aktivitetet të cilat ndërmeren për shërimin e personave keqpërdorues të drogës, rehabilitimi dhe risocializimi i personave tëvarur. Vështruar nga aspekti etiologjik, kriminaliteti iorganizuar me narkotikë në shoqërite bashkëkohëse, është një dukuri mjaft e ndërlikuar e problem botëror, shkaktuar nga ndikimiet e faktorëve të shumtë kriminogjenë, sic janë: krizat ekonomike, varfëria,papunësia, pasurimi i shpejtë, kriza e banimit, emigracioni, prostitucioni, alkoolizmi, narkomia dhe dukuri të tjera socio patologjike, sic janë: familjet e degradura, familjet deficit, shfaqjet e luftës, konfliktet politike, ekzistenca akoma e deformimeve moniste dhe i disa veprimeve tinëzare të armikutnga jashtë, i cili nxit disa të rinjë në kriminalitetin e organizuar duke ua mundësuar dhe lehtësuar tregtimin e palejuar me mjete narkotike e keqpërdorimin e tyre. Këtu bën pjesë edhe faktori i imigracionit si shkaktar i kriminalitetit të organizuar.[14]Kërkimiet shkencore dhe njohja e faktorëve kriminogjenë në vete ngërthen para së gjithash hulumtimin e shkaqeve dhe hulumtimin e aspekteve etilogjike të tij. Të njohurit e aspekteve etiologjike , shkaktimi i tyre në lidhshmërinë me pasojat e përgjitshme është qëllimi dhe parakusht për kontrollimin dhe përhapjen e kriminalitetit tëorganizuar me narkotikë. Kështu, studimi i kriminalitet të organizuar në fushën e narkotikëve sidomos të tregtisë së palejuar tëtyre, prodhimin, kultivimin, shitja, nxitja për përdorim, brenda dhe jashtë vendit të drogës narkotike ose substancave psiktrope, qoftë si dukuri me përmasa të rrezikshme kriminale dhe lidhja e tyre me kriminalitetin nëpërgjithësi ,është cështje thelbësore me karakter etiologjik.Një ndër format e kriminalitetit të organizuar është dhe prodhimi , kultivimi, shitja nxitja për përdorim, brenda dhe jashtë vendit, e drogës narkotike ose e substancave psikotrope.[15]Sa do që të jenë të hulumtuara dhe të mësuara, shkaqet dhe kushtet e vecanta dhe të

[14]Dr.sc.Bicaj.K , "Aspekti Etiologjiki i Kriminalitetit" , fq. 1
[15] Prof.dr. Begeja. S, Kriminalistika, Viti, 1997, Tiranë, fq.3.

drejpërdrejta të kësaj forme kriminale, do të ishte e gabuar të mendohet se me ndihmën e disa shkaqeve mund të shpjegohet kriminaliteti i organizuar në tërësi dhe tregëtia e jashtëligjshme e drogave, narkotikëve ose esubstancavepsikotrope nëvecanti [16].Duke studiuar këtëfenomen , nga aspeki kriminologjik si dhe faktorët krimonogjenë, u afrohemi shkaqeve të tërthorta të sjelljeve kriminale. Tregtia e palejuar e drogave ose e substancave të ndryshme narkotike ,është rezultat i shumë faktorëve. Është i vështirë të thuhet se vetëm një faktor mund të shkaktoj paraqitjen e kësaj dukurie në kohëra në mjedise dhe në kushte të ndryshme dhe te personat e ndryshëm.Kriminaliteti iorganizuar i narkotikëve paraqet dukuri negative për shoqërinë.Në paraqitjen e kësaj dukurie ndikojnë shumëfaktorë , si të natyrës objektive ashtu edhe të natyrës subjektive.

1.1.Përdorimi i drogës në mesin e popullatës së përgjithshme dhe të rinjve.

Deri më sot nuk është bërë ndonjë studim serioz mbi përdorimin e drogës në mesin e popullatës së përgjitshme.Disa sondazhe mbi përdorimin e drogës në mesin e nxënësve janë kryer gjatë viteteve të fundit si psh : Projekti Evropian mbi Përdorimin e Alkoholit dhe Drogave (të tjera (ESPAD), Studimi i Shëndetit tek fëmijët që janë në Shkollë , Studimi i UNICEF-it për adoleshentët më të rrezikuar dhe një studim mbi prevalencën e HIV SIDA dhe sjelljen e rrezikut në grupet e rrezikut.

Sondazhi i parë i ESPAD u krye në vitin 1999 dhe u përsërit në vitin 2008.Sondazhi i vitit 2008 u realizua në 22 qytete të zgjedhura rastësisht nga 30 qytete, në përputhje me shpërndarjen e vjetër territoriale të vendit.Në anketim morën pjesë 156 klasa të vitit të parë dhe të dytë në shkollëne mesme, (nxënës të lindur në vitin 1992 , në momentin e anketimit të moshës 16 vjec.) nga 68 shkolla të mesme publike.Gjithsej janë përpiluar 2452 pyetësor për të përpiluar rezultatet.

[16] Milutinovic.M,vep.e cit., fq.371.

Studimi i vitit 2008 ka dhënë këto rezultate:

- 5.5% e nxënësve kanë përdorur Kanabis të paktën njëher në jetën e tyre (prevalence gjatë jetës) , 4.3% e kishin përdorur atë gjatë 12 muajve të fundit dhe 2.2% e kishin përdorur atë në muajin e fundit.
- 3.2% e kan përdorur ekstazën të paktën një herë në jetën e tyre (një rritje prej 1% që nga viti 1992), 2.1% në 12 muajit e fundit dhe 1.6% në muajin e fundit.
- Përdorimi i inhalantit është i rrallë, dhe zakonisht ata përdorin inhalantin vetëm një herë ose dy herë. Rreth 1.4% e nxënësve e kanëpërdorur së paku një herë në jetë , 1.1% në 12 muajit e fundit dhe 0.4% në muajin e kaluar.
- Përdorimi i përditshëm i barnave është nën 1% në shumicën e rasteve (LSD 0.8%,Plasarit0.7%, Kokain 0.9%, Heroin 0.8%, këpurdhat magjike 1.2%, GHB 0.6%, stereoide 0.9%)
- 10.1% e nxënësve kishin përdorur qetësues të paktën një herë në jetën e tyre , duke i kthyer ata si substancat legale më të zakonshme. 11.2% janë femrat ato që përdorin qetësues kundrejt 9.1% që janë meshkujt. Duhet theksuar se recetat mjekësore të qetësuesve janë dyfishuar që nga viti 1999. Përafërsisht 6% e nxënësve kishin përdorur qetësues nje ose dy herë.
    - Përdorimi i kanabisit ka rënë që nga viti 1999 dhe mbetet i ulët krahasuar me vendet tjera Europiane. Përdorimi i Marihuanës mbetet më popullori në mesin e nxënësve.
    - Përdorimi i barnave të tjera të paligjshme mbetet i njëjti si në vitin 1999.
    - Nëpërgjithësi , studentët meshkuj përdorin më shumë lëndë narkotike se sa nxënëset femra.
    - Përvojën e tyre të parë nxënësit e kanë pasur në moshën 14 ose 15 vjecare.

  Hulumtimi i HBSC (Sjellja Shëndetsore tek Fëmijet e moshës Shkollore, në kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetsis) është realizuar tri herë në R.Maqedonisë në v. 2002, 2006 dhe 2009/10. Në vitin 2006 rreth 4% e meshkujve dhe 3% e femrave nga 1500 nxënës kanë raportuar se kanë përdorur sëpaku njëher Kanabis. Më pakë se 5% e nxënësve të moshës 15 vjec kanë përdorur Kanabis në 30 ditët e fundit. Prevalence e

përdorimit të Kanabisit gjatë 12 muajve të fundit dhe në 30 ditët e fundit ishte 3% për meshkujt dhe 1% për femrat.

Bazuar tek frekuenca e përdorimit janë ndarë në 4 grupe dhe atë:

- Përdoruesit me ndërprerje: meshkuj 1%
- Eksperimentuesit : meshkuj 1%
- Përdoruesit e rregullt: meshkuj 2%
- Përdoruesit e rëndë: meshkuj 1%

Përqindaj e përdoruesve femra në secilën prej grupeve të përdoruesve ishte afër zero.Përdoruesit e ndërprerë: ata që kanë përdorur kanabis të paktën një herë në jetën e tyre, por jo në 30 ditët e fundit ose 12 muajt e fundit. Eksperimenti: ata që kanë përdorur kanabis 1-2 herë në 12 muajt e fundit. Përdoruesit e rregullt: ata që kanë përdorur kanabis 3-39 herë në 12 muajt e fundit. Përdoruesit e rëndë: ata që kanë përdorur kanabis 40 herë ose më shumë në 12 muajt e fundit.[17]

2. Teoria e faktorit

Teoria e faktorit paraqet këndvështrimin lidhur me faktoërët kriminogjenë dhe thekson se në shfaqjen e kriminalitetit ndikojnë rrethana të ndryshme. Dy janë shpjegimet kryesore të saj. Në versionin e parë, teoria e quajtur teoria e një faktori të vetëm (monfaktor) sipas të cilës kriminalitetin në shoqërin e shkakton një faktor kryesor kriminogjen. Teoria tjetër e faktorit është teoria pluraliste, ose teori multifaktorëve, e cila thekson se në paraqitjen e kriminalitetit ndikojnë më shumë faktorë dhe shkaqet e kriminaliteit i gjenë nën ndikimin e shumë rrethanave shoqërore,ekonomike familjare etj.[18] Njeriu gjithmonëështë përjekur që jetën e vet ta bëj më të lumtur , për të jetuar sa më mirë dhe më leht. Kështu nga kureshtja, duke e studiuar natyrën dhe botën , ai vuri kontakte edhe me kriminalitetin i cili shprehet në forma të ndryshme pavarsisht faktorëve të ndryshëm dhe shkaqeve të brendshëm dhe të jashtme që ndikojnë te njeriu. Si qënie shoqërore njeriu i qëndron ndikimit të rrethit

[17]Europian Monitoring Centre for Drug and Addiction , Raporti për Republikën e Maqedonisë, Shtator, Viti 2013.
[18] Dr.sc.Bicaj. K , "Aspekti Etiologjik I Kriminalitetit" , fq. 2.

shoqëror dhe reagon në situata të caktuara dhe në rrethana të tjera në shoqëri. Shumë autorë, të cilët e studijojnë kriminalitetin në përgjithësi, konsiderojnë se kriminaliteti është pasojë e shkaqeve të shumta, si për shembull nëpër disa vende kultivohet shumë bima e narkotikut si burim jete dhe të mirash ekonomike. Për rrjedhojë ato merren me prodhimin, kultivimin dhe shitjen e në disa raste edhe tregtinë e palejuar me narkotikë.

3. Faktorë e jashtëm që ndikojnë në konsumimin e lëndëve narkotike

Sipas mendimit të disa kriminologëve , ndikimin më të madh në paraqitjen e kriminalitetit ku bënë pjesë dhe konsumimi i lëndëve narkotike si sjellje kriminale, e kanë dhe faktorët e jashtëm ose egzogjenë, paraqesin kushtet dhe rrethanat determinuese të sjelljes kriminale. Nga kërkimet empirike kriminologjike e sidomos duke marrë parasysh rezultatet e shënimeve dhe të të dhënave statistikore mbi kriminalitetin në përgjithsi, në shumë vende vërehet se disa faktorëobjektivë përgjithësisht të jashtëm kanë një ndikim më të madh se sa faktorët e tjerë.[19] Sipas teorive bashkëkohëse , lidhur me ndikmin e faktorëve objektivë, ekonomikë e shoqëror ka pikëpamje të ndryshme kur flasim për kriminalitetin e organizuar me pije narkotike ose tregtinë e palejuar me narkotikë. Në këtë drejtim theksohet arritjet e mëdha në zhvillimin e hovshëm të industrisë, në telekomunikacionin, zhvillimin i elektronikës, ai hekurudhor dhe rrugor dhe një varg transformimesh me kompjuterike kanë ndikuar edhe në proceset e formimit të njeriut dhe personalitetit të tij. Disa vende botërore të pasura bëjnë gara për dominim ekonomik dhe teknologjik e në anën tjetër shumë shtete janë në mjerim, skamje, varfëri, egzodin masiv dhe që kanë një natalitet të shtuar, por edhe me një vdekshmëri masive të popullsisë nga uria[20]. Sa i përket Maqedonisë e cila ndodhet në një fazë të stërgjatur të tranzicionit e cila vetvetiu mbjell klimën e mosbesimit dhe pesimizmit tek qytetarët të cilët gjejnë mënyra të ndryshme të aktiviteteve nje pjesë dhe kriminale. Ekonomia në rënie në Republikën e Maqedonisësjell rritjen e pesimizmit tek të rinjtë të cilët shumë shpejt mund të bien pre e grupeve kriminale të narkotikëve. Kësisoj si faktorë më me ndikimin të dukshëm në paraqijen e sjelljeve kriminale trajtohen grupi i faktorëve ekonomiko-shoqëror, faktorët ideopolitik, mikrogruprë, sociopatologjikë dhe

[19] R.Halili, "Kriminlogjia" 2002, fq.231.
[20]Dr.sc.Kadri Bicaj , "Aspekti Etiologjik i Kriminalitetit" , fq. 3.

tëtjerë. Shumica e faktorëve të jashtëm do të trajtohen vec e vec dhe me shpjegime më të hollësishme në vazhdim të këtij punimi.Shumë e rëndësishme është dhe përcaktimi i rëndësis së faktorëve kriminogjen në lidhje me lartësin intezitetin apo ndikimin që kanë në rritjen apo zvogëlimin e përqindjes së paraqitjes së sjelljeve kriminale.[21]

3.1. Krizat ekonomike dhe kriminaliteti

Varfëria , disavantazhi ekonomik dhe papunësia janë disa nga faktorët që mundësojnë apo shtysin kultivimin dhe shitjen e drogës. Aspekti ekonomik mund të ketë gjtihashtu një ndikim në zhvillimin e tregjeve të paligjshëme të drogës, si ndryshimet në nivelet e të ardhurave dhe të fuqisë blerëse ku mund të ndikojnë dhë në modelet e konsumit të drogës. Ashtu si zhvillimi ekonmik ka një ndikim në tregjet e paligjshme të drogës,prblemi i drogës mund të ketë pasoja ekonomike. Kostoja ekonomike që shkakton përdorimi i drogës psh kur shtresa e fuqisë punëtore që njëkohësisht është dhe përdoruese e lëndëve narkotike , nuk marrin trjatimin adekuat atëher ato mund të ndikojnë në produktivitetin e tyre në punë. Shpenzimet që lidhen me përpjektjet nga ana e institucioneve shtetërore për të ndihmuar njerëzit të cilët përdorin drogë, të tilla si përpjekjet për të siguruar trajtim dhe rehabilitim kanë një ndikim në buxhetin e shtetit përkatës. Një mënyrë pë të parë se si zhvillimi ekonmik ndikon në problemin e drogës është për të krahasuar këtë të fundit nëpër vende të ndryshme në bazë të zhvillimit të tyre ekonomik. Një analizë e tillë ofron një pamje të thjeshtuar, pasi ka një numër faktorësh që mund të luajnë një rol në formësimin e problemit të drogës. Disa modele manifestohen në nivel global dhe mund të shihen krahasimet ndër veti në bazë të treguesve kombëtarë, modelet e tjera janë të lidhura thelbësisht me variacione brenda shteteve dhe mund të vërehet nga indikatorët socio-ekonomik në nivel lokal. Papunësia qëështë e pranishme gjatë krizave ekonomike sjell me vete varfërinë dhe mungesën e kushteve elementare për egzistencë. Krizat dhe depresionet ekonomike ndikojnë dhe në paraqitjen e të ashtuquajturave crregullime dhe depresione individuale. Krizat ekonomike ndikojnë në paraqitjen e konflikteve dhe kundërthënieve brenda në familje dhe në grupe të ndryshme shoqërore. Në pjesën më të madhe në kohën e krizave

[21]Oliver Baqanviq “Policijata i Drzhavta” Shkup, 1997, fq.182.

ekonomike-sociale njerëzit përpiqen që këtë gjendje ta kalojnë me angazhime dhe punë normale në pajtim me ligjin. Mirëpo , disa individ dhe grupe, krizat e këtilla përpiqen ti përballojnë dhe ti tejkalojnë duke u marrë me veprime dhe aktivitete antiligjore dhe kriminale.[22]Sipas vrojtimeve personale dhe duke u bazuar tek të dhënat e Qendrës Ndërkomunale për punë Sociale nëOhër, Varfëria dhe Bixhozi ka sjellë deri tek perhapja e sjelljeve kriminale sidomos tregtisë të paligjshme me Marihuanë (me e lir në kosto dhe më e lehtë në gjetje) me shpresën se do pasurohen në mënyr të shpejtë dhe si një mënyrë për rimbursimin e borxheve të vëna si pasojë e bixhozit. Vetëm në Strugë në një hapsir prej jo më shumë se 2 km katror aktualisht janë funksionale rreth 20 Kazino, të cilat janë bërë burim i sjelljeve kriminale tek të rinjtë. Sipas të njëjtit burim 346 është numri i konsumuesve të lëndëve narkotike të regjistruar tek Qendra për punë Sociale ku, sipas ekspertëve të këtij institucioni numri më i madh i personave përdorues të lëndëve narkotike vijnë nga familjet me probleme ekonomike në familje.

3.2. Papunësia dhe Kriminaliteti

Ekziston një linjë e qartë pozitive ndërmjet varësis nga droga dhe disavantazheve sociale, duke përfshirë dhe papunësinë dhe varfërinë. Marrdhëniet në mes përdorimit të drogës dhe statusit të punësimit është mjaft komplekse dhe karakterizohet nga shkaktari reciprok:**përdorimi i drogës rrezikon për të mbetur i papunësuar, ndërsa papunësia rrit rrezikun e përdorimit të drogës.** Përdorimi i drogës mund të pengojë prespektivën e punësimit të një personi duke ulur produktivitetin dhe mundësinë për të gjetur punë. Në anën tjetër, papunësia mund të shkaktoj stres , ankth dhe vështirsi financiare, pakënaqsi të gjitha këto mund të inicojnë ose të intesifikojnë përdorimin e drogës. Ka disa mënyra ku problemi i drogës mund të ndikojë në shanset për një përson për të gjetur ose për të mbajtur vendin e punës. Së pari personat me crregullime të cilët vuajnë nga varësia e drogës, kanë probleme mendore , psiqike dhe me mënyrën e jetesës. Së dyti përdorimi i drogës mundtë jetë i lidhur me faktorë të tjerë , të tilla si mungesa e kualifikimeve , nivelit të ulët të arsimit , ulja drastike e aftësis për të menduar në mënyrë racionale dhe për të

[22]Halili. R , "Kriminlogjia", Viti 2002, Prishtinë fq.236

gjykuar shëndetshëm etj.[23] Përqindja e papunësis në Republikën e Maqedonisëështë 29.9 përqind , sipas Institutit Shtetëror të Statistikave. Numri i personave të papunë në Republikën e Maqedonise është 284.823 mijë nga të cilët 61.4% janë meshkuj, ndërsa 38.6%janë femra, përqindja më e madhe e papunësis është ndërmjet moshës 15 der 24 vjet ku rezulton 53.5% nga 25 deri 49 vjet është 28.3% dhe nga 50 deri 64 vjec është 24.8%.Nga të papunësuarit 159.171 janë me arsimim të mesëm, 68.534 mijë me arsim themelor, 40.183 me arsim të lartë. Me arsim themelor të pa përfunduar janë10.566 , me arsim të lartë 3936 dhe pa arsim janë 2433 mijë persona.

Tabela 2:

Shoqeria aktive për punë dhe përqindja e papunësis në R.Maqedonisë[24]

Viti	Shuma totale e shoqëris aktive	Shoqëria aktive			% e aktivitetit	% e të punësuarve	% e të papunësuarve
		totali	Të punësuar	Të papunësuar			
2015	1 676 659	954 924	705 991	248 933	57.0	42.1	**26.1**
2016	1 678 890	948 599	723 550	225 049	56.5	43.1	**23.7**
2016/I	1 678 411	945 821	714 435	231 386	56.4	42.6	**24.5**
2016/II	1 678 805	948 376	720 674	227 702	56.5	42.9	**24.0**
2016/III	1 679 052	949 944	727 985	221 959	56.6	43.4	**23.4**
2016/IV	1 679 290	950 255	731 107	219 148	56.6	43.5	**23.1**

[23]United Nations Office and Drugs and Crime, "World Drug Report", Viti 2016 , Ne York fq.72
[24]"Instituti Shtetëror i Statistikave të R.Maqedonisë", Viti 20.03.2017, Shkup, nr 2.1.17.06., fq.2

Për shkak të pamundësis së plotësimit të shkollimit dhe mbrojtjes shëndetsore, pason braktisja e shkollës dhe mësimit, paraqitja e sëmundjeve dhe sjelljeve kriminale. Këto faktorë ndikojnë më së shumti tek personat me tëri në moshë, të cilët i shtyn preteksin për ti harruar këto probleme të konsimojnë lëndë narkotike.Nga ana tjetër vet atmosfera e krijuar për shkak të papunësisë, ndikon në gjendjen psiqike dhe shpirtërore të individëve dhe familjeve të caktuara. Rritja e kriminalitetit me lëndë narkotike përvec tjerash shpjegohet edhe me ndikimin e papunësis.Gati në të gjitha vendet ku është shtuar papunësia, vërehet edhe rritja e formave të ndryshme të kriminalitetit, megjithëse kjo nuk do të thotë se kriminaliteti automatikisht do të rritet nëse shtohet papunësia.[25]

TABELA 3:

Përqindja e papunësis tek perosnat e moshës nga 15 deri 74 vjec. Masa e matjes %[26]

	2011	2012	2013	2014	2015
Gjithsej	31.4	31.0	29.0	28.0	26.1
Meshkuj	31.8	31.5	29.0	24.6	26.7
Femra	30.8	30.3	229.0	2836	25.1
Mosha					
15-24	55.3	53.9	51.9	53.1	47.3
25-74	28.5	28.2	26.3	25.2	23.8

Të rinjtë dhe puntoret më të vjetër, femrat dhe personat me kualifikim të ulët janë personat të cilët vuajn nga papunësia. Përqindja e papunësis të personave nga 15-24 vjec viti ku ishte dhe kulmin e saj ishte viti 2003 , prej asaj kohe sa vjen dhe zvogëlohet. Në krahasim me vitin 2014 përsëri ishte me e ulët dhe ishte 47.3%. Peqindja e papunësis tek meshkujt për vitin 2015 u ul për 0.9% ndërsa tek femrat për 3.5% e cila tregon që situata po përmisohet sa i përket gjinisë femërore. Sic edhe shihet nga statistikat zyrtare përsëi të rinjtëjanë shtresa më problemtaike

[25] Halili.R, "Kriminlogjia"Viti, 2002, Prishtinë, fq.239
[26]"Instituti Shtetëror i Statistikave të R.Maqedonisë", Viti, 2016, Shkup, fq.6

për punësimin e cila pastaj ashtu sic kemi theksuar ka lidhje direkte me shfaqjen e sjelljeve kriminale apo devijuese.

3.3. Arsimimi dhe Kriminalitetit

Përvojat botërore tregojnë se roli i familjes tradicionale në procesin e edukimit tek fëmijët sa vjen është në rëniedhe kjo për disa arsye: rritja e numrit të divorceve, gjithmonë më shumë dhunë në familje etj. Për këto dhe të tjera arsye Arsimimi dhe sistemi shkollor në tërësi është njënga shtyllat kryesore për zgjidhjen kushtimisht thënë të kësaj problematike shumë komplekse.Qysh ne kohën e mendimtarëve dhe filozofëve racionalist dhe ato iluminist, është theksuar se me anë të arsimimit të njerëzve luftohen shumë të këqija në shoqëri.Njeriu i arsimuar është më i aftë për të dalluar të keqen nga e mira.

Situata në lidhje me arsimimin në Republikën e Maqedonisë ndryshon në bazë të shkallës së arsimimit.Kështu që në arsimimin bazë, nga viti në vit zvoglohet numri i nxënësve që regjistrohen për her të parë, si dhe numri i përgjithshëm i nxënësve.Numri i nxënësve të regjistruar në arsimin bazë për vitin shkollor 2014/2015 është më i vogël për 15.3% në krahasim me vitin 2004/2005.Situata me numrin e nxënësve të regjistruar në arsimin e mesëm gjithashtu po zvogëlohet, numri i nxënësve të regjistruar për vitin shkollor 2014/2015 në krahasim me vitin shkollor 2004/2005 është zvogëluar për 12.3%.Në krahasim nga arsimi bazë dhe i mesëm situata është më pozitive në arsimin e lartë ku numri i regjistruar i studentëve është në rritje.Numri i studentëve të regjistruar për vitin 2014/2015 është rritur për 20.2% në krahasim me vitin 2004/2005.

GRAFIKONI 2:

Niveli i arsimimit të popullsis mbi 15 vjec në Republikën e Maqedonisë[27]



TABELA 4 :

Niveli i arsimimit të popullatës në Republikën e Maqedonisë[28]

Gjithsej	1.579.500	100
Pa Arsimim	60.700	3.85
Të papërfunduar arsimin bazë	170.200	10.77
Arsimin bazë	579.200	34.77
Arsim i mesëm trivjecar	168.000	10.64
Arsim i mesëm katërvjecar	465.100	29.45
Arsim i lartë	51.200	3.24
Arsim univerzitar	114.900	7.28

[27] "Instituti Shtetëror i Statistikave të R.Maqedonisë" Viti 2016, Shkp, fq.23

[28] „Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë nga 2005-2015, Shkup , fq.29

Nëse këtij grupi do ti shtonim dhe personat të cilët kanë përfunduar vetëm 3 ose 4 vjet arsim atëher sitauata sa i përket arsimit në Republikën e Maqedonisëështë alarmante, dhe aspak nuk është optimiste për rritje të ekonomis dhe mundësis sociale për mirjetesë. Në kushte të një bumi të madh të zhvillimit teknologjik i cili nënkupton dhe arsim më të lartë dhe profesinal.[29]Situata ku gjendemi nuk është shpresdhënëse, dhe kjo fare lehtë mund të sjell deri te përhapja e sjelljeve kriminale në përgjithsi ku normal bënë pjesë dhe përdorimi apo shitja e lëndëve narkotike.Numri më i madh i të papunëve në Republikën e Maqedonisëështë pikërisht i personave që kanë ose nuk kanë fare arsim të përfunduar. Nësë kësaj i shtojmë dhe shoqërinë jo aktive për punë tek e cila 62.05% janë të gjinisë femërore, nga e cila 67.57% posedon arsimimi të përfunduar deri tek shkalla e arsimit bazë, atëherë situataështë akoma më e rëndë. Të gjitha shifrat që kemi përmendur më lartë janë “burim” pothuajse i sigurt që për një periudh jo shumë të largët në Republikën e Maqedonisë të shtohen sjelljet kriminale vecanërisht ajo më lëndë narkotike. Pamundësia për tu integruar në shoqëri, mos posedimin e respektit nga të tjerët, dështimi në më shumë fusha të jetës janë disa faktor kyc që janë në lidhje të drejtpërdrejtë shkak pasoj sa i përket përhapjes të sjelljeve kriminale.

3.4. Familja dhe Kriminaliteti

Modele të ndryshme të përdorimit të drogës kanë dhe lloje të ndryshme të ndikimit në familje apo ndikimi nga familja. Në disa situata , përdorimi i drogës mund të bëjë ndryshime ose kufizime të vogla për familjen, ose nga familja për antarin përdorues të lëndëve narkotike. Mardhënia, dhuna në familje, abuzimi dhe neglizhimi sidomos i fëmijëve dhe ndikimi i ekonomisë familjare.Përdorimi i drogës shpesh lidhet me abuzimin e fëmijëve dhe dhunën në familje dhe gjithashtu është një kontribues kryesor për pakënaqsinë martesore, për prishjen e familjes dhe refuzimin e anëtarve të familjes.Familja është institucioni ku mësohen dhe interpretohen numër i madh i teorive.Mirëkuptimi dhe organizimi i familjes parashtron një sfidë për teoricentët dhe profesionistët e drejtimieve të ndryshme, vecanërisht familjet me adoleshent, ku të gjithë janë dakord qëështë familja shembull për një mardhënie

[29] Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005-2015“ fq.30

shumëkomplekse.***Sistemi Familjar*** nuk përbën vetëm një grup personash që i përkasin së njëjtës familje por, ajo paraqet vendi ku rriten, zhvillohen, bashkërisht lidhen, përmbahen ndërmjet veti, plotësojnë ose zavendësojnë njëri tjetrin . Antarët e familjes, janë të lidhur ndërmjet veti jo vetem fizikisht por edhe emocionalisht, kjo nënkupton që vetëm ndryshimi i sjelljes emocionale apo fizike e një antari të familjes ndikojn drejtpërdrejtë në ndryshimin e të gjithë funksionalitetin e të gjithë familjes. Ndër obligimet të tjera që ka familja si ato (biologjike, egzistenciale,psiko-sociale etj) vecanërisht të rëndësishme konsiderohen dhe mesimi i artit të komunikimint dhe e mënyrës së dakordimit, ndërtimin dhe rrespektimin e sistemit të vlerave materiale, ato morale dhe standarteve normative, respektimin e ndryshimit, përkrahjen e kreativitetit, mënyrë së jetesës etj. Sistemi familjar bashkarisht me antarët e saj vazhdimisht ndryshon , rritet, dhe zhvillohet duke kaluar tek faza apo cikle te caktuara. Cdo cikël jetësor paraqet një sfidë për familjen ku ndonjëher kërkon riorganizim, ndonjëher ndryshim të sistemit familjar , dhe ndonjëher të dyja bashkë. Në ditët e sotme shumë shpesh është vënë në pikëpytje roli i Sistemit Familjar në lidhje me paraqitjen, zhvillimin, dhe mbajtjen e keqpërdorimit me drogë , mbi të gjitha kur është në pyetje adoleshenti si antar i familjes paraqitet si keqpërdorues i lëndëve narkotike. Edhe pse familja nuk është faktor i vetëm por padyshim qëështë një nga më të rëndësishmit në lidhje me këtë problematik. Duke marrë parasysh që sistemi familjar pos të githave, ka një rol shumë të rëndësishëm në ruajtjen, zhvillimin e shëndetit shpirtëror të antarëve të saj, dhe vecanërisht tek adoleshentët. Nësë familja nuk qëndron pranë probleme psiko-sociale dhe nuk ndihmon në gjetjen e një zgjidhje, atëherë mundësia është shumë e madhe që vecanërisht adoleshentët ti drejtohen rrugëve alternative për ti „zgjidhur“ këto probleme. Pas kontaktit të parë nga kureshtja adoleshenti mendon se pas konsumimit të lëndëve narkotike fshihet zgjidhja e të gjitha problemeve të paraqitura më lartë. Kjo eksperiencë do jetë faktori apo arsyja kryesore që shumë adoleshentë apo të rinjë përsëri dhe përsëri do jetë pre e epshit për ta provuar drogën, pa marrë parasysh efektet negative të saj. Edhe pse konsumues apo keqpërdorues të lëndëve narkotike vijnë nga sisteme familjare të ndryshme ku dallojnë ndërmjet veti për sa i përket organizimit apo funksionalizimit, tek numri më i madh i

tyre gjejmë disfunksionalizimi të sistemit familjar, familje të cilat mund ti grupojmëtek familjet me rrezik për paraqitjen dhe zhvillimin e personave keqpërdorues të lëndëve narkotike.[30]

Sipas të dhënave statistikore nga Qendra Ndërkomunale për punë Sociale në Ohër numri i personave të regjistruar si persona keqpërdorues të lëndëve narkotike dhe njëkohësisht të varuar nga të njëjtat në këtë qendër është gjithsej 346 persona nga të cilët 210 janë përdorues të drejpërdrejt të drogave të ndrysme dhe **136 të tjerë janë antar të familjeve**. Në vitin 2016 janë regjjistruar dhe 10 raste të tjera ku 7 nga ata janë përdorues të drejpërdrejtë të drogave të ndryshmë ndërsa 3 të tjerë janë antar të familjeve.

TABELA 5:

Numri i personave të regjistruar si keqpërdorues të lëndëve narkotike në qendrën ndërkomunale në Ohër[31]

Gjithsej	Spas vendbanimit	Sipas nacionalitetit	Sipas moshës
364 persona	Ohër 60%	Maqedon 73%	Mbi 28 vjec 55%
	Strugë 32%	Shqiptarë 17%	23-28 vjec 30 %
	Kërcovë 8%	Turq 4%	19-22 vjec 13 %
		Egjiptianë 3%	Nën 18 vjec 2%
		Romë 2%	

3.4.1.Karakteristika e familjeve nga të cilat dalin keqpërduesit e lëndëve narkotike:

Familje disfunksionale, një nga varësit në familje si : problem me alkoholin, drogën, dhunën, etj. Dhuna në familje, mardhënie të prishura dhe konflikte të vazhdueshme mangësia e arsimit të antarëve të familjes, mungesa e procesit edukativo-arsimor.[32]Kur flitet për ndikimin e familjes dhe raporteve familjare në sjelljet kriminale të fëmijëve dhe të miturve, është me rëndësi

[30] Dr.Gajdasic-Knezhevic Slavica, Acc.dr. Ignjatova Liljana, Paqoska Natka, „ Tretmani dhe parandaliimi i dëmeve nga keqpërdorimi i drogave“ Viti, 2005, Shkup fq.38
[31] “Qendra Ndërkomunale për punë Sociale Ohër” , Viti 2017, Ohër fq.1-3
[32]“Qendra Ndërkomunale për punë Sociale Ohër” , Viti 2017, Ohër fq.1-3

tëtheksohet se nuk duhet të absolutizohet përtej mase ndikimi i familjes[33]. Këto faktorë duhet të ndërlidhen dhe me faktorë të tjërë, që kanë ndikim në paraqitjen e sjelljeve kriminale përfshirë dhe konsumimin e lëndëve narkotike.

4. Faktorët e brendshëm që ndikojnë në konsumimin e lëndëve narkotike

Sado që faktorët e jashtëm apo objektivë u takon një rol me rëndësi nëpraqitjen e sjelljeve kriminale, dukuria e kriminalitetit me narkotik nuk mund të shpjegohet drejtë dhe deri në fund pa analizën dhe ndricimin e faktorëve të brendshëm subjektiv, të cilët kanë të bëjnë me personalitetin e kryersit, në rastin e studimit tonë me konsumuesin apo keqpërdoruesin e lëndëve narkotike. Kur flitet për faktorët subjektiv zakonisht mendohet për individin, për personalitetin e njeriut, në rastin konkret, të njeriut delikuent. Në këtë drejtim posacërisht theksohet roli dhe rëndësia e jetës së tij biopsiqike dhe lidhjet e sj me sjelljet dhe veprimet kriminale. Mendohet se ndikimet e faktorëve të jashtëm në sjelljet dhe veprimet e personalitetit varen shumë nga vetë struktura biologjike dhe psiqike e atij individi. Nësë ajo strukturëështë normale, nësëështë zhvillluar në mënyrë harmonike, nësë nuk ka defekte dhe anomali, atëherë personaliteti i njeriut është më rezidentndaj ngacmimeve dhe ndikimeve që vijnë nga jashtë nga veprimi i kushteve dhe faktorëve objektiv dhe anasjelltas. Prandaj mu këtu qëndron rëndësia e njohjes dhe shpjegimet të faktorëve subjektivëe gjitha sa e thënë më lartë nuk mund të përgjithsohet si nje fakt i pandryshuar, nga vet fakti se cdo person përdrues apo keqpërdrues i lëndëve narkotike është një histori më vete e cila ngërthen si motive si fakorët e brendshëm ashtu edhe ato të jashtëm.[34] Nuk mund të thuhet edhe pse ndihmojnë mjaftueshëm shumë me studimin e faktorëve si ato objektiv apo ato subjektiv nuk dmth se kemi arritur deri tek burimi i kësaj prblematike, megjithëse lirisht mund të thuhet se ka dritë në fund të tunelit dhe me gjithë zhvillimin socio-ekonomik arritjet janë optimiste për ta reduktuar sa më shumë qëështë e mundur problematikën e keqpërdorimit të lëndëve narkoitke.Faktorët subjektiv apo individual mund të shihen si faktorë që kanë bazën në ndikime të natyrës biologjike dhe në faktorë që këtë bazë e kanë në ndikimet e natyrës psikike.[35]Disa autor kanë mendim dp thosha shumë radikal

[33] R.Halili, "Kriminlogjia" 2002, fq.266
[34] R.Halili, "Kriminlogjia" 2002, fq.321
[35] Halili.R,"Viktimiologjia" Viti ,2007, Prishtinë fq.115

apo ekstrem ku i përkufizojnë prirjen e disa personave për tu marrë me kriminalitet vetëm sepse kanë ndonjë anomali psiqike apo fizike, për të thënë të vërtetën kjo tezë apo teori asnjëherë nuk ka marrë mbështetje të gjërë dhe as qëështë faktuar si e vërtet. Më poshtë do trajtojmë disa nga faktorët subjektiv.

4.1. Karakteri dhe Kriminaliteti

Në literaturë psikologjike me termin "karakter" më shpesh nënkuptohet aftësit e një personi i cili i shpreh apo i aplikon ato përballë normave sociale apo shoqërore nga njëra anë, dhe mënyra e kuptimit të ambientit shoqëror të caktuar nga ana tjetër.[36]Karakteri është një ndër vetit kryesore të personalitetit të njeriut. Karakteri konsiderohet si cilësi esenciale e një personaliteti. Kuptimi apo nocioni „karakter"identifikohët me nocionin „personalitet". Kështu në të folurit e përditshëm dëgjohet të thuhet për një njeri se ai është me karakter të fortë ose karakter të dobët etj.[37]Sjelljet e manifestuara nga personi i caktuar është mënyra e vetme që jo vetëm që mund të vrojtohen aftësit apo vetit karakteristike, në të njëjtën kohë dhe vlersohen nga një rreth shoqëror i caktuar që normalisht ka dhe normat e veta, në kuptimin që sjelljet e karakterit të tillë janë pozitive apo negative. Karakteri i një personi eksponohet nëpërmjet një numri të caktuar të aktiviteteve, nëpërmjet qëndrimeve që mban, për zhvillimet shoqërore, në lidhje me idetë, vlerat, cilat nga këto i pranon dhe cka ai merr si shembull për ta ndjekur në jetë.Kjoështë një ndër mënyrat me të besueshme për të studiuar dhe analizuar objektvisht personin në fjalë, i cili varet nga numër më i madh i kritereve sociale si psh sjelljen kundrejt vetvetes, kundrejt shoqërisë më të ngushtë dhe asaj mëtë gjërë, kundrejt natyrës etj.Zgjidhja e mënyrës se si do sillet individi në momente të caktuara duke pasur alternativa të ndryshme , faktivisht është ai tip i caktuar i karakterit i cili demonstrohet në sjellje dhe veprime të vecanta.Disa individi janë konsekuent të vendosur dhe të qëndrueshëm, mirëpo nuk kanë qëndrim pozitiv ndaj disa vlerave dhe rregullave morale. Ata nuk përputhen me etikën e ambientit tëcaktuar, nuk përfillin disa rregulla të mirësjelljes apo disa adete dhe zakone të cilat vlersohen si veti të larta. Në këtë mënyrë lindin kontradita rreth definimit të karakterit në psiklogjinë bashkohore e vecmas rreth elementeve përbërës të kuptimit të karakterit. Karakteri i

[36] Dr.Kralev.T "Kriminologia na nebreznata delikvencija" Viti.1998, Shkup fq.133
[37] Halili.R, "Kriminlogjia" Viti,2002, Prishtinë fq.322

njeriut nërend të parëështë produkt i edukatës. Tiparet e karakterit formohen në procesin e socializimit të njeriut. Në këtë proces, rol dominues kanë familja, shkolla dhe ambienti social.Megjithëse faktet janë kokëfort, disa nga personat që janë konsumues të lëndëve narkotike as nuk rrjedhin nga familje e keqe as mungesë karakteri.Zgjedhja e nje lloj sjellje duke pasur më shumë alternative, paraqet se dëshmon për një lloj të karakterit që posedon një person, i cili ndonjëherë duke u ndikuar nga një numër i madh faktorësh të tjerëmund të bie nën presion të sjelljeve kriminale.Kështu për shembull një struktur antisociale e karakterit i cili ka këto tipare : egoizmin e tepruar, jo tolerancën, agresivitetin, paedukatën në sjellje etj, tipare të cilat në jetën e përditshme nuk ka pse duhet të jenë burim i sjelljeve kriminale, por nëse personi i posedon këto cilësi të sipërpërmendura në rrethana të caktuara apo në shoqëri e cila merret me konsumin e lëndëve narkotike, shumë më leht mund të bëhet pre e grupeve të ndryshme kriminale. Si individ me karakter të fortë cilësohen personat që flasin tëvërtetën , që e mbrojnë të vërtetën, persona që nuk gënjejnë, persona që nuk u nënshtrohen motiveve dhe interesave të ulëta dhe lakmisë materiale. Si persona me karakter konsiderohen dhe personat që janë konsekuentë në qëndrimet dhe pikëpamjet e tyre për ndonjë cështje apo për ndonjë problem.Të atillë konsiderohen edhe individë të cilët me aftësitë dhe fuqinë e tyre angazhohen në gjykimin dhe eliminim e padrejtësive dhe të këqijave të ndryshme ndaj njerëzve të tjerë.Është e rëndësishme që gjatë ndricimit të cdo sjellje kriminale të individit të njihet edhe karakteri i personalitetit të tij individi. Njohja e tipareve dhe vetive të karakterit të kryesit të krimit apo sjelljes tjetër kriminale sic është konsimumi i lëndëve narkotike, ndihmon në ndricimin e shkaqeve të sjelljes kriminale. Kjo është me rëndësi edhe për procesin e rehabilitimit dhe risocializimit të personit të dënuar, apo të personave që janë duke u trajtuar në qendrat e posacme për trajtim të personave tëvarur nga përdorimi i lëndëve narkotike.

4.2. Intelegjenca dhe kriminaliteti

Intelegjenca në përgjithësi definohet si „aftësia për ti gjindur dhe përshtatur në situata të caktuara duke e shfrytëzuar eksperiencat e më përparëm“. Me ndihmën e të cilës sipas psikologëve dhe neuropsikologëve personit i mundësohet që ai të mendoj dhe vet ti përcaktoj

vendimet që do marrë në situata të caktuara.[38]Intelegjenca është një veti me rëndësi e personalitetit e cila ka ndikim të madh në sjelljet dhe veprimet e tij në jetën e përditshme. Intelegjenca në psikologji përkufizohet si aftësi e të menduarit e zgjedhjes së problemeve dhe orientimit të situatave të ndryshme, e ndërtimit të koncepteve abstrakte dhe zgjidhjes së problemeve dhe detyrave që parashtrohen në jetën konkrete të personalitetit. Mendohet se intelegjenca paraqet një aftësi unike, pra ajoështë një tërësi e vetëdijes dhe aftësive të personalitetit.[39] Duke u bazuar në vrojtimin etiologjik të intelegjencës dallojmë dy mendime ekstremisht të ndryshme njeri prej tjetrit. Mendimi i parë ku këtij funksioni psikologjik i jep rëndësi primare zhvillimit të intelegjencës në zhvillimin apo shfaqjen e sjelljeve kriminale, dhe mendimi i dyt i cili e mohon nivelin e intelegjencës si faktor në shfaqjen apo zhvillimin e sjelljeve kriminale.Në brendësi tek mendimi i parë nuk është e vështir të dallohet teza ku si faktor primar të sjelljeve kriminale e shohin intelegjencën. Sipas këtij mendimi niveli i ulët i intelegjencës paraqet faktor të rëndësishëm tek paraqitjet e sjelljeve kriminale, përfaqsuesit e kësaj teze këtë të dhënë e ilustrojnë sipas një studimi i cili thot se 50% e personave që janë dënuar për një sjellje kriminale janë persona më nivel të ulët të intelegjencës.[40]Thelbi i kësaj teorie qëndron tek fakti që personat me intelegjenc më pak të zhvilluar janë më shumë të predispozuar për të shkaktuar sjellje apo veprime kriminale. Arsyja pse ndodh kështu sipas përfaqsuesve të kësaj teorie është se këta persona gjykojnë me më shumë vështirsi, vështir i dallojnë rëndësinë e veprimit të tyre në raport me vlerat shqërore apo ligjet[41]. Gjithashtu niveli i ulët i intelegjencës sipas përfaqsuesve të kësaj teorie sjell edhe deri tek veprimet pothujase të pakontrolluara nga persona te caktuar, ku vlen të theksohet edhe fakti se edhe ndërrmarja e cfardo lloj mase është e vështirë për të pasur rezultat tek persona të cilët nuk e kuptojnë rëndësinë e veprimit të tyre aq më pak qëllimin e dënimit.

Mendimi i dytë mohon të gjitha lidhjet që mund të kenë sjelljet kriminale me intelegjencën e personit të caktuar. Megjithatë edhe pse nuk mund ta përjashtojmë rëndësin e procesit psiklogjik në lidhje me sjellet në vecanti me ato kriminale, nuk duhet asesi që ky proces

[38] Dr.Kralev.T “Kriminologia na nebreznata delikvencija“ Viti, 1998, Shkup fq.125
[39] Halili.R, “Kriminlogjia” Viti,2002, Prishtinë, fq.328
[40] Përfaqsues të këtij mendimi : Ferguson, Burt,Carr-Saunders, Manheim , Bagot, etj.
[41] Dr.Kralev.T “Kriminologia na nebreznata delikvencija“ Viti .1998, Shkup, fq.126

tëvëzhgohet apo studiohet vecmas pa mos e lidhur me faktorë të tjerë sic mundë të jenë faktorët familjar, shoqëror, motivet e ndryshme etj. Nga niveli i intelegjencës varen edhe kushtet dhe mënyra e jetës. Në të vërtetë në masë të konsideruar suksesi në jetë, në mësime, në studime, në punë, aftësia e të kuptuarit të situatave, proceseve dhe raporteve të tjera, varen nga shkalla e intelegjencës.Persona të cilët kanë aftësi që këto procese dhe situata ti zgjedhin në mënyrë të favorshme , më pak vijnë në situatë të merren me veprime dhe me sjellje delikuente. Në raste të caktuara, pikërisht intelegjenca e zhvilluar mund të përdoret apo mund të jetë faktor kyc në kryerjen e nje veprimi kriminal.

4.3. Motivet Sociale

Si motive sociale karakterizohen të gjitha ato shtytje a nxitje dhe nevoja që nuk janë të lindura dhe që nuk janë të karakterit anatomiko-bilogjik, por të cilat fitohen në procesin e zhvillimit, formimit, edukimit dhe përsosjes së individit në shoqëri. Në shoqërinë tonë ashtu si dhe në shumë shoqëri të tjera në lidhje me gërshetimin e gjinive, gjinija mashkullore është ajo që ka përparsi, edhe pse disa zakone tradiconale po pësojnë ndryshime. Ky lloj vlersimi apo një lloj hierarkie e shoqëris paraqet për prindërit dhe për shoqërinë e gjërë që të aplikojnë metoda të ndryshme edukative socio-kulturore tek personat e gjinive të ndryshme gjatë procesit të rritjes së fëmijëve por edhe mbas këtij procesi. Zakonisht fëmijët e gjinisë mashkullore të edukohen në atë mënyrë që ato të kenë më pak hapsir apo mundësi për të folur për ndjenjat dhe emocionet e tyre, dhe kjo sjell deri aty sa tek persona të caktuar humbin përfundimisht aftësin për të njohur emocinet e tyre. Edukohen në atë mënyrë ku duhet të jenë më të guximshëm, të durueshëm, të mësohen që vetë ti kalojnë problemet, konfliktet e brendshme, krizat emocinale etj. Duke marrë parasysh që fëmijët të gjinisë mashkullore pregatien që në jetë të jenë ato bartësit e pergjegjësive në formimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e familjes, kërkesat dhe pritshmërit nga shoqëria janë më të larta po më të mëdha. Mund të thuhet që pikërisht kjo lloj qasje e asaj që u përmend më sipër mund të sjellë deri aty sa persona të caktuar të ndjejnë njëfar lloj frike dhe të stopohet procesi i pjekurisë apo zhvillimit normal, duke kaluar direkt tek faza ku mund të quhen të rritur.

Ndarja tradicionale e roleveluan një rol shumë të madh në vlersimin e gjinive te ndryshme në një shoqëri. Meqënëse në shoqërinë tonë gjinia mashkullore vlersohet më shumë, meshkujt janë më lartë në hierarkin shoqërore dhe kanë forcën për të marrë vendime si në shoqëri ashtu edhe në familje. Ky fenomen ndikon tek rritja e pritshmërisë nga ana e meshkujve. Shumë persona të rinjë duke u „trembur“ nga përgjegjsia apo nga pritshmërit e mëdha, devijojnë nga rruga normale e zhvillimit dhe e gjejnë strehimin apo kushtimisht thënë shpëtimin tek konsumimi i ndonjë nga lloj i narkotikëve. Në shoqëritë apo kulturat ku kërkohet nga të rinjtë një pavarsi socio-ekonomike të shpejtë me automatizëm rritet niveli i stresit, depresionit dhe frikës, mbi të gjitha nga e ardhmja e pasigurt dhe gara për mbijetes me të rriturit. Në kulturat ku vazhdohet dhe mbështetet jo pavarsimi socio-ekonomik i shpejtë i të rinjve, mund të paraqitet si fenomene sjelljet e indiferencës, mosinteresimit dhe frika nga marrja e përgjegjësive tek të rinjtë. Sa i përket shoqëris sonë ka elemte nga të dy palët e përmendura më lartë. Më poshtë do pasqyrojmë disa nga fenomenet që janë aktuale në Reublikën e Maqëdonisëqë sipas mendimit tim ndikojnë në rritjen apo zvoglimin e numrit të përsonave përdorues të lëndëve narkotike, kjo duke u bazuar në funksionalitetin e këtyre dukurive.

a) Shoqëria në tranzicion

Proceset në tranzicion në shqërin tonë sollën në ndryshime ekonomike dhe socilae në shoqërin tonë. Shumëllojshmëria dhe shpejtësia e ndryshimeve në të gjitha shtresat e shoqëris solli dhe ndjenjën e frikës, pasiguris dhe jo koherencës. Për këtë arsye njerzit apo shoqëria në tranzicion jan nën stress të vahdueshëm dhe në pritje të vazhdueshme që edhe ajo pak “vler” që ka mbetur do ti nënshtrohet ndryshimit.

b) Pasiguria ekonomike dhe ekzistenciale

Ndryshimet ekonomike në Republikën e Maqëdonisë sollën dhe rritje shumë të lartë të papunësis, lëshim nga puna, pafuqia ekonomike në nivel familjar, pasiguria egzistenciale ku ndodhi që shumë familje ishin në pragun e egzistencës.

c) Ndryshimi i shpejtë i sistemit të vlerave

Sistemin e vlerave që ishte dhe qëi njëjti deklarativisht mbrohet dhe përfaqsohet shumë shpejt iu nënshtrua ndryshimit (mësimi, studimi, vlersimi i mundimit intelektual). Sjelljet amorale por edhe ato kriminale të shtresave të caktura të shoqërisë dhe mosndëshkimi i tyre aq më tepër e ndrydhën rrethin e vlerave morale dhe shoqërore. Ky lloj i ndryshimeve dhe kjo mënyrë e sjelljes së shoqërisë dhe shoqëria si tërësi vetëm se e sjellë popullin vecanërisht të rinjtë në një dilem shumë të madhe në atë se cka është e mirë, cka është e keqe, cfarëësht mirë të bëhet cfarë nuk është mirë.

d) Dobësimi i kontrollit social

Me kontrollin social nënkuptojmë procesin i cili vendos standarte dhe rend në shoqërinë sociale. Ajo mundëson që person i caktuar të sillet në mënyrë të caktuar në një rreth shoqëro-kulturor të caktuar. Për fat të keq në Republikën e Maqëdonisë kontrolli social është dobësuar shumë dhe së fundmi më shumë shihet interesi personal i personave se sa e mira e përgjithshme. Kështu që solidariteti është pothuajse inekgzistent dhe kjo sjellë që persona të caktuar të mos kenë ndihmën nga shoqëria kur ai ka nevoj sidomos nevoj për mbështjetje emocionale, dhe kjo vështirson funksionimin normal të një personi dhe pastaj të një shoqërie.Me dobësimin e kontrollit social rritet mundësia e përdorimin të lëndëve narkotike sidmos nga personat adoleshent.

e) Ngjarjet dhe Zhvillimet Stresuese

Ngjarjet e pazakonta jo stabiliteti ekonomik dhe ai shoqëror në afërsi të shtetit tonë ka qënë e pranishme 10 vjet, para se të njëjtat të ndodhin dhe tek ne. Ku më vonëishim pjes e një konflikti të armatosur në Republikën e Maqedonisë. Kjo dmth që të gjithë ne kemi qënë të shqetsuar dhe të stresuar nga lufta dhe jo stabiliteti shoqëror dhe ai ekonomik këtu duke vënë theks të vecantë dhe të rinjve për një periudhë prej gati 10 vjecare po jetojmë në një farë stresi kronik.

Përhapja mëmasive e keqpërdorimit të lëndëve narkotike më shumë rritet në fazat postraumatike tek një shoqëri.[42]

Kur flitet për motivet si veti subjektive ato gjithmonë trajtohen si faktorë të cilët ndikojnë në ndricimin e sjelljeve kriminale dhe duhet të vështrohen në një lidhshmëri të kushtëzuar me faktorë të jashtëm.[43]

5. Efektet personale tek vet përdoruesi i lëndëve narkotike (narkomanët)

5.1. Pamja e jashtme

Njohja e një narkomani sipas pamjes së jashtme, sipas sjelljes që ai paraqet si në rrugë ashtu dhë në ndonjë vend tjetër ku narkomanët e kanë vend takimin e tyre është teje e vështir, vecanërisht kur narkomani me vete ka sasi të konsiderueshme të drogës, kur ai mund tja lejojë vetes konsumin e drogës pa ndonjë vështirsi për ta pasur atë, dhe kur nuk vuan nga mungesa e saj. Duhet theksuar se narkomanët janë "aktor" shumë tëmirë për sa i përket mos rënies në sy tek shoqëria dhe mjedisi ku ai jeton sidomos në fillimet e tij kur integriteti personal nuk është fare i cënuar. Mosha e narkomanëve varen nga mosha 13 dhe 15 vjec nuk bëjnë përjashtim dhe ato të moshës 12 vjecare.Në fillim konsumojnë vetëm nga kureshtja, kjo nuk dmth se ai do bëhet i varuar nga droga nga ai cast , mirëpo me vazhdimin e kësaj "kënaqsie" momentale pasi ta mbërrij moshën 25 vjecare atëher narkomani nuk përdor vetëm një tip të drogës, ai përdor më shumë lloje deri sa të vijë deri tek e "vërteta". Përgjithsisht narkomanët ndërmjet veti thirren me sinonime të ndryshme dhe këtë e bejnë për dy arsye: e para për të mbrojtur identitetin e vertet të tyre, dhe arsyja e dytë për tu solidarzuar ndërmjet veti dhe duke e legjitimuar largimin nga pjesa tjetër e shoqërisë që sipas tyre po jetojnë një jetë shumë të mërzistshme.

[42] Dr.Gajdasic-Knezhevic Slavica, Acc.dr. Ignjatova Liljana, Paqoska Natka, „ Tretmani dhe parandaliimi i dëmeve nga keqpërdorimi i drogave" Viti , 2005, Shkup fq.42
[43] Milutinovic M.vep.e cit. fq.458

5.2. Zënkat me prindërit

Bashkangjitur faktit të sjelljes së pazakonte asaj të jashtme dhe të brendshmë, zënkat, konfliktet dhe ndërpreja e kontakteve me prindërit, janë tregues shtesë se dicka po ndodh me personalitetin e personit në fjalë.Orët e para të diskutimeve inelektuale ku pretendohet që njeri i moshës së re nuk është pranuar nga gjeneratat e vjetra dhe nga mendimet e tyre konservative janë tentimet e para që përdorimi i dorgës të vihet në plan të dytë. Këto diskurse me fjalor intelektual duke pretenduar të nxirren nga situata si viktim e mendimeve konservative nga prindërit që nuk po e kuptojnë botën e tij sa vjenë dhe po përkeqsohen. Shumë shpesh këto diskutime eskalojnë duke dashur të tregohet dhe forca fizike duke shkuar deri aty sa i riu mund te kërkoj dhe përpalsje fizike me prindin. Të gjithë këtë narkomani e bënë si pasojë e problemeve personale të tija që ka me drogën dhe varësis nga saj. Ai vazhdimisht do mundohet të arsyetohet dhe problemin kryesor i cili është droga ta vër në plan të dytë si të parëndësishëm dhe si krejt normal. E gjitha kjo lloj sjellje dhe këto veprime nga narkomani kundrejt prindërve të tij mund të jetë njëfar qortimi apo hedhje fajin prindërve ku narkomani pretendon që kur ai ka pasur nevojë nuk ka pasur interesimin e prindërve për plotësimin e nevojave të tij si ato shpirtërore ashtu dhe ato materiale, për këto arsye ai është bërë narkoman.Konfliket verbale, konfroktimet e nxehta tek narkomanët bëhen për një arsye shumë të thjesht, që ai të mundë të dal nga situata për të përdorur një gënjështër të radhës.Ato gënjejnë dhë që të jenënë sinfoni të drejtë me ndërgjejgen e tyre. Duke vazhduar praktikën e gënjështrës narkomanët gënjejnë të gjithë, shokët, prindërit, shkojnë deri aty sa gënjejnë dhe personat e ligjit, me të vetmen arsye që ti ikin përgjegjësisë.Kjo nuk dmth që narkomani nuk është i gatshëm për bashkëpunim, vecanërisht kur para tij ka person tek i cili ai mund të ket besim, person ku ai i ka besuar dhe më herët tek kontaktet e tyre të mëhershme. Pororsia që do të doja ta dërgoj deri të të gjithë prindërit është : ka ardhur koha që problemin me drogën ta trajtoni më seriozisht dhe jo domosdorisht pasi të prekeni nga ajo në njërën apo tjetrën mënyrë.

5.3. Ndërpreja e shkollës

Asnjëra nga shenjat e para apo sindromat e jashtme qëmanifestohet teki riu që vecse ka filluar të konsumoj lëndë narkotike, se sa lënja e mësimit apo e shkollës. Tek nxënësi narkoman, lënja e orëve më shpesh, mos interesimi total për mësimin dhe ajo cka ndodh gjatë mësimit, janë shenjat më të dukshme dhe shumë lehtë të verfikueshme. Me interes janë dhe arsyetimet që bëjnë nxënësit narkoman kundrejt prindërve të tyre dhe atë të tipit: profesorët më urrejnë, vetëm mua më detyrojnë të mësoj, më bëjnë pyetje të vështira qëllimisht, nuk jamë për atë shkollë etj. E keqja më e madhe ndodh atëherë kur prindërit do të bien pre e gënjeshtrave të fëmijëve të tyre, në vend se të fillojnë interesimin mëdetaisht , duke u konsultuar me profesorët e shkallës përkatëse, me psikologun, sciologun etj.[44]

6. Siguria shoqërore,ulja e dëmeve dhe shkalla e rrezikshmërisë nga përdoruesit e lëndëve narkotike

Programet për uljen dëmeve nga përdoruesit e drogave në Republikën e Maqedonisë daton që nga viti 1996, atëherë kur Asocacini për aktivitet multikulturor “MASKA” e hapi programin e parë shkëmbim të mjeteve për injektim, të cilën vitin tjetër e vazhdojë organizata Opsine për jetë të shëndetshme në Shkup , (HOPS). Prej atëherë në Maqedoni ekzistojnë gjithsej 16 programe për uljen e dëmeve nga droga, nga të cilat 4 ndodhen në qytetin e Shkupit dhe nga një program për 13 qytete të tjera. Programet për uljen e dëmeve nga përdorimi i drogave në Republikën e Maqedonisëështë karakteristik si pasojë e multifunksionalitetit të tyre, gjegjësisht ato ofrojnë më shumë shërbime në një vend dhe atë: mjete të sterilizura për injektim, prezervativ, shërbime nga personeli mjeksor, puntor social, puna në teren, testimi i HIV dhe Epatit C, ndërsa në 6 qytete ofrohet pa pagesë dhe ndihma e parë. Pikërisht për arsyet e lartpërmendura programi për uljen e dëmeve janë të njohura për efikasitetin e tyre jo vetëm në Republikën e Maqedonisë por edhe ne rajon, numër shum i lartë i studimeve të rasteve janë realizuar në Maqedoni me ndihmë të programës për uljen e dëmeve nga droga ku studiues nga shtete të ndryshme kanë ndjekur nga afër aktivitetin e programit për uljen e dëmeve nga droga, dhe kanë asistuar në përmisimin dhe rritjen e efikasitetit të programit. Përvec qytetit tëShkupit

[44] Dr- Tomovski Boshk , “ Droga bolest na deneshnicata” Vitti, 1998, Shkup, fq. 23

qëështë bashkfinansues në njërën nga qendrat e programit për uljen e dëmeve nga droga (angazhimi i dy personave si kordinator, dhe puntor social, si dhe shpenzimet për qiran e objektit ku është e lokalizuar qendra), të gjitha qendrat e tjera të programit dhe aktivitet e tyre finansohen nga Fondi global i luftës kundër SIDËS, turbekulozës dhe malarias, mbështetje e cila mbaroj në Dhjetor të vitit 2016.Në këtë moment kontuiniteti i këtyre programeve është i pasigurt për arsye të mos sigurimit të mjeteve financiare, pas mbarimit të mbështetjes nga Fondi global. Për këtë arsye HOPS bëri një analizë të programeve për uljen e dëmeve nga droga me qëllim për gjetjen e një mënyre për vazhdimin e aktivitetit të këtyre programeve në aspektin e finansimit dhe vazhdimsin e qëllimit të programit, duke propozuar dy modeled dhe atë: modeli parëështë modeli minimal i cili do ofroj vetëm shërbime minimale dhe më mjete finansiareminimale , dhe modeli optimal i cili do ofroj shërbime optimale me numër optimal të shërbimeve dhe me mjete financiare optimale.[45]

6.1 Efikasiteti i programeve për uljen e dëmeve nga përdorimi i drogës

Ekzistojnë një numër i madhë studimesh që tregojnë efkiasitetin pozitiv të programeve për uljen e dëmeve nga droga, mbi të gjitha në parandalimin e HIV dhe hepatitit C, dhe ulja apo kufizimi i sjelljes teje të rrezikshme nga personat përdorues të drogave.Nga studimi i realizuar i Organizatës ndërkombëtare për zgjidhjen e problemeve shëndetsore (Health Outcomes International) nga viti 2002, e shtrirë në 103 qytete në 24 shtete , nga të cilat në 36 ka pasur program për shkëmbim të paisjeve të sterilizuara për injektim, tek 67 të tjerat nuk ka pasur kështu lloj programi, e vërtetuar është se: mundësia për tu përhapur virusi HIV është zvogëluar me 18.6% tek vendet ku ka program për shkëmbim të paisjeve të sterilizuara për injektim, ndërsa tek qytetet ku nuk ka program ka rritje të mundësisë të përhapjes së virusit HIV për 8.1%. Një tjetër studim i realizuar nga Harli i vitit 1997 sa i përket përhapje së virusit HIV tek personat që injektojnë Drogë në 52 qytete të ndryshme ku nuk ka pasur program për shkëmbim të paisjeve te sterilizuara për injektim dhe 29 qytete ku ka pasur program si në: Azi, Evrop, Amerika Veriore, Amerika Jugore etj. Mesatarisht mundësia e përhapjes të virusit HIV te qyteteve ku nuk ka pasur program për shkembim të paisjeve për injektim ka qënë më shumëpër

[45]Dekov.V , " Idninata na programite za namaluvanje na shteti od upotreba na drogi vo Makedonija" Viti, 2015, Shkup fq.10

5.9%, ndërsa tek qytetet ku ekziston programi për shkëmbim të paisjeve për injektim vërehet zvogëlim i mundësisë së përhapjes së virusit HIV me 5.8% në nivel vjetor.Në Maqedoni, efikasiteti i programit për shkëmbim të paisjeve për injektim është i dokumentuar.Nga viti 1987 deri në vitin 2014 gjithsej janë të regjistruar 239 raste të VIV\SIDA.Nga të cilët vetëm 12 janë persona të cilët kanë injektuar drogë.Në 10 vitet e fundit periudhë kur janë hapur më shumë qendra të programit për shkëmbim të paisjeve për injektim janë shënuar vetëm 4 raste më që kanë fituar virusin HIV si pasoj e injektimit të drogës, 8 rastet e tjera janë regjistruar para se të ekzistojë programi për shkëmbim të paisjeve për injektim. Nga ana tjetër këmbanat e alarmit po bien për Maqedoninë dhe atëjo nga shumë larg por nga Greqia dhe Romania. Pas përfundimit të finansimit nga ana e Fondit global të programeve për uljen e dëmeve nga droga shihet një numër në rritje të rasteve sidmos të injektimit më HIV.Psh në Romani pas largimit të Fondit global që finansonte luftën kundër HIV/SIDA , turbekulozë dhe malarian, u mbyllen një numër i konsiderueshëm i programeve të shkëmbimit të paisjeve për injektim. **Kjo rezultoj me rritjen e numrit të rasteve me HIV dhe atë nga 28 raste për periudhën 2007 deri vitin 2010. Në362 raste të reja për peridhën 2011 deri 2012.!!**

6.2 Arsyetimi financiar

Në përputhje me nevojën për të ruajtur shërbimet dhe aktivitetet e kryera programe për të zvogëluar dëmin në Maqedoni , mundësitë për reduktimin eventual të fondeve janë minimale. Në këtë drejtim një reduktim të mundshëm mund të ketë sa i përket shpenzimeve administrative dhe ato të personelit të cilët nuk janëtë përfshirë drejtpërdrejtë në organizimin apo zbatimit e programit. Mirëpo ky lloj i stafit ekziston në një numër të vogël të organizatave, ndërsa në shumicën e organizatave i gjithë stafi është i përfshirë në zbatimin e programit**.**Në Maqedoni ka 3 modele të ndryshme të programeve: HOPS që ofron një gamë të gjërë shërbimesh (shkëmbimi i pajisjeve sterile të injektimit,prezervativët, shërbimet e një punonjës social, mjek, psikiatër, avokat) 3 drop-in qendrat dhe shërbimet me automjete, modeli i dytë janë të gjitha organizatat e tjera, pa zgjedhjen e Strumicës dhe Via Vita Manastir, të cilat ofrojnëshërbime standarde - shkëmbimi gjilpërë, prezervativët, shërbimet e një punonjës social dhe një person mjekësor në një qendër drop-in dhe punë në terren. Modeli i tretëështë Zgjidhja

e Strumicës dhe Via Vita Manastir, si një kombinim i modelit të parë dhe të dytë.Në përputhje me llogaritjet, lartësia minimale për të gjithë 16 programet ekzistuese për zvogëlimin e dëmeve në Maqedoni arrin 445,525 euro, me angazhim me kohë të pjesshme të personelit, gjegjësisht shumën prej 514,033 euro e arrin nëse i gjithë stafi do punësohet në vend që të jenë me kohë të pjesshme. Modeli optimal arrin shumën prej 502,330 euro, me angazhim të pavarur të personelit, ose 566,902 euro nëse i gjithë stafi të punësohet me kohë të rregullt.

Modeli i minimumit përfshinë të gjitha shërbimet e ofruara nga programi aktual me shpenzimet administrative të reduktuara të cilat nuk kanë lidhje direkt me programit dhe reduktimet e stafit aty ku është e mundur, kjo është në programet e HOPS, zgjedhje nga Strumica dhe Via Vita Manastir. Ka dy variante të modelit minimal: të paguajnë tarifë (mujre, vjetore etj.) dhe variant i dytë është punësimi i të gjithë palëve që janë të angazhuar.Modeli optimal përfshinë të gjitha shërbimet e ofruara nga programi aktual me kosto të reduktuara administrative që nuk kanë lidhje tëdrejtpërdrejt me programin, në këto programe ka dhe reduktim të personelit, por rënia është në shkallë të vogël.Si përfundimna mbetet të shpresojmë se njerëzit që do të krijojnë buxhetin e shtetit për vitin 2017, si dhe politikanët të cilët duhet të votojnë për buxhetin do të jenë human dhe të përgjegjshëm, dhe do të përfshijnë Programet për të zvogëluar dëmin nga përdorimi i drogës në buxhetin kombëtar, dhe kështu do të ndihmojnë shumë familje në Maqedoni që përballen me problemin e varësis nga drogat e ndryshme.

6.3.Droga, vdekshmëria në mesin e përdoruesve të drogës sipas statistikave zyrtare.

Në republikën e Maqedonisë regjistrimin e vdekjeve si pasojë e përdorimit të drogave të ndryshme e bëjnë : Regjistri i Policisë në kuadër të punëve të brendshme, Regjistri i Përgjitshem i vdekshmëris pranë Zyrës së Statistikave Kombëtare dhe Instituti i Mjekësis Ligjore. Mirëpo për të qënë informacioni më i saktë përvec burimeve të lartë përmendura si burime shtesë në lidhje me vdekshmërinë në Republikën e Maqedonisë dhe arsyet e saj, janë edhe: Instituti i Mjeksis Ligjore, Kriminologjia dhe Mjeksia Deontologjike pranë Fakultetit të Mjeksis në Shkup, Instituti i Mjeksis Ligjore në Shkup, Instituti i Mjeksis Ligjore në Manastir dhe Tetovë.

Në vitin 2011 ka pasur 14 vdekje të lidhura me drogën, duke përfshirë dhe nje femër.Në vitin 2012 ka pasur 18 raste nga ku kanë qënë 5 femra. Në vitin 2011, personi më iri që ka vdekur nga mbidoza ka qënë 18 vjec, ndërsa më i moshuari ka qënë 40 vjec. Në vitin 2012 personi më i ri ka qënë 17 vjec , ndërsa më i moshuari ishte 41 vjec. Në vitin 2011 shumica e vdekjeve të lidhura me Drogën (DRD) kanë qënë nga 25-29 vjec ose (35.7%) të pasuar nga ata të moshës 20-24 vjec ose (28.6%). Në vitin 2012 shumica e vdekjeve të lidhura me Drogën kanë qënë 35-41 vjec se (33.3%) , pasuar nga ata të moshës 30-34 vjec ose (27.7%).

Në vitin 2011, 4 vdekje kanë qënë të lidhura ose janë shkaktuar si pasojë e mbidozës me opiate, 9 raste me metadon nga ku në 4 raste ajo ka qënë e përzier me benzodiazepinat.Një vdekje është regjistruar si pasojë e mbidozës me Kokain. Në vitin 2012 shumica e vdekshmërisë në lidhje me Drogën ose më saktë 55.5% janë shkaktuar si pasojë e dehidrimit me metadon dhe benzodiazepinëgjithsej 10 raste, 4 vdekje janë shkaktuar nga mbidoza me metadon dhe dy të tjera nga dehidirimi si pasojë e opiateve, 2 të tjerat poashtu si pasojë e dehidrimit nga mbidoza e amfetaminës.

Analiza e të dhënave nga pika qëndrore kombëtare tregon që ka një ndryshim sa i përket vdeshmërive të lidhura me Drogën, ku shihet një rritje e numrit të vdekjeve të lidhura me drogën tek gjinia femërore ne këto vitet e fundit. Nëse arsyja kryesore për vitet 2007-2010 ka qënë mbidoza me Heroinë, për vitet 2011-2012 shifrat tregojnë se mbidoza me Metadoni është bërë opiumi më i përhapur në vdekjet e lidhura me drogën.Megjithatë shkalla e ulët e autopsisë dhe ekzaminimet toksilogjike të kufizuara e bëjnë të vështir vlersimin dhe interpretimin e numrit të saktë të vdekshmërive të lidhura me drogën. Gjithsesi mendoj se tanimë kemi një pasqyrë se saështë shkalla e rrezikshmëris nga përdorimi i jashtligjshëm i drogave të ndryshme.[46]

[46] Europian Monitoring Centre for Drug and Addiction , Shtator 2013

KAPITULLI I TRETË

ROLI I ORGANEVE POLICORE, GJYQËSORE DHE INSTITUCIONEVE TË TJERA NË VLERSIMIN DHE PARANDALIMIN E VEPRAVE PENALE SI PASOJ E KONSUMIMIT TË LËNDËVE NARKOTIKE

1. Roli i policisë së Maqëdonisë në vlersimin dhe parandalimin e kriminalitetit

Vlersimi i kërcënimeve që vijnë nga kriminaliteti i organizuar paraqet një raport strategjik detyrë e të cilit është për të identifikuar rreziqet e tanishme, të vendos prioritetet dhe të propozj aktivitetet e ardhshme, për eliminim ose zvogëlimin e rrezikut.Kriminaliteti serioz dhe i organizaur përfaqson kriminalitetin më të rrezikshëm i cili kërcënon sigurinë kombëtare ose shtetërore, ekonomin, sundimin e së drejtës, demokracinë etj. I njëjti është dinamik, fleksibil që përfshin një numër të madh të krimieve të ndryshme njëkohësisht i lidhur më biznese legale. Parandalimi dhe mbrapsja e krimit të organizuar dhe serioz në masë të madhe varet nga njohja e tërësishme të këtij fenomeni, duke përfshir dhe pasojat që len pas ky llojë i aktiviteti kriminal. Vlersimi para së gjithash, ju vjen në ndihmë hartuesve të politikave dhe ekzekutuesve të saj, agjencineve që merren me këtë problematik, gjithashtu të gjithë palëve të interesuara në luftën kundër krimint të organizuar, sidomos krimit transnacional në kohën e një globalizmi ku pikat kufitare nuk përbëjnë më një pëngesë serioze për krimin e organizuar. Njëkohësisht vlersimi do ndihmoj në ndërmarrjen e iniciativave për të qënë sa më efikase në ndikimin kundër krimit serioz dhe tëorganizuar, me qëllim përmisimin e mundësis për parandalim, intervenim dhe bashkëpunim, për të garantuar siguri, për të rritur besimin tek institucionet, dhe mbrojtje efikase të shoqërisë. Vlersimi nacional i Republikës së Maqedonisë kundër krimit të organizuar është i përpiluar në kornizën e projektit " Fortësimin e kapaciteteve për analizë strategjikedhe përpunimi i vlersimit të kërcënimeve nga krimi serioz dhe i organizuar në Republikën e Maqedonisë dhe Malit të Zi".Ky vlersim paraqet versionin publik të Strategjisë Nacionale të vlersimit të kërcënimit nga krimi i organizuar dhe serioz. Përkrah këtij versioni i përpunuar

është dhe versioni i klasifikuar e cila është e destinuar vetëm për vendim marrësit në Ministrin e punëve të brendshme.[47]

1.2.Objektivat dhe Detyrat

Vlersimi nacional i kërcënimeve nga krimi i organizuar përpunohet me kërkes të udhëheqjes së Drejtorisë për siguri publike.Llojet e kriminaliteit të cilat analizohen vë vlersimin, janë të vërtetuara në Vlersimin Strategjik të Drejtorisë për siguri publike e prezentuar para një grupi Strategjik për dhënien e vendimeve në lidhje me krimin e organizuar.Për përpunim e Vlersimit strategjik mbi rrezikun nga krimi iorganizuar formohet një grup në Drejtorinë për siguri publike i përbër nga analist të cilët janë të trajnuar në seminare të ndryshme për këtë problematik.Gjithashtu ekspert nga EUROPOLI e monitorojnë të gjithë procesin dhe punën e përpilimit të Vlersimit Strategjik të rrezikut nga krimi i organizuar.Vlersimi nacional i vlersimit nuk e përfshinë terrorizmin si pjesë e vecant e krimit të organizuar. Gjithashtu vlersimi nuk e përfshin larjen e parave dhe korrupsionin si lëndë e vecant e kriminalitetit.

1.3. Grupet e Organizuara Kriminale

Grupet e organizuara kriminale janë të involvuar në tregtim të paligjshëm të drogës, amfikimin e emigrantëve, krime serioze si në shtet dhe jashtë tij. Përafërsisht 26% e grupeve kriminale janë gjysëm kriminale dhe operojnë në më shumë fusha të kriminalitetit. Lidhje ndërmjet antarve të grupit kriminal më shpesh është në bazë të lidhje familjare dhe shoqërore. Më shumë se gjysma e grupeve kriminale janë të madhësis të mesme nga 5 deri më 14 antar. Mjetet financiare të fituara nga kriminaliteti lahen nëpërmjet investimit duke hapur biznese apo edhe duke financuar biznese aktive legale në tregun e punës. Karakteristik tjetër e grupeve të organizura kriminale është edhe përhapja e korrupsionit sidomos tek nënpunësit shtetëror me qëllim aplikm të ligjit në formën më të butë dhe në disa raste anashkalim total.

[47] Republika e Maqedonisë, Ministria e punëve të Brendshme, Drejtoria për siguri publike „Vlersimi i kërcënimeve nga kriminaliteti i organizuar dhe serioz”, Viti, 2016 , nr 22.4/875 fq.7.

1.4. Tregtimi i paligjshëm i drogës

Republika e Maqedonisë para së gjithash është një vend tranzit, më pakështë vend ku deponohet droga, akoma më pak vend ku prodhohet ajo, për nevojat e tregut të brendshëm dhe atij të jashtëm. Tregtia me lëndë narkotike është shumë dinamike, ku vecse janë vendosur praktikat e dërgesave të më tepër llojeve të drogës të ashtuquajtuara **"dergesat koktel"**gjithashtu nuk bënë përjashtim dhe aktiviteti kriminal i llojeve të ndryshme.Numri më i madh i organizatave të identifikuara janë organizata gjysëm kriminale të cilat janë të involvuara në tregtin e paligjshme të drogës, ku me mjetet financiare të fituara finacnojn apo i investojnë në bizese legale, me qëllim të pastrimit të parave.Tregtimi i paligjshëm i drogës është një ndër aktivitetet kriminale më fitim prurës, ku janë të përfshir numri më i madh u grupeve kriminale.Republika e Maqedonisëështë shteti transit ku kalon një pjesë e mirë e transportit qëështë i destinuar për në vendet Europiane.Gjithashtu Maqedonia nuk bënë përjashtim edhe si shteti ku droga kultivohet dhe përdoret. Prezenca e lëndëve narkotike në narko-tregun e Maqedonisë shihet qartë nga sasia e kapur e drogës ku pjesa më e madhe është Kanabisi dhe Heroina.[48]

1.4.1 Tregu i Heroinës

Tregu i Heroniës në Evropë përjetoj një balancim.Me antarsimin e disa shteteve të Evropës Juglindore në Bashkimin Europian, gjithmonë më shumë mbetet aktive pjesa perëndimore e Ballkanit.Pjesa më e madhe e Heroniës që në Maqedoni nga Turqia që hyn nëpërmjet Greqis dhe Bullgaris transportohet deri tek destinacinet përfundimtare në vendet perëndimore të Bashkimi Europian, një pjes e vogël mbet në narko-trafikun e Maqedonisë.

1.4.2 Tregu i Kokainës

Prodhimi global i Kokainës gjeneralisht është në rënie, koridori i Ballkanit sa vjen e më shumë mbet si zgjidhje sekundare si vend transit për në Evrop. Tregtimi i Kokainës nuk paraqet rrezikshmëri në Repubikën e Maqedonisë, për arsye se cmimi është shumë i lartë dhe kërkesa

[48]Republika e Maqedonisë, Ministria e punëve të Brendshme, Drejtoria për siguri publike „Vlersimi i kërcënimeve nga kriminaliteti i organizuar dhe serioz", Viti, 2016 , nr 22.4/875 fq.7.

në narko-tregun e Maqedonisëështë e ulët. Në Maqedoni Kokaina mbërrin në sasi të vogël nëpërmjet porteve të regjionit, nga Amerika Jugore , Hollanda dhe Belgjika.

1.4.3. Tregu iMarihuanës

Regjioni i Ballkanit përjetoj ekspazoin të tregtimit të paligjshëm të Marihuanës. Rruga që përshkon tregtimi i Marihuanës është: nga veni i origjinës qëështë Shqipëria, nëpërmjet Maqedonisë ajo arrinë deri në Greqi, Sërbi, Kosov, dhe Bullgari. Me rritjen e operacioneve policore kundër kanabisit në Shqipëri dhe sasia e Marihuanës në narko-trafikun Maqedonis sa vjen dhe pakësohet, fakt ky që qon në rritjen e cmimit i cili rritet dita ditës. Për arsye të kontrollit jo të mjaftueshëm, Maqedonisë i kanoset rreziku shumë serioz nga Marihuana.

1.5 Heroina

Vështrim global – Nga prodhimi total i opiumit i cili për vitin 2014 ka qënë diku 7.554 ton, 85% e sasis janë prodhuar në Afganistan.[49]Prodhimi i Heroinës është në rritje dhe pritet që stadi përfundimtar të përfundoj në Evrop. Në Evrop, Heroina hyn nëpërmjet vendeve transit, Ballkani Perëndimor dhe Jugor të cilat po përjetojnë modifikime. Rruga ballkanike po humb nga aktualiteti i saj dhe po bëhet përpjekje për gjetjen e rrugëve të reja nëpërmjet Europës Perëndimre.Për furnizim më Heroinë akoma aktuale është rruga Ballkanike e cila është e ndarë në perëndimore, jugore dhe lindore.Kjo rrugë shërben për dy aspeke e para për mbetjen e Heroinënë Ballkan dhe e dyta si vende tranzite për në Europë. Me antarsimin e disa shteteve të Evropës lindore në Bashkimin Europian , rruga ballkanike e Heroinës pësoj disa modifikime, gjë që qoj deri tek aktiviimi i pjesës perëndimore.

Republika e Maqedonisëështë pika tranzite nga e cila kalon rruga Ballkanike perëndimore e trafikimit të jashtligjshëm të drogës. Në Maqedoni nuk është gjetur prodhimi i opiumit, ndërsa afini për arsye mjeksore dhe e kontrollluar prodhohet dhe kultivohet në pjesën lindore të vendit. Pjesa më e madhe e Heroinës kalon nëpërmjet Maqedonisë vetem në formë tranziti, një pjes ndalohet për tu ripaktetuar dhe për ndryshim të kualitetit që më vonë e njejta të lëshohet në shtijte ilegale për tek destinacini i fundit, ndërsa një pjes mbetet në Maqedoni për konsum

[49] (UNODC) 2015

tëbrendshëm në rrethe të caktuara.Sasit e ndaluara dhe të kapura të Heroinës nga autoritetet shtetërore të Maqedonisë për periudhën 2013 dhe 2014 shohin një rënie dhe atë nga sasia totale e ndaluar**41 deri 45 kg , 91%** kanë qënë të destinuara për tregun ndërkombëtar. Karakteristike është së për cdo ditë më shumë shtetas të Republikës të Maqedonisë përfshihen në tregtimin ilegal të lëndëve narkotike dhe atë në shtete si Austria dhe Gjermania.Tregu ilegal i Heroinës në Maqedoni është stabil.Cmimi i Heroinës si drogë e dytë më e kërkuar dhe gjendur në Maqedoni për një periudhë më të gjatë ka qënë stabil. Në vitin 2015 cmimi ka pësuar një rritje si rezultat i rritjes së cmimit tëHeroinës në Turqi.

1.6.Grupet e Organizuara Kriminale

Grupet e organizuara kriminale në Maqedoni organizojnë transportin e Heroinës me destinacion shtetet e Evropës perëndimore ku sasin më të madhe e sigurojnë nga Turqia, ku shumë shpesh gjatë transportit kalojnë nëpërmjet Maqedonisë. Një pjesë e grupeve të organizuara kriminale që merren me tregtimin ilegal të Heroinës, gjatë transportit të saj një pjesë të Heroinës ndalojnë për konsum të brendshëm në Maqedoni, ku nëprmjet dilerve ajo shpërndahet dhearrinë deri tek konsumuesit.[50]

GRAFIKONI 3:

Heroin e kapur në Republikën e Maqedonisë[51]



[50]Republika e Maqedonisë, Ministria e punëve të Brendshme, Drejtoria për siguri publike „Vlersimi i kërcënimeve nga kriminaliteti i organizuar dhe serioz”, Viti, 2016 , nr 22.4/875 fq.7.
[51]Republika e Maqedonisë, Ministria e punëve të Brendshme, Drejtoria për siguri publike „Vlersimi i kërcënimeve nga kriminaliteti i organizuar dhe serioz”, Viti, 2016 , nr 22.4/875 23

Një pjesë të logjistikës dhe financimit të grupeve të organizuara kriminale e sigurojnë nga shtetet Europiane duke shfrytëzuar lidhjet kriminale me persona të caktuara, nuk përjashtohen dhe lidhjet familjare.Shumica e grupeve kriminale gjatë trafikimit më lëndë narkotike, angazhojnë dhe ekspert të kësaj fushe, gjithashtu nuk bënë përjashtim dhe keqpërdorimi si kamuflazh i bizneseve legale. Rrugët kryesore nga vjen Heroinë në Maqedoni janë Turqia dhe Bullgaria, ndërsa kufiri verior me Sërbin dhe Kosovën shfrytëzohet për nxjerrjen jashtë të Heroinës me destinacion përfundimtar Evropën. Sasia më e madhe që kalon transit në Maqedoni është e destinuar për Zvicër, Austri dhe Gjermani. Transporti illegal i Heroinës realizohet nëprmjet makinave për udhëtar dhe ato për mallra, duke shfrytëzuar dhe linjat e rregullta të autobusave që shkojnë në Shtetet Evropiane. Gjatë transportit shfrytëzohen modele apo forma të ndryshme të fshehjes të Heroinës, si psh fshehja në pjesë të vecanta të makinës apo mjeteteve të rënda , fshehja në trupin e transportuesit etj. Grupet kriminale që merren me këtë aktivitet illegal janë tashmë të profesinalizuar, dhe ato mendojnë dhe shpikin vende të vecanta tek mjetet, për fshehjen e Drogës. Për realizimin e transportit Grupet Kriminale më shpesh aktivizojnë persona shtetas të Maqedonisë, që kanë dokumentet të rregullta të një nga vendet Evropiane, kjo bëhet me qëllim lehtësimit e transportit dhe shmangjes të kontrolleve kufitare, sidomos ne shtetet Evropiane.[52]

1.7. Kokaina

Prodhimi i Kokainës, sipas statistikave botërore vazhdon të bjerë, ndërsa ka vitë që Bolivia, Kolumbia dhe Peru janë shtetet me prodhim më të madh dhe kryesor të Kokainës.[53]Pika kryesore për distribuimin në narko tregun e evropës llogaritet se është Spanja, ndërsa si shtete me interest ë vecant janë Belgjika, Hollanda, Franca dhe Italia[54].Shtetet perëndimore Afrikane kanë rol si shtete transit në tregun ilegal të Kokainës.

[52]Republika e Maqedonisë, Ministria e punëve të Brendshme, Drejtoria për siguri publike, nr.22.4/875 „Vlersimi i kërcënimeve nga kriminaliteti i organizuar dhe serioz", Shkup , 2016 v. fq.22
[53] UNODC,2015
[54] UNODC, 2014

GRAFIKONI 4:

Kokain e kapur në Republikëne Maqedonisë[55]



	2011	2012	2013	2014	2015	
Kokain	1.46	0.17	0.01	0.31	0.073	
Raste	10	18	10	25	25	
Kokain i lëngshëm	1.56		0.15			

Për sasi të caktuara të Kokainës gjithashtu shfrytëzohen Aeroportet dhe Portet e shteteve të Evropës Lindore, nga ku e njëjta sasi do të transportohet për në shtetet perëndimore, të cilët njëherazi janë dhe vendet me konsumin më të madh të Kokainës.

Tregtimi i paligjshëm i Kokainës në Republikën e Maqedonisë nuk paraqet ndonjë rrezikshmëri apo kanosje serioze, për arsye të kërkeses të pakët që ka për këtë lloj droge, si rezultat i cmimit shumë të lartë. Territori i Maqedonisë më shumë përdoret si rruga tranzit, përdoret i njëjti rrjet rrugësh që përdoret për llojet e tjera të drogave që tregtohen dhe si pasoj një sasi e vogël është edhe Kokaina. Tregu i jashtligjshëm i Kokainës në Republikën e Maqedonisëështë realitivisht stabil tashmë një kohë të gjatë. Kokaina e kapur e cila ka qënë e destinuar për tregun ilegal të brendshëm për vitet 2013 dhe 2014 është zvogëluar, për arsye të uljes së sasive që qarkullojnë në territorin e Maqedonisë. Cmimi i Kokainës në tregun ilegal për sasi të mëdha në Maqedoni është stabil kundrejt cmimit për sasi më të vogla i cili është në rritje në varësi të trendeve globale.

[55]Republika e Maqedonisë, Ministria e punëve të Brendshme, Drejtoria për siguri publike, nr.22.4/875 „Vlersimi i kërcënimeve nga kriminaliteti i organizuar dhe serioz", Shkup , 2016 v. fq.23

Grupet e organizuara kriminale që merren me tregtimin e Kokainës në të njëjtën kohë merren dhe me tregtimin edhe të llojëve të tjera të drogave. Rrugët më të shpeshta që shfrytëzohen për tregtimin e Kokainës janë: Belgjikë, Hollandë dhe shtetet e Amerikës Jugore nëpërmjet Porteve detare të ndryshme. Transportin përgjithësisht bëhet nga kompani legale që merren me biznes të rregullt.

1.8. Kanabis

Kanabisi me dy llojet e tij, Marihuana dhe Hashashi tanimë nga një kohë më e gjatëështë droga më e trafikuar ilegalisht në botë. Prodhimi i Marihuanës lidhet gati me cdo shtet, përvec prodhimit të Hashashit i cili prodhohet vetëm në disa vende. Rajoni i Ballkanit pësoj një ekspanzion sa i përket trafikimit ilegal të Marihuanës e prodhuar në Shqipëri. Sasi a më e madhe e Marihuanës trafikohet duke u shfrytëzuar rrugët: Shqipëri-Itali dhe Shqipëri-Greqi-Itali. Pika të rëndësishme të tranzitit janë edhe Shqipëria, Mli i Zi, Kosova, Sërbia dhe Maqedonia.

Tregtimi i paligjshëm i Kanabisit në Republikën e Maqedonisëëshë tregtimi më i madh nga të gjitha llojet e tjera të drogave, për këtë arsye në narko tregun është dhe droga më e gjetur. Republika e Maqedonisëështë vendi ku prodhhet Marihuana, vendi që shfrytëzhet për tranzit , vendi ku një pjesë e Kanabisit magazionohet për tu destinuar për tregun Evropian të drogës dhe ku një sasi e madhe mbetet për tregun narkotik i brendshëm. Në periudhën e viteve 2013/2014 janë kapur 1920 kg Marihuanë nga e cila 90% ka qënë e destinuar për tregun ndërkombëtar.

GRAFIKONI 6:

Marihuanë e kapur në Republikën e Maqedonisë[56]



	2011	2012	2013	2014	2015	
Marihuanë	407.33	847.31	1197.48	723	246	
Raste	276	302	355	434	304	

Me realizimin e aksioneve plicore në Shqipëri, pati një ndikim në gjysmën e dytë të vitit 2014 ku u zvogëluan sasit e Kanabisit në qarkullim. Mungesa e ofertës dhe mungesa e sasive të mjaftueshme për narko tregun, solli tek rritja e cmimit, ku vazhdon dhe sot.Grupet e organizuara kriminale që merren me trafikkmin e Marihuanës në Republikën e Maqedonisë për peridhuën 2013-2015 janë aktivizuar me trafikmin dhe organizimin e Marihuanës duke shfrytëzuar si vend prodhues Shqipërinë për ta futur në Maqedoni. Grupet e organizuara kriminale rekrutojnë persona të cilët janë të aftë që të njëjtëjn ta shesin në narko tregun e brëndshëm, dita ditës këto grupime behën më shumë profesionale dhe më tëmiksuara sa i përket etniteteve të antarëve të saj.

Rrugët ilegale që përdoren për sjelljen e Marihuanës në Maqedoni nga Shqipëria janë të ndryshme. Sjellja e Marihuanës në Maqedoni bëhet nëpërmjet kalimeve kufitare legale , ato të tokës dhe të ujit duke shfrytëzuar liqenin e Ohrit dhe të Prespës. Në rrugët ujore nëpërmjet liqenit të Ohrit dhe të Prespës përdoren mjetet lundruese, në kalimet kufitare të gjelbërta

[56]Republika e Maqedonisë, Ministria e punëve të Brendshme, Drejtoria për siguri publike, nr.22.4/875 „Vlersimi i kërcënimeve nga kriminaliteti i organizuar dhe serioz", Shkup , 2016 v. fq.26

përgjithsisht kalohet në këmb, ose me kafshë, ndërsa në pikat kufitare legale shfrytëzohen makinat e transportit të mallrave të biznese legale, makinat e modifikuara etj.

GRAFIKONI 7:

Marihuanë e kapur jashtë Republikës së Maqedonisë[57]



Prodhimi i Marihuanës në Republikën e Maqedonisë nuk është e sasis tëmëdha , prodhimi i Marihuanës në territorin e Maqedonisë përgjithsisht është e destinuar për narko tregun e brendshëm. Prodhimi i brendshëm nuk njihet si kualitet i cili mund tëkonkuroj në tregun rajonal dhe atë Evropian. Grupet e organizuara kriminale momentalisht nuk kanë të angazhuar ekspert për kultivimin e Marihuanës të kualitetit të lartë.Përgjithësit prodhohet në zonat rurale, eventualisht në ndonjë laborator të modifikuar etj. Për sa u tha më lartë në lidhje me rrezikshmërinë nga lëndët narkotike që kërcënojnëMaqedoninërrezikuështë evident ndoshta jo në shkall alarmante por gjithmonë gati për tu rritur si fenomen, në momëntin që institucionet nuk do jenë vigjilent.

[57] Republika e Maqedonisë, Ministria e punëve të Brendshme, Drejtoria për siguri publike, nr.22.4/875 „Vlersimi i kërcënimeve nga kriminaliteti i organizuar dhe serioz", Shkup , 2016 v. fq.27

GRAFIKONI 8:

2.Mënyra e organizimit dhe sruktura e policisë së Maqedonisë[58]



[58] Ministria për Punë të Brendshmë „ Organizimi i Ministrisë për punë të brendshme“ Viti, 2015, Shkup.

GRAFIKONI 9 :

Organizmi i njesitit të policis qëndrore[59]



[59] Ministria për Punë të Brendshmë „ Organizimi i Ministrisë për punë të brendshme“ Viti, 2015, Shkup.

GRAFIKONI 10 :

Organizimi i policis të njësitit qëndror[60]



[60] Ministria për Punë të Brendshmë „ Organizimi I Ministrisë për punë të brendshme“ Viti, 2015, Shkup.

3. Roli i policisë në informimin dhe risocializimin e personave vecanërisht të rinjve përdorues të lëndëve narkotike.

Pasojat e keqpërdorimit apo konsumimit të lëndëve narkotike janë shumë të mëdha si në aspektin social ashtu edhe në atë shëndetsor. Ato e rrezikojnë mirëqënien e qytetarëve dhe kërcënojnë kohezionin social dhe stabilitetin politik të shoqërisë. Për këtë arsye faktori ndërkombëtar dhe një pjesë e faktorit të brendshëm (R.Maqedonisë) në luftën kundër përdorimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, kanë ndërmarr dhe po ndërmarrin një sërë aktivitetesh sociale , shëndetsore dhe arsimore ku qellimi i tyre është ndërprejra ose zvoglimin e kërkesës dhe furnzimit me lëndë narkoitke deri tek qytetarët, vecanësrisht tek moshat e reja.

Masat,aktivitetet dhe politikat e hartuara për mbrojtetje sociale të personave me probleme sociale dhe shëndetsore të shfaqura si pasojë e keqpërdorimit të lëndëve narkotike themelohen sipas disa standarte dhe qëllime: ato duhet të përgjigjen kërkesave të konsumuesve të lëndëve narkotike, të jenë me nivel të lartë etik, të garantojn kualitet të lartë të aftësive dhe njohurive**, ti përfaqsojnë dhe ti mbrojnë denjësisht personat konsumues të jashtëligjshëm të lëndëve narkotike në përballjen e tyre me ligjin dhe të drejtat që atyre u takojnë sipas ligjit,** të respektohen të drejtat e tyre dhe të drejtat e familjarëve të konsumesve të lëndëve narkotike, gjithashtu tu jepet mundësia familjarëve ne kycje në procesin e risocializimit etj.

3.1.Definicioni i fjalisë, Rintegrimi Social

Rintegrimi social i personave me problematikën e keqpërdorimit të lëndëve narkotike në dy dokumentat për kontrollimin e drogës të Unionit Evropian[61]është një qëllim strategjik i drejtuar për rritjen ndjeshëm të numrit të personave të shëruar nga varësia e drogës, dhe personave me probleme sociale dhe shëndetsore si pasojë e konsumimit të lëndëve narkotike.Rintegrimi social i cili është aspekti kyc për shërimin nga varësia e drogës, nuk është një term qartësisht i definuar. Sipas EMCDDA[62]rintegrim social definohet si: “cdo lloj i intervenimit qëllimi i së cilës është strehimi, edukimi, punësimi,përfshir dhe këshillat për punë”. Përkrah kësaj mund të kycet

[61] EU Plan 2000-2004, EU Drugs Strategy 2005-20012

[62] EMCDDA Insights, Social reintegration and employment: evidenc and interventins for drug uders in treatment, Emcdda, Lisbon 2012

dhe këshillimi dhe sigurimi i mundësive për shfrytëzimin e kohës së lir. Në një kuptim më të gjërë , rintegrim social definohet në gjithsej 8 kategori:

1. Puna rreth rehabilitimit dhe trajnimi
2. Mjekimi
3. Zgjidhja e probleme ligjore të personit keqpërdorues të lëndëve narkotike
4. Ndihma për zgjidhjen e problemit të strehimit ose banimit
5. Arsimimi dhe trajnimi për punë
6. Mbështetja për punësim
7. Kordinimi i aktiviteteve për mjekim dhe punësim
8. Përfaqësim në përmisimin e perceptimit social kundrejt personave përdorues të lëndëve narkotike dhe eliminimi i stigmatizimit dhe diskriminimit shoqëror dhe social ndaj tyre.

Konsumimi i drogës, mbi të gjitha problematika më e madhe bëhet atëherë kur kemi keqpërdorim të Heroinës, drogë e cila i dëmton serizosht aftësit për mësim dhe punë. Si pasoj e këtyre dëmeve, proceset normale të socializimit dhe rintegrimit i personit i cili përdor drogë prej moshës së hershme të adoleshencës deri në moshën madhore, bëhet shumë e vështirë dhe me pengesa të shumta. Person i cili përdor drogë në mënyrë problematike e ka shumë të vështirë zhvillimin e pavarur dhe socializim në shoqëri, fakt ky që con ngadal deri në humbjen e kontaktit të personit përdorues problematiktë drogës me shoqërinë reale, dhe margjinalizimi i tij. Shoqëria më shpesh i margjinalizon këto persona , duke ja rënduar kështu mundësin e shkollimit, punësimit, dhe cdo lloj tjetër të mbështetjes sociale.

Në shumë raste konteksti shoqëror në të cilin jetojnë këto persona me gjithë përpjekjet për risocializim në shoqëri rëndohen apo kufizohen për arsye të qasjes që kanë këto persona deri tek institucionet shëndetsore dhe sociale.[63] Kushtet ekonomike të vështira në Republikën e Maqedonisë, numri i lartë i papunësis tek të rinjtë gjithashtu ndikon në rritjen e pamundësis për shkollim, punësim dhe sigurimin e një banese për personat që janë konsumues të lëndëve narkotike. Reintegrimi social është faktori kyc i rëndësishëm në shërimin e personave

[63]Shekutkoska. S, "Ulogata na socialniot rabotnik vo socialnata reintegracija na liceto so problematicna upotreba na drogi" , Shkup, fq. 31.

qëpërdorin lëndë narkotike. Ajo realizohet paralelisht me ndihmën farmateologjike dhe psikologjike.Tri janë shtyllat kryesore të rintegrimit social ku varet dhe suksesi i risocializimit apo rintegrimit të personit që konsumon lëndë narkotike: sigurimi i banesës, shkollimi dhe punësimi, përfshirë dhe trajnimin në punë. Përkrah kësaj si pjesë e intervenimit social mund të jenë dhe këshillimet dhe orgaznizimet e aktiviteteve të lira për personat problematik në konsumimin e lëndëve narktotike.Ndërkohë shërimi dhe rehabilitimi i personit me probleme të përdorimit të lëndëve narkotike, vecanërisht tëk shoqërit të cilat apstenojnë në këtë proces, shumë shpesh e vendos vet raporti që ka personi më konsumin e lëndës narkotike, rintegrimi social angazhohet me pozicionimin e personit në shoqërinë e gjërë. Tek një numër i madh i personave me probleme të konsumimit të lëndëve narkotike, punësimi vetvetiu nuk sjell dhe zgjidhje të problemit. Rintegrimi social si detyrë bazë e ka shërimin e personit të varur nga droga, ndër të tjera përfshihen dhe aktivitete të tjera ekonomike, institucionale etj, që u vihen ne dispozicin personave në fjalë.[64]

3.2.Mënyra ose metoda e tretmanit tek personat me probleme të përdorimit të lëndëve narkotike në Republikën e Maqedonisë

Strategjia Nacionale kundër drogës në Republikën e Maqedonisë e vitit 2006-2012, për herë të par vuri theksin tek nevoja e një qasje të problemit me drogën shumëdimensionale, trajtimin e përdoruesve të drogës, duke përfshirë trajtimin ambulator, detoksifkant. Në pajtim më ligjin për mbrojtje shëndetsore, qendrat për trajtim dhe reduktim nga varësia e drogës duhet të jenë pjesë e spitaleve, të përbërë me një staf minimal prej, një mjek (GP), një psikiatër dhe një infermiere, për fat të keq në Maqedoni kjo realizohet vetëm nëpër spitalet e mëdha të vendit. Trajtimi i problematikës të fenomenit të drogës është në kuadër të Shërbimit Kombëtar të Shëndetit Publik, duke e bërë kështu sektorin publik aktorin kryesor në trajtimin e asistuar mjeksor lidhur me drogën. Financues kryesor i trajtimit të personave në lidhje me keqpërdorimit të drogës është Ministria e Shëndetësis e Republikë së Maqedonisë, për arsye se trajtimi i personave tëvarur nga droga u ofrohet edhe personave që nuk kanë sigurim social.

[64] Sumnall H, Brotherhood EMCDDA Insight . Social reintegration and employment: evidence and interventions for drug users in tretman, EMCDDA, Lisbon 2012

Ka dhe disa klinika psikiatrike private që merren me trajtimin e personave me probleme me varësin nga droga,trajtimi mbulohet financiarisht pjesëirsht ose tërësisht nga pacienti. Në procesin e trajtimit marrin pjesë, psikiatri, mjeku i përgjitshëm, infermieri, farmacistë, punonjës social dhe psikolog. Për fat të keq nuk ka specialist për trajtim të varësis nga droga. Shumica e përdoruesve apo tëvarurve nga droga shërbimi që marrin apo që u ofrohet është: trajtim ambulant, zavendësim të dozave të drogës me doza të kontrolluara nga mjeku dhe droga alternative, ndërhyrjen psikosociale, këshillim individual ose grupor dhe trajtim psikosocial. Megjithatë mbetet e paqartë se deri në cfarë mase ndërhyrje të tjera përvec nga trajtimi farmakologjik janë në dispozicion. Trajtimi mund të bëhet në tri qendra sociale të kujdesit, 10 qendra nga ku 3 ndodhen në ambientet e burgjeve për trajtimin e përdoruesve të drogës, një komunitet terapeutik, dy spitale ku njëri është më kapacitet për detofiksant.

Metadoni për herë të parë u prezentua në vitin 1992 si zavendësues i drogës, dhe akoma mbetet substanca kryesore për këtë qëllim.Buprenorphine, është prezantuar në vitin 2009 për herë të parë e përdorur për detofiskim dhe si zavendësim i drogës.Diku rreth 1250 përdorues të drogës janë përfshirë në programin (MMT) Përdorues tëvarur nga droga, dhe ato marrin metadon me doza ditore apo javore sipas nevojës.Qeveria e Republikës së Maqedonisë aplikon programe të vecanta për cdo vit në kuadër të kujdesit shëndetsor për personat e varur nga droga.[65]

Konkluzioni i arritur se një person është në rrezikshmëri si e pasojë e keqpërdorimit të lëndëve narkotike mbi të gjitha është punë e mjekut. Megjithatë “diagnostifikimi” i një personi me problem shëndetsore dhe sociale si pasojë e përdorimit të drogës ka një kuptim më të gjërë se sa vetëm si një rast mjeksor. Kjo paraqet dhe kycjen në proces dhe punonjësin social i cili mund të gjendet ne zyrat speciale apo nëpër shkoll, familja, ambienti ku punon, i gjithë rrjeti social ku ai pun jeton dhe vepron.

[65] European Commission“National Report , The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2014, National report on narcotic drugs , page” Viti 2014 , 50.

TABELA 4 :

Numri i pacientëve nga keqpërdorimi i lëndëve narkotike të trajtuar në vitin 2013[66]

Kategoria e dorgave (drgat dytësre)	**2013**															**TOTAL**
	15-19			**20-34**			**35-44**			**45-54**			**55-64**			
	M	F	Total	M	F	Total	M	F	Total	M	F	Total	M	F	Total	**919**
Opiatet, Heroin	1		1	542	70	612	248	20	268	35	1	36	2		2	
Kanabis	2		2	49	8	57	25		25							**84**
Sedativ, Hipnotizues				59	10	69	29		29		1	1				**99**
Kokain										1		1				**1**
Stimulant				1		1										**1**
Halucinacionizues				3		3	2	1	3							**6**
Polydrug				14	1	15	11	1	12	3		3	1		1	**31**
Totali	3		3	668	89	757	315	22	337	3	9					**1141**

[66]European Commission"National Report , The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2014, National report on narcotic drugs , page" Viti 2014 , 50.

Gjithsej kanë qënë 1141 pacient që janë trajtuar në kuadër të ICD në vitin 2013.Të gjithë kanë qënë për opiate, mirëpo gjithashtu ato kanëkonsumuar dhe kanabis, benzodiazepines etj.Si droga të dyta.

Konkluzioni, opsione të ndryshmë janë në dispozicion për trajtimin e personave të varur nga opiadet.Njerëzit në burg marrin të njëtin tretman të kujdesit shëndetsor si ato që janë jasht në komunitet. Profilet demografike shfaqin një qëndrueshmëri relative në të gjithë vendin, dallimet vërehen vetëm sa i përket moshës mesatare të pacientëve na trajtim, si psh ndërsa në qytetin e Shkupit grupmosha mbizotëruese është 35-40 vjec në qytetet tjera mosha mesatare e pacientëve është 20-34 vjec. Duhet të theksohet fakti se klinikat psikiatrike private pavarsisht se ato janë të vendosura në Shkup, mosha e pacientëve që trajtohen në këto klinika është 20-34 vjec.E njëjta situate vlen edhe në mesin e të burgosurve ku 62% janë të moshës 20-34 vjec. E rëndësishme është për të forcuar masat parandaluese si dhe për të rritur ndërgjegjësisimin sidomos tek të rinjtë për pasojat e përdorimit të drogave të ndryshme.Mund të thuhet se nuk ka një korelacoin midis nivelit të ulët të arsimit dhe përdorimi i lëndëve narkotike.[67]

4. Bashkëpunimi Institucional i organeve nacionale me organizatat ndërkombëtare kundër trafikimit të lëndëve narkotike.

4.1. Strategjia Nacionale 2006-2012 dhe plani i veprimit në R.Maqedonisë

Republika e Maqedonisë bazuar në parimet bazë të Kushtetutës me qëllimin për vendosjen e disa masave dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim të kontrollimit të drogës, dhe me qëllim që të mund të anagazhohen të gjithë "aktorët" të cilët do marrin pjesë në realizimin e kësaj Strategjie Kombëtare paraqet Strategjinë Kombëtare kundër drogës 2006-2012. Strategjia Kombëtare kundër drogës është në kordinim të plot më Kartën e Kombeve të bashkuara, me të Drejtën Ndërkombëtare, dhe me vlerat themeore të Bashkimit Europian sic dhe janë: rrespekti i dinjitetit njerëzo, liri, demokracia, barazia, solidariteti, sundimi i së drejtës dhe të drejtave të njeriut. Strategjia Kombëtare kundër drogës, thekson nevojën për të intergruar një qasje multidisiplinore , lineare dhe të balancuar, të themeluar në këto pes elemente bazë:

[67]. European Commission"National Report , The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2014, National report on narcotic drugs , page" Viti 2014 , 56

1. **Kordinimi nacional dhe nivel ndërkombëtar**
2. Reduktimin e kërkesës
3. Reduktimin e furnizimit dhe luftimin e trafikut të paligjshëm
4. Vlersim, Vrojtim, Informacion, Trajnim
5. **Bashkëpunim Ndërkombëtar**

4.2. Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Në politikën e jashtme të saj lidhur me kontrollin e drogës Republika e Maqedonisë, në përputhje me parimet e përgjegjësis reciproke duhet që të zbatoj tre kategori strategjike në vëprim :

1. Bashkëpunim bilateral dhe multirateral në fushën e reduktimit të kërkesës për drogë dhe reduktimin e furnizimit (policia, drejtësia, dogana)
2. Rrespektimin e detyrimeve nga e drejta ndërkombëtare, dhe pjesmarrja në trupat dhe organizatat ndërkombëtare
3. Shkëmbim informacionesh, përvoja dhe njohurish, trajnime, pjesmarrja në aktivitete ndërkombëtare (seminare, knferenca) etj.

Republika e Maqedonisë do të duhet që ti përdor të gjitha instrumentet që iofron Komisioni Europian për bashkëpunim ndërkombëtar , (zhvillim, ndihmë financiare dhe teknike etj). Në lidhje me përdorimin e kontrollit të drogës të shihet si një pjesëë rëndësishmë në zhvillimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar kundër drogës Maqedonia do jep kontributin e saj maksimal duke shfrytëzuar bashkëpunimin bilateral dhe multirateral, duke ndihmuar në ndërrmarjen e disa aksioneve të rëndësishme kundër përdorimit dhe tregtimit te drogës.

Republika e Maqedonisë e njeh rëndësinë e lidhjes ndërmjet zhvillimit, bashkëpunimit dhe promovimit të një qeverisje të drejtë, sundimit të ligjit dhe rrespektim të të drejtave të njeriut, dhe nevojën për një qasje të qëndrueshme që ka të bëjë më bashkëpunimin ndërkombëtarë me vendet e treta në lidhje me problematikën e trafikimit ndërkombëtar të drogës.Kjo qasje

është një komponent i rëndësishëm i iniciativës për drogën të marra nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krim (UNODC).

Republika e Maqedonisë zotohet se do të mbështes të gjithë përpjekjet e kombinuara nga të gjitha kompenetët të mbështetura nga UE dhe më gjërë, me një rol të vecantë të Europolit në fushën e mbledhjes së të dhënave dhe analizave duke ndihmuar në koordinimin e hetimeve nacionale.

Strategjia Kombëtare për drogën ka për qëllim që ti arrij këto rezultate:

1. Bashkëpunimi me organizatat dhe institucionet kompetente në fushën e drogës ndërkombëtare duhet të vazhdoj të përmisohet. Për Maqedoninë, Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësinë nga Droga për Përsosmëri për Ndërhyrje dhe veprimet për të reduktuar kërkesën e drogës, ndërsa Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin dhe Europolit mund të konsiderohen si qendra të ekselencës në cështjet në fushën e reduktimit të furnizimit të drogës. Republika e Maqedonisë do ti kushtoj një vëmendje të vecantë përmisimit të bashkpunimit me organizatat ndërkombëtare kompetente.
2. Qeveria do të mbështes shkëmbimin e profesionistëve dhe të inkurajojë ndërveprimin midis studiuesve dhe praktikantëve, në bazë të programit vjetor të veprimtarive që tregojnë prioritet, si në nivel kombëtar dhe atë lokal.
3. Një nga prioritetetështë dhe përmisimi i metodave për adresimin e nevojave (parandalimi, trajtimi) dhe faktorët që stimulojnë parandalimin dhe trajtimin, dhe testimin e përbashkët dhe vlersimin e mjeteve të parandalimit.
4. Në këtë kontekst, Qeveria nëpërmjet ministrive dhe institucioneve të tjera të specialuzuara, për të mbështetur rrjetet e institucioneve dhe OJQ-ve të Maqedonisë në rrjetet e shumta transnacionale, si psh rrjeti Evropian i shërbimeve për droga dhe HIV\SIDA në burgje (ENDHASP), Federata e profesionistëve evropianë që punojnë në fushën e përdorimit të drogës, fondacioni Evropian për ndihmën nga droga (FESAT),

rrjeti për hetim dhe evulim në parandalim, rrjeti për parandalimin e dëmeve në Evropën Juglindore.[68]

4.3. Zbatimi i Strategjisë dhe planit të veprimit

Strategjia dhe plani i veprimit është implementuar ndërmjet viteve 2006 dhe 2012. Zbatimi i kësaj strategjie vlersohej cdo vit në bazë të raporteve të ndryshme (të standartizuara dhe jo të standartizuara) nga ministritë, institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile.Plani i veprimit i ka të specifikuara masat dhe mënyrën e veprimit si ato individuale dhe ato që duhej të ndërrmeren nga institucionet përgjegjëse që njëkohësisht janë përgjegjëse dhe për zbatimin e tyre, duke pasur kujdes afatet e veprimit dhe inkuadrimin e treguesve të ndryshëm për problematikën e lëndëve narkotike.Institucionet përkatëse janë të detyruara tëtrasportojnë për progresin e arritur për periudhën e dhënë tek Komisini Ndërministror për Drogat Narkotike. Departeamenti për substancat narkotike pranë Ministrisë së Shëndetsisë do bëjë kontrollimin dhe analizën e progres raportit të dorëzuar gjithashtu dukë ekzaminuar dhe dokumenat që përcaktojnë strategjinëë veprimit. Gjithë cka ka për tu raportuar do ti prezentohet Komisionit të BE-së cdo gjashtë muaj. Departamenti për substancat e kontrolluara monitoron trended e keqpërdorimit të lëndëve narkotike, duke përdor shumëllojshmëri të treguesve kur është nevoja propozon masa shtesë ose bënë ndryshim të paln veprimit për periudh të caktuar. Në nivel kombëtar programet apo plan veprimi i zbatuar nga organizatat e shoqëris civile vlersohen nga vlersues të jashtëm, pasi që burime apo të ardhura të konsiderueshme janë garantuar nga buxheti i Fondit Global për luftën kundër AIDS, Turbekulozit dhe Malaries. Programet në fushën e drogës reduktimit të kërkesës dhe parandalimin e drogës të cilat janë zbatuar në nivel lokal, shpesh vlersohen nga Komitetet lokale për luftimin e drogave dhe shpërdorimin, përderisa ato financojnë këto programe ose nga agjencia e të Rinjve dhe Sportit për programe të financuar nga kjo Agjenci.[69]

[68] Ministertsvo za zdrastvo „ Nacionalna Strategia za Drogi na Republika Makedonija 2006-2012“ , Viti ,2007. Shkup fq. 29

[69] European Commission“National Report , The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2014, National report on narcotic drugs , page” Viti 2014 ,13

4.4. Vlersimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit

Në Maj të vitit 2012 Departamenti për kontrollimin e substancave, në kuadër të Minstrisë të Shëndetsisë kreu një vlersim shkencor të evaluimit të Strategjisë. Qëllimi i tij ishte për të lidhur strategjinë për vitet 2014-2020 për nevojat specifike që rrjedhin nga problemet e lidhura me drogën duke dashur të përmisojë efektin kundër kësaj problematike dhe duke rritur efektin në sistemin që do luftojë këtë fenomen.

Në vitin 2012 është bërë një hulumtim duke përdor një metodë studimi që përfshinte një pyetësor të standartizuar për përdorimin e drogës në vendet e BE-së, i njëjti pyetësor është përshtatur në rrethanat kombëtare të R.Maqedonisë.Hulumtimi u përfshin 246 persona, në tetë rajone dhe 20 qytete.Hulumtimi është realizuar në lokalitete të ndryshme, si ato publike dhe ato private , përfshirë parqet, kafenet dhe klubet.

Rezultatet :

Mosha mesatare e të anketuarve ishte 32.2 plus 7.3 vjet. Vlerat mesatare të llogaritura tregojnë së 50% e të anketuarve ishin të moshës mbi 32 vjec.

TABELA 5:

Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë dhe vendodhjes[70]

Qyteti	Mashkull		Femër		Totali	
Kumanova	30	12.20%	5	2.03%	35	14.23 %
Ohër	24	9.76%	6	2.44%	30	12.20 %
Shkupi	27	10.98%	3	1.22%	30	12.20 %
Shtipi	22	8.94%	8	3.25%	30	12.20 %
Strumica	30	12.20%	0	0.00%	30	12.20 %
Tetova	26	10.57%	4	1.63%	30	12.20 %
Velesi	21	8.54%	9	3.66%	30	12.20 %
Manastiri	27	10.98%	4	1.63%	31	12.60 %
Totali	207	84.15%	39	15.85%	246	100. %

[70]European Commission"National Report , The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2014, National report on narcotic drugs , page" Viti 2014 ,13

GRAFIKONI 9:

Shpërndarja e të anketuarve që injektojnë drogë sipas qytetit[71]



4.5. Komisioni shtetëror Ndërdikasterial (Ndërministror)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë formon Kominsionin shtetëror Ndërdikasterial për luftën kundër prodhimit të paligjshëm, tregtimit dhe keqpërdorimit të dorgës. Punët profesionale dhe administrative lidhur me funksionimin e Komisionit shtetëror Ndërdikasterial i kryen Drejtoria e barnave.

Komisioni ndërdikasterial përbëhet nga përfaqsues të ministrisë të drejtësisë, për punë të brendshmë, të shëndetsisë, vetqeverisje lokale, planifikimin hapsinor, për punë të jashtme, shkencë dhe arsim, punë dhe politik sociale, e bujqësisë, pylltarisë dhe ujrave, të financave, agjencioni dhe drejtoria e doganave, dhe agjencioni për rini dhe sport.

[71]European Commission"National Report , The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2014, National report on narcotic drugs , page" Viti 2014 , 17

Komisioni ndërshtetëror ka për kompetencë për ti zgjidhur këto punë:

1. shqyrton cështjet dhe bënë rekomandime dhe sygjerime për zbatimin e konventave ndërkombëtare nëkontrollin e drogave narkotike, rregullor dhe mekanizma të tjerë që kanë ndikim në keqpërdorimin e drogave.

2. zhvillon dhe siguron zbatimin e përgjithshëm dhe sistematik të strategjië si dhe është mbikqyrësi parandalimin dhe abuzimin me drogat narkotike

3. të promvojë veprimet që ndikojnë në parandalimin dhe informimin publik se sa i dëmshëmështë përdorimi i lëndëve narkotike.

4. formon një sistem për grumbullumin e të dhënave mbi natyrën e shtrirjes dhe shfaqjes së keqpërdorimit të drogave në Republikën e Maqedonisë si dhe sistem për përpunimin e këtyre të dhënave.

5. kordinon dhe jep mbështetje aktiviteteve që ndërrmeren nga njësitë e vetqeverisjeve lokale.

6. shqyrton ligjet dhe rregullore të tjera, si dhe mekanizma të ndryshëm të cilët kanë ndikmin tek problematika e keqpërdorimit të lëndëve narkotike.

7. jep udhëzime për zbatimin e konventave ndërkombëtare në kontrollin e lëndëve narkotike.

8. përfaqsim në organizatat ndërkombëtare dhe dhënien e informacionit dhe të dhënave në përputhje me konventat ndërkombëtare mbi kontrollin e drogave narkotike dhe kujdesin për të mbajtur komunikimin të rregullt me organet dhe shërbimet profesinale kombëtare dhe ndërkombëtare.

9. paraqitja e një raporti për situatën aktuale dhe tendencën në vend në fushën e ofertës dhe kërkesës për drogë, më një propozim të përshtatshëm për veprim nga autoritetet publike .

10. bënë dhe punë të tjera që do ja ngarkoj Qeveria e Republikë së Maqedonisë.

4.6. Njësitë regjionale

Më poshtë do radhisim vendet se ku janë krijuar dhe ku veprojnë njësitë rajonale për zbatimin e aktiviteteve për parandalimin dhe ndalimin e abuzimit me drogat narkotike dhe substancat të tjera psikotrope.

1. Rajoni i Pellagonisë (Resnjë, Manastir,Prilep,Kryshev, Demir Hisar)

2. Rajoni I Vardarit (Veles, Qyteti, Kavadarc, Negotinë,Demir Kapi)

3. Rajoni Verilindor (Kratovë, Kumanovë, Kriva Palanka)

4. Rajoni Juglindor (Ohër,Strugë,Dibër,Kërcovë,MakedOnski Brod)

5. Rajoni i Shkupit

6. Rajoni Juglindor (Gjevgjeli, Strumicë, Dojran , Vallandovë, Radovish)

7. Rajoni i Pollogut (Tetovë, Gostivar, Mavrovë)

8. Rajoni Lindor (Shtip, Kocan, Probishtip, Pehcevo, Makedonska Kamenica, Sveti Nikole, Berov, Delcev, Vinic)

9. Qendra rajonale për institucionet korrektuese dhe arsimore Shkup.

Nga njësitë të shënuara në paragrafin me numër 1 formohen grupe pune të cilat do të realizojnë një sërë aktivitetesh të caktuara për parandalimin dhe trajtimin e abuzimit me lëndët narkoitke dhe për rajonet për të cilat do të formohen.[72]

[72]“ Ligji për kontroll të drogave narkotike dhe substancave psikotrope”, Viti, 2008 , Shkup, nr 07-3399/1, fq. 5.

5. Mjekimi dhe Trajtimi Shoqëror i personave, konsumues të lëndëve narkotike

5.1.Rregullimi ligjor për mjekimin e përdoruesve të lëndëve narkotike dhe, analiza e dokumentave ligjore me të cilat rregullohet e drejta e mjekimit të personave tëvarur nga droga.

Problemet shëndetsore dhe ato sociale që janë të lidhur me varësinë nga substancat narkotike, trajtimi psikosocial i cili vlen për të , na detyon që të bëjmë një analizë të sistemit aktual të trajtimit të personave përdorues të lëndëve narkotike në Republikën e Maqedonisë, nëaspektin e të drejtave të njeriut. Qëllimi i kësaj analize në kuadër të këtij punimi është për të pasur një pasqyrë të dokumentave ndërkombëtare të ratifikuara nga ana e Republikës së Maqedonisë, si dhe sistemin ligjor aktual lidhur me të drejtën e mjekimit, me fokus të vecantë të trajtimit të personave tëvarur nga lëndët narkotike. Analiza jep definicionin e të drejtës për mjekim dhe të principeve bazë me anë të të cilave do të analizohet shkalla e realizimit të së drejtës për mjekim nga varësia e lëndëve narkotike.Gjithashtu vërteton si politikat nacionale janë të orientuara në garantimin e mundësis për realizimin e të drejtës për mjekim nga varësia e lëndëve narkotike, gjegjësisht cfarë ka në plan Republika e Maqedonisë dhe cfarë mer ajo për obligim për të cuar përpara mundësinë dhe të drejtën për mjekim nga lëndët narkotike.[73]

Dokumentat ndërkombëtare të firmosura dhe të ratifikura nga Republika e Maqedonisë dhe Kushtetuta e Maqedonisë e garantojnë të drejtën për mjekim nga varësia e lëndëve narkotike si një nga të drejtat themelore tënjeriut.Dipozitat e këtyre dokumentave e detyrojnë palën nënshkruese që të themeloj apo projektoj për tua garantuar me ligj dhe në praktik të drejtën e mjekimit cdo personi pa dallim.E drejta e mjekimit bënë pjes në grupin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturre kundrejt të drejtave politike dhe qytetare.[74]Megjithatë e drejta për mjekim nuk duhet par si një e drejtë e vecantë, sepse është ngushtë e lidhur me të drejtat e tjera të cilat përbëjnë gamën e gjërëe të pandashëm të të drejtave të njeriut.[75]Karakteri ekonommik dhe

[73] Vanja Dimitrieska, Natasha Boshkova, “Podobruvanje na kvalitet na programite za lekuvanje na zavisnosti od drogi vo Skopje” Shkup, v. 2012, fq 18.
[74]Kluwe Law International, Economic, Social and Cultural Rights.
[75] United Nations, United Nations World Conferenc on Human Rights , Vienna Declaration and Programme of Action, UN doc. A/CONF.157/23, 12 July 1993, Part I.

social nënkupton mbrojtjen e individëve nga padrejtësia ekonomike dhe sociale e cila ndikon në shëndetsi, ndërsa komponenti kulturor nënkupton vetëdisimin e shërbimeve shëndetsore edhe sa i përket kulturave të ndryshme tek përsonat e vecantë. Pas kodifikimit të Kushtetutës së Organizatës Botërore të Shëndetsis (OBSH) e drejta për mjekim ka qënë e përfshirë në disa dokumenta të karakterit ndërkombëtar dhe regjional.

Në kornizën ndërkombëtare, e drejta për mjekim është e garantuar me:

1. Deklarata univerzale për të drejtat e njeriut , neni 25, i vitit 1948,

2. Karta Ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore neni 12, i vitit 1966,

3. Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminit të grave, neni 12, i vitit 1979.

4. Karta Sociale Evropiane , neni 11 I vitit 1961.

Të gjitha këto dokumete kanë për qëllim që shteti nënshkrues të obligohet që të garantoj realizimin sa më të mirë të së drejtës për mjekim për cdo person në vecanti. Republika e Maqedonisë ka pas qasje pozitive duke i ratifikuar të gjitha dokumentat e lartëpërmendura si ato ndërkombëtare dhe ato regjionale dhe sipas nenit 188[76] të kushtetuës ka për obligim të bëjë realizimin e të njëjtave.

5.2. E drejta për mjekimin e personave tëvarur nga droga

Sigurimi i trajtimit adekuat tëvarësis nga droga, është e potencuar vetëm tëk Konventa për drogat narkotike e vitit 1961, dhe Konventa për substancat psikotrope e vitit 1971 nga ku i detyrojnë shtetet anatare, ku bënë pjesë edhe Maqedonia, të kushtojnë vëmendje të vecantë parandalimit dhe trajtimit tëvarësis nga drogat. Këto janë dokumentat e vetme ndërkombëtare ligjërisht të detyrueshme për shtetet antare, ku përmendet detyrimi dhe garantimi i të drejtës për mjekim të personave tëvaraur nga droga.Qëllimi i këtyre konventave është që ti bëjnë drogat narkotike dhe substancat psikotrpe të qasshme për mjeksinë dhe studimet përkatëse

[76] Gazeta Zyrtare e Reublikës sëMaqedonisë , nr 52/1991, Kushtetua e R.Maqedonisë.

dhe të pengojnë shpërndarjen e tyre për qëllime të tjera.[77]Në përputhshmëri me Konventat , R.Maqedonisë në vitin 2008 miratoj ligjin e posacëm Ligji për kontroll të drogave narkotike dhe substancave psikotrope, me anë të së cilit rregullohet prodhimi, tregu i drogave narkotike dhe substancave psikotrope, masat për parandalimin e keqpërdorimit të lëndëve narkotike, e drejta për mjekim, rehabilitimi dhe integrimi social i personave përdorues të lëndëve narkotike.[78] Në lidhje me praktikimin apo realizimin e trajtimit, pranimit, dhe urdhërshkrimit dhe dhënia e dozave me metadon në vitin 2005 është sjellëUdhëzimi me protokll për pranimin e metadonit gjatë trajtimit tëvarësis na drogat, [79] nga 16 Marsi 2012 është sjellë Udhëzim i ri për mënyrën e realizimit të së drejtës për mjekim në aspekt të praktikimit shëndetsor sa i përket pranimit të metadonit gjatë seancave të trajtimit tëvarësis nga substancat narkotike[80]. Sipas Konventës të vitit 1961, metadoni është radhitur në listën e drogave narkotike dhe rregullohet me këtë Konvent ndërsa bubrenofina është radhitur në listën e substancave psikotrope dhe rregullohet me Konventën për substancat psikotrope e vitit 1971. Funksionimi i shëndetit publik dhe qendrat shëndetsore, shërbimi i mir, si dhe programi duhet të jenë në numër të mjaftueshëm në gjithë R.Maqedonisë sipas detyrimit që del pas nënshkrimit të Kartës Ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale, dhe kulturore. Sipas Komitetit për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore shërbimi mir, qendrat shëndetsore të mjaftueshme dhe me standarte varion në bazë të disa faktorëve , përfshirë këtu dhe zhvillimin e shtetit antar , mirëpo shtetet antare ku bënë pjesë dhe Maqedonia, duhet që patjetër të plotsojnë disa standarte sa i përket të drejtës për mjekim nga varësia prej substancave narkotike. Në aspektin e trajtimit e varësis OBSH e ka vendosur metadonin dhe buprenofinin si ilace bazë. Për të plotësuar minimunim e standartit për mjekim tëvarësis, Maqedonia duhet të sigurojë metadon dhe buprenofinë për të gjithë personat që kanë nevojë për mjekimin nga varësia prej drogës.Në Maqedoni metadoni është në listën e ilaceve të regjistruara në Ministrin e shëndetsisë dhe në Listën e ilaceve që janë nën financimin e Fondit për sigurim dhe shëndetsor në R.Maqedonisë. Edhe pse është ilac i

[77] Ëorld Health Organizatin, Guidelines for the Psychosocially Assisted Pharmacolgical Treatmant of Opiid Depence , pg . 8

[78]Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë, nr 103/2008, Ligji për kontroll të drogave narkotike dhe substancave psikotrope, neni 1 pika 1, alineja 1 dhe 2.

[79]Ministria e Shëndetsis, Udhëzim me protokoll për pranim të metadonit gjatë trajtimit të nvarësis nga drogat.

[80] Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë, nr 36/2012 Udhëzim për mënyrën e ralizimit të shërbimit shëndetsor sa i përket pranimit të metadonit gjatë seancës së trajtimit nga varësia prej substancave narkotike.

regjistruar bupenofrini akoma nuk është vendosur në listën e ilaceve bazë, gjë e cila është në kundërshtim më standartet e OBSH.

5.3. Strategjia e realizimit

Edhe pse Marihuana është droga që abuzohet më tepër, Heroina është një shqetësim më i madh në fushën e drogave të paligjshme, për shkak të rreziqeve që bartë keqpërdorimi i kësaj droge si përhapja e sëmundjeve ngjitëse të gjakut, sëmundjeve seksualisht të transmetuesme , virusi HIV , Hepaiti C etj.

Pavarsisht kësaj situate alarmante, trajtimi i këtyre fenomeneve dhe i kësaj problematike të rëndë socio-mjekësore, në vitet e fundit iështë besuar institucioneve mjeksore, kryesisht atyre psikiatrike, të financuara nga sigurimi shëndetsor kjo ka dhënë rezultate modeste në një munges totale të mbështetjes më se të nevojshme nga institucionet e tjera. Në kuadër tëzbatimit të strategjisë Kombëtare të Drogës, 2006-2012, një sistem i kujdesit që përfshinë trajtimin ambulator, trajtimin spitalor, etj. Trajtimet terapeutike gjithashtu janë përshirë si pjesë e shëndetit publik ku janë të monitoruara dhe të testuara.

Strategjia e dytë kombëtare për drogën 2014-2020 është në proces pregatitje, ku pritet që kjo strategji të adresojë nevojën për këshillim dhe trajtim edhe për llojet tjera të substancave të kontrolluara si Marihuana, substancat stimulese ku pritet që do ndikojë në sistemin e trajtimit mjekësor tëvarësis nga drogat.

5.4. Vendi i Trajtimit

Në të kaluarën trajtimi i personave që keqpërdorin lëndët narkotike bëhej në vende të specializuara, shpesh mirë të izoluara nga hapsirat të tjera të shëndetit publik dhe institucioneve të shëndetit publik. Në njërën anë kjo praktikë mendohej se di sjellë deri tek përmisimi apo risocializmi i personit pas një izolimi që do i bëhet atij, dhe nga ana tjetër mendohej se do mbahej pjesa tjetër e shoqëris e paprekur nga kjo dukuri. Trajtimi i personave tëvarur nga droga tani bëhet në bazë të një vlersimi të specializuar ku dhe parashihet mënyra dhe vendi i trajtitmit për cdo person vecanërisht me qëllim përmisimit apo mjekim të të njëjtit.

Trajtimi mund të organizohet në :

1. Kushte Spitalore:

- Infiermeri (sektori spitalor)
- Sektori në spitalin e përgjithshëm
- Sektor i specializuar
- Spital psikiatrik
- Spitali ditor

2. Në kushte jashtë spitalore:

- Kushte shtëpiake
- Ambiente Burgu
- Qendra të tjera të specializuara për këtë fenomen

3. Trajtimi i vazhduar mund të realizohet në :

- Institute të specializuara spitalore
- Terapi
- Qendrat për punë Sociale
- Institucionet religjioze etj.

5.5. Llojet e trajtimeve

Trajtimi i personave tëvarur nga droga realizohet në kombinim me :

1. Farmakoterapi (terapi biologjike – ilace)

- ilacet – ilace për qetësim të dhimbjeve, për përmisim të oreksit, rregullim të disponimit, gjumit etj.

- Ilacet agnostike: ilace me efekte të ngjashme si droga

- ilace antagnostike: ilace me efekte totalisht të kundërta me drogën, të ashtuquajtura bllokues të drogës (nemexin).

2. Psikoterapia - realizohet në varësi të vlersimit të nevojës të pacientit dhe familjes, kjo lloj terapie mund të realizohet :

- psikoterapi individuale

- psikoterapi në grup (grup i vogël, psikodrama, geshtald etj.)

- psikoterapi familjare

3. Socioterapia – paraqet të mësuarit e aftësive sociale, përmisimit të funksionimit social, kjo llojë terapie realizohet në :

- grupë të mëdha

- shoqëri teraupetike

- rrejte sociale

- grupe për përmbajtje

- grupe për vetëndihmus etj.

4. Terapi me punë, angazhim dhe rekreacion – është llojë i terapisë që jo vetëm që ndihmon kondicionin fizik dhe angazhimin në punë, por dhe ruajtjen dhe të mësuarit dhe profesione dhe aftësi tëtjera profesinale, vlersime edukative, organzimi ditor dhe një strukturim të kohës të mirfillt[81].

[81] Dr, Slavica Gajdasic- Knezhevic, acc. Dr. Liljana Ignjatova, Psik. Natka Pacoska " Tretman i namaluvane na steatite od zloupotreba na drogi , vo prevencija na HIV/AIDS vo zaednicata " Shkup, v.2005, fq 49, 51.

GRAFIKU 10:

Numri i pacientëve në qendrat e trajtimit për vitin 2013[82]



5.6. Përfundimi

E drejta për mjekim bënë pjesë tek grupi i të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, përballë të drejtave politike dhe qytetare, e drejta për mjekim nuk duhet që të trajtohet si një e drejtë e vecantë, sepse është ngushtë e lidhur me të drejtat e tjera, të cilat të gjitha sëbashku formulojnë tërësinë e të drejtave themelore të njeriut. Programet e financuara për trajtim nga varësia nga drogat në Republikën e Maqedonisë para së gjthash janë paraparë për persona të rritur. Për fat të keq nuk ka programe trajtimi për persona të mitur vecanërisht jo për persona më të ri se 16 vjec. Me mjetet financiare të buxhetit të R.Maqedonisë fare nuk finansohen programe për trajtim të personave të varur nga lëndët narkotike që nuk janë OPIOIDE.

[82]European Commission"National Report , The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2014, National report on narcotic drugs , page" Viti 2014 , 51

Problem tjetër që vërehet është dhe aksesi i kufizuar deri tëk qendrat e trajtimit dhe atë për faktor të ndryshëm si: mospërshtatja e orait të punës të këtyre qendrave gjithashtu dhe faktori gjeografik si pozicionimi i këtyre qendrave që del se janë largë shumicës së venbanimeve të pacientëve në nevojë. Terapia farmaeologjike jepet në hapsira të cilat nuk i plotsojnë kushtet e diskrecionit , ku paraqet mundësi reale për zbulim të indentietit të pacinetit që mjekohet përpara shoqërisë në tërësi.

Pacientët nuk janë të informuar plotësisht me profesionalizmin e personave që përbëjnëë ekipin mjekësor që merren me trajtimin e tyre, vecanërisht me lartësinë e pregatitjes profesinale sa i përket trajtimit të sëmundjes së varësisë nga lëndët narkotike.

Pacientët vazhdimisht kanë dyshime në profesionalzimin e ekipit mjekësor, kjo përshtypje apo bindje u krijohet pacientëve nga vet sjellja apo qasja teje e vrazhdë dhe jo njerzore dhe profesionale që demonstrojnëpersonat që merren me trajtimin dhe mjekimin e tyre.

KAPITULLI I KATËRT

VEPRAT PENALE TË NARKOTIKËVE SIPAS LEGJISLACIONIT TË R.MAQEDONISË

1. Analizë e përgjithshme

Në Maqedoni posedimi drogës per nevoja personale nuk është vepër penale, ndërsa përdorimi i drogave paraqet kundërvajtje kundër qetësis dhe rregullit publik dhe është e dënueshme me të holla. Më konkretisht në Maqedoni posedimi i drogës për nevoja personale dhe përdorimi i saj janë të dekriminalizuara. Vepër penale është posedim i drogës me qëllim shitjen. Megjithatë në praktik posedimi i drogës më shpesh trajtohet si vepër penale dhe dënohet në bazë të kodit penal.

Sipas një ankete të zhvilluar nga redaksia e revistës Drogat dhe Politikat në të gjithë Republikën e Maqedonisë qytetarët janë përgjigjur në mënyrë vullnetare dy pyetjeve :

1. A mendoni se posedimi i drogës vetëm për nevoja personale duhet të jetë e dënueshme me ligj?

2. A mendoni se përdorimi i Marihuanës duhet të legalizohet?

Në ketë anketë nëpërmjet telefonit janë përfshir 1095 qytetarë në nivel nacional të selektuar sipas gjinisë,moshës, përkatësis etnike dhe vendbanimit.Tek pyetja e parë 90.5% janë deklaruar se posedimi i drogës vetëm për përdorim vetjak duhet të jetë e dënueshme me ligj, 6.9% mendojnë se nuk duhet të jetë e dënueshme, ndërsa 5.3% nuk e dinëose nuk duhen të përgjigjen.

Në pyetjen për legalizimin e përdorimit të Marihuanës, 83.7% nga të anketuarit deklaruan se janë kundër legalizimit të Marihuanës, 9.3% janë përgjigjur se duhet që Marihuana të legalizhoet, ndërsa 9.7% nuk e dinë ose nuk duhen të përgjigjen. Sipas moshës , përqindja me e madhe e të anketuarve të cilët janë pro legalizimit të marihuanës janë nga mosha 18-29 vjec (13.5%). Këto shifra më poshtë janë paraqitur dhe në mënyrë grafike.

GRAFIKONI 11:

A mendoni se përdorimi i Marihuanës duhet të legalizohet në R.Maqedonisë[83]



	18-29	30-44	45-59	60 +	
PO	13.5	10.3	9.1	4.5	
JO	81.2	85	83.8	85	
NUK E DI	0.4	0.4	6.8	10.5	

Sipas venbanimit, legalizimin e Marihuanës më shumë e mbështesin të anketuarit me vendbanim në Shkup me 16.2% dhe pjesa juglindore 12.5 %.Pikërisht ne rajonin juglindor të Maqedonisëështë mbështetja më e ulët për ndalimin e përdorimit të Marihuanës 70.8 %. Pjesa tjetër ose 29.2% janë persona të cilët jan pro legalizimit të Marihuanës, një pjes nga këto nuk e dinë ose nuk duhen të përgjigjen. Më poshtë do paraqesim në mënyrë grafike.

[83] Revista " Drogi-politiki i praktiki", Viti 2014 nr2. Shkup, fq.6.

GRAFIKONI 12:

Sa mendojnë se përdorimi i Marihuanës duhet të legalizohet sipas qyteteve të R.Maqedonisë[84]



	Vardarit	Shkupit	Pelagnisw	Jugperwndim	Juglindje	Pologut	Verilindje	Lindje	
PO	12.4	16.2	11.2	3.2	12.5	2.9	1.4	4	
JO	83.5	77.3	81.6	94.4	70.8	88.3	89	94	
NUK E DI	1	0.6	7.2	2.4	16.7	8.8	9.6	2	

1.2. Dilemat etike dhe sociale të kriminalizimit

Suksesshmëria e politikave për drogën në aspektin e shëndetit publik më sëshumti matet sipas parandalimit, gjegjësisht numri i personave që përdorin drogë, personat që trajtohen nga varësia e drogës, mortaliteti, dhe indikator të tjerë.

Nga aspekti juridik apo i së drejtës suksesi matet në bazë të numrit të të burgosurve, sipas numrit të veprave penale lidhur me drogën, numri i të regjistruarve të rinjë etj. Megjithatë vlersimi i një politke sa i përket kriminalizimin e përdorimit të drogave do të jetë e kompletuar atëherë kur parasysh do merren dhe të dhënat shkencore sociale dhe psikologjike. Për shembull: sa është numri i persoanve që përdorin drogë të cilët janë të punësuar, sa prej tyre kanë themeluar familje, sa janë pranuar nga shoqëria etj. Ekzistojnë dhe shumë indikator të tjerë të cilët pak ose pothuajse aspak nuk hetohen nuk studiohen dhe nuk merren parasysh kur hartohen politkat apo projekt ligje për një dukuri kaq të ndjeshme në ditët e sodit. Duke pasur

[84]Revista " Drogi-politiki i praktiki", Viti 2014 nr2. Shkup, fq.6

parasysh të gjithë seriozitetin e ligjeve që rregullojnë fenomenin e drogave, të miratuar nga politikanët, duhet që shumë seriozisht të pysim veten se a janë politikanët tanë në nivel për ti marrë parasysh të gjitha anët negative që sjellin ligjet që ata miratojnë.!! Ndoshta është momenti më i përshtatshëm për ta përmendur thënien e famshme të Sharl De Gol ***" Politika është shumë punë serioze për tja u lënë vetëm politikanëve"***

2. **Prodhimi dhe shitjae narkotikëve dhe vënja në qarkullim në mënyrë të pautorizuar – formë e rëndë e veprës penale.**

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë ka vecuar tre vepra penale lidhur me drogën të cilat sanksionohen,dhe atë: prodhim i pautorizuar dhe vënia në qarkullim të drogave dhe substancave psikotrope (neni 215); mundësimi i përdorimit të drogës (neni 216); shkaktimi i lëndimit të rëndë trupor se përkeqësimin e gjendjes shëndetsore të theksuar duke konsumuar dy veprat penale që përmendëm më sipër (neni 217). Pjesa më e madhe e procedurave penale lidhur me drogën që trajtohen para gjykatave janë veprat sipas Nenit 215 të Kodit Penal " Prodhim dhe shitje në mënyrë të pautorizuar të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope". Nga miratimi i parë i Ligjit penal në vitin 1996 deri më sot, ky ligj është ndërruar në Shtator të 2009 ku u miratua një nen i ri ku parasheh dënim më të butë nëse vepra penale është kryer me sasi më të vogël të drogës. Në Ligjin penal nuk është e përcaktuar sasia, për këtë arsye Prokurria publike solli një udhëzim të brendshëm apo intern ku definohet cila sasi për cdo llojë të drogës do të llogaritet e vogël. Dhe kështu për Prokurorinë sasi e vogël llogaritet **5g Marihuanë, 2g Heroin dhe 2g Kokain**.

Përshkrimi i veprës penale, prodhim dhe shitje të pautorizuar të lëndëve narkoitke dhe substancave psikotrope, si dhe interpretimi nga ekspertët, nuk e përfshin posedimin e drgës për nevoja personale. Në praktik duhet që Gjykata primare duhet që të analizojë dhe të vërtetoj se a ka pas qëllim për ta shitur drogën nga ana të akuzuarit apo drogën e ka poseduar për përdorim vetjak. Analiza e situatës na tregon një praktikë më ndryshe. Persona të rritur të dënuar për veprën penale lidhur me drogën në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2009-2013 është dikuu 4% nga numri i përgjithshëm i të dënuarve në Maqedoni. Në të njëjtën periudhë numri i vendimeve për burgim është rreth 9% nga numri i përgjithshëm i vendimeve me burg

nëMaqedoni. Në të gjitha procedurat penale për ,,prodhim dhe shitje të pautorizuar të lëndëve narkotike dhe substancave psiktrope“, Gjykata si rrethan lehtësuese e merr faktin sasinë e vogël të drogës. Nga ana tjetër, gjatë procedurës Gjykata i përmbahet kualifikimit të Prokurorisë sipas udhëzimit të brendshëm të saj në lidhje me përcaktimin e sasisë. Në Kodin Penal nuk ekziston kufzim i sasisë që do llogaritet si sasi e vogël apo e madhe, sic vijon:

NENI 215

Prodhimi dhe shitja e pautorizuar e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope.

1. Personi i cili pa autorizim organizon, prodhon, përpunon, shet ose ofron për shitje ose për shitje, blen, mban ose transferon ose ndërmjetëson në shitje ose blerje ose në ndonjë mënyrë tjetër të paautorizuar vendosjen në treg të lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve dënohet me burgim tre deri në dhjetë vjet.

2.Nëse vepra nga paragrafi (1) i këtij neni është kryer me droga narkotike, substanca psikotrope dhe prekursorë me sasi më të vogël, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 është kryer nga disa persona ose kryerësi i këtij krimi ka organizuar një rrjet të rishitjes ose ndërmjetës ose ka organizuar një veprim nga paragrafi 1 i këtij neni, kryerësi dënohet me burgim prej së paku pesë vjetësh.

4. Personi i cili prodhon, blen, ndërmjetëson ose jep përdorimin e pajisjeve, materialeve ose substancave për të cilat e dinë se janë të destinuara për prodhimin e narkotikëve, substancave psikotrope dhe prekursorëve, dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

5. Kryerësi i veprës nga paragrafit 2, me përjashtim të organizatorit, i cili do të zbulojë aktin ose do të kontribuojë në zbulimin e tij, do të lirohet nga dënimi.

6. Nëse vepra penale e përmendur në këtë nen kryhet nga personi juridik, dënohet me gjobë me të holla.

7. Drogat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët, si dhe sendet e luajtshme ose të paluajtshme të përdorura për bërjen, transferimin ose shpërndarjen e tyre, do të konfiskohen.

3. Bashkëpunimi i të akuzuarit apo të dyshuarit sipas Kodit Penal të R.Maqedonisë.

NENI 215

Prodhimi dhe lëshimi i paautorizuar i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve

1).Personi i cili pa autorizim organizon, prodhon, përpunon, shet ose ofron për shitje ose, blen, mban ose transferon ose ndërmjetëson në shitje ose blerje ose në ndonjë mënyrë tjetër të paautorizuar vendosjen në treg të barnave, substancave psikotrope dhe prekursorëve dënohet me burgim tre deri në dhjetë vjet.

2)Nëse krimi nga paragrafi (1) i këtij neni është kryer me droga narkotike, substanca psikotrope dhe prekursorë me sasi më të vogël, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

3)Nëse vepra penale nga paragrafi 1 është kryer nga disa persona ose kryerësi i këtij krimi ka organizuar një rrjet të rishitjes ose ndërmjetës ose ka organizuar një veprim nga paragrafi 1 i këtij neni, kryerësi dënohet me burgim prej së paku pesë vjetësh.

4) Personi i cili pa autorizim, prokurim, ndërmjetësim ose përdorim të pajisjeve, materialeve ose substancave të cilat janë të destinuara për prodhimin e narkotikëve, substancave psikotrope dhe prekursorëve, dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

5) **Kryerësi i veprës që parasheh paragrafit 2, me përjashtim të ORGANIZATORIT, i cili do ta zbulojë aktin ose do të kontribuojë në zbulimin e tij,LIROHET nga dënimi.**

6)Nëse vepra penale nga ky nen kryhet nga personi juridik, dënohet me gjobë dënim.

7) Narkotikët, substancat psikotrope dhe prekursorët, si dhe sendet e luajtshme ose të paluajtshme të përdorura për bërjen e tyre, transferimin ose shpërndarjen, do të konfiskohen.

Sic shihet edhe tek Neni 215 i Ligjit Penal të Republikë së Maqedonisë pika 5 e këtij ligji parasheh një lloj bashkëpunimi ndërmjet autorit apo bashkëpuntorit dhe drejtësis ose organeve të policisë kundrejt një shpërblimi qëështë lirija nëse ai rrezikon të dënohet. Meqë kjo problematik është teje e ndjeshme, edhe Ligji tregohet i kujdesshëm se kur mund të ket njëbashkëpunim , ndaj dhe është shumë decit ku thotë që bashkpunim mund të ketë vetëm nëse KRYERSI I VEPRËS PENALE QË PARASHEH PARAGRAFI I 2 , ME PËRJASHTIM TË ORGANIZATORIT. Pra nuk mund që të mirrret Organizatori i një grupi kriminal që merren me trafikimin e drogës si një Bshkëpuntor i drejtësis, nga vetë fakti se organizatori mund të ketë qëllime të dyshimta edhe sa i përket "informacionet" që do i japë organeve të drejtësisë. Se saështë i zbatueshëm ky Nen i këtij ligji mbetet për tu diskutuar.

4. Klasifikimi dhe kontrollimi i drogave narkotike , substanvace psikotrope dhe substancave bimore.

Sipas Ligjit për Kontrollim të drogave narkotike dhe substancave psikotrope, bëhet një kategorizim si mëposhtë :

Neni 21

Listat e drogave narkotike, dhe substancave psikotrope

Listat e barnave narkotike, substancave psikotrope dhe bimëve nga të cilat mund të merren barëra narkotike (në tekstin e mëtejmë: listat) janë listat e substancave dhe preparateve të klasifikuara në Listat I, II, III dhe IV të Konventave Ndërkombëtare për Kontrollin e Narkotikëve në Varësi masat e kontrollit të aplikuara për to. Listat nga paragrafi 1 i këtij neni e parashtron Ministria e Shëndetsis.

Përveç përmbajtjes së paragrafit 1 të këtij neni, listat mund të përmbajnë ndonjë substancë dhe ose fabrikë tjetër që Ministri i Shëndetësisë, me propozimin e Komisionit Ndërministror, vlerëson vlefshmërinë e arsyeve për klasifikimin e vullnetarëve. Listat nga paragrafi 1 i këtij neni publikohen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Neni 22

Klasifikimi i listave

Tek Lista 1 klasifikohen substancat dhe bimët narkotike të ndaluara.

Lista 2 klasifikohen substancat dhe bimët narkotike që i nënshtrohen kontrollit të rreptë.

Lista e 3 klasifikohen substancat dhe bimët të cilat i nënshtrohen kontrollit.

Lista 4 klasifikon prekursorët sipas rregullave pararendës.

Përzierjet e ngurta ose të lëngëta që përmbajnë një ose më shumë substanca të kontrolluara dhe substanca psikotrope që ndahen në doza individuale do të konsiderohen si preparate dhe do t'i nënshtrohen kontrollit të kushteve që ato përmbajnë.Përgatitjet dhe përmbajtja e substrateve II dhe III futen në përputhje me rregulloret për produktet medicinale, duke ndjekur testet laboratorike (farmako-kimike) të kryera në një institucion që kryen aktivitetet e Laboratorit Kombëtar për testimin dhe kontrollin e cilësisë së gjendjes shëndetësore të autorizuar nga Ministria e Shëndetësis.

Neni 25

Kontrolli i drogave narkotike, substancave psikotrpe dhe klasifikimi i Listave 2 dhe 3.

Ndalohet kultivimi, prodhimit dhe tregtisë e substancave dhe bimëve të klasifikuara në listat II dhe III dhe përgatitjet e tyre për çdo person juridik e cila nuk ka leje për të kryer aktivitetin dhe ose të pajisjeve dhe objekteve që nuk janë miratuar në mënyrë specifike për këtë qëllim, përveç mjekësore ose kërkime shkencore, ose në mjekësinë ligjore, sipas udhëzimi që përcaktohet me ligj. Ndalohet posedimi dhe përdorimi i substancave dhe bimëve të klasifikuara në Listat II dhe III, si dhe përgatitjet e tyre pa lejen e lëshuar në pajtim me këtë ligj ose ligj tjetër.[85]

[85]" Ligji për kontroll të drogave narkotike dhe substancave psikotrope", nr 07-3399/1, Shkup 01.08.2008.

KONKLUZIONET

Fenomeni i drogës është një problem global botëror, serioz dhe kompleks. Përveç ndryshimeve të shumta kulturore, sociale, ekonomike dhe të tjera, njerëzit në mbarë botën kanë më shumë ose më pak interesa të njëjta ose identike dhe njëlloj kanë qasje në informacione të ndryshme që i bëjnë drogat më të kapshme. Sidomos pasojat e ndjeshme negative të përdorimit të drogës janë vendet me sisteme institucionale jo të besueshme ekonomike dhe të dobëta, apo vende në të cilat ngjarjet politike janë të paqëndrueshmëria ose konfliktet e brendshme apo rajonale kontribojnë duke dobësuar strukturat e kontrollit shtetëror. Në to, problemi i drogës seriozisht ndikon negativisht në shëndetin dhe strukturën sociale. Problemet e shkaktuara nga prodhimi, tregtia dhe përdorimi i paautorizuar i substancave psikotrope dhe prekursorëve duhet të shihet në kontekstin e zhvillimit bashkëkohor ekonomik, social dhe politik. Ndryshimet në sektorin bankar dhe proceset e privatizimit të firmave shtetërore kontribuojnë në faktin se sistemet ekonomike të shumë vendeve janë të pamjaftueshme për të luftuar organizatat kriminale.

Organizatat kriminale përdorin mundësitë që u ofrohen atyre me globalizimin e ekonomisë së tregut dhe intensifikojnë aktivitetet e tyre, duke përfshirë edhe ato të prodhimit të drogës dhe trafiku i drogës e bëjnë drogën më të arritshme, veçanërisht në shtetet si Republika e Maqedonisë ku kontrolli social është i pamjaftueshëm dhe ku ndryshimet e shpejta në shoqëri dhe në sistemet socio-ekonomike janë bërë faktorë shtesë të rrezikut.Në vetvete, asnjë vend nuk mund të jetë plotësisht efektiv në trajtimin e problemeve të lidhura me drogën, dhe kjo është arsyeja pse është e nevojshme legjislacion i kuptueshëm dhe i qëndrueshëm si dhe politika të shëndosha kundrejt fenomenit të drogës, si dhe bashkëpunimi midis tre shtyllave të shoqërisë: shtetërorit, shoqëris civile dhe asaj private, si dhe aktivitete të koordinuara, rajonale dhe ndërkombëtare dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Bazuar në Sondazhet e realizuara mbi përdorimin e lëndëve narkotike nga të rinjtë e moshës shkollore, sondazh i realizuar nga Projekti Evropian mbi përdorimin e Alkoholit dhe Drogave, i cili sondazh është realizuar dy herë në Republikën e Maqedonisë në 22 qytete të ndryshme dhe atë njëher në vitn 1999 dhe njëherë në vitin 2008.Nga ky sondazh mund të përfundohet se : përdorimi i Marihuanës është njëjtjë pothujase që nga viti i 1999, fakt ky që mendoj se është pozitiv për Republikën e

Maqedonisëduke pasur parasysh trendin në rritje të përdorimit të lëndëve narkotike e vecanërisht Marihuanës. Në përgjithësi, nxënësit meshkuj janë përdorues më shumë se sa femrat, por kjo nuk përjashton dhe rritjen e numrit dhe tek femrat në përdorimin e lëndëve narkotike. Përvojën e tyre të parë të konsumimit të lëndëve narkotike nxënësit e kanë pasur në moshën 14 dhe 15 vjecare. Sipas këtyre të dhënave mund të përfundohet se të rinjtë në Republikën e Maqedonisë njihen ose kanë akses relativisht të lehtë deri tek lëndët e ndryshme narkotike. Mendojqë situata të mbahet në kontroll ose të përmisohet sa i përket aksesit që kanë të rinjtë tek lëndët narkotike, duhet që institucionet arsimore përkatëse, në bashkëpunim me organet policore ose instancat e tjera, të kenë kontroll më të rreptë ndaj personave të pautorizuar që mund ti afrohen oborrit të shkollës. Konsideroj seprogramet për uljen e dëmeve nga përdorimi i drogave për Republikën e Maqedonisëështë teje i rëndësishëm. Mendoj sekëto llojë programe duhet të vazhdojnë të funksionojnë më formacion të plotë dhe me mbështetje financiare nga buxheti shtetëror. Ky konstatim vjenë pas vështrimit të fakteve dhe shifrave ku në 10 vitet e fundit periudhë kjo kur janë hapur më shumë qendra të programit për uljen e dëmeve nga keqpërdorimi i drogave, vetëm 4 raste janë evidentuar që kanë fituar virusin HIV në Republikën e Maqedonisë nga injektimi i drogave të ndryshme. Rekomandoj që duhet patjetër Republika e Maqedonisë të planifikoj dhe garantoj, në buxhetin vjetor mjete financiare për vazhdimin e punës të këtyre programeve. Vlersoj se këto lloj programe arsyetojnë mjetet e shpenzuara duke ndihmuar qindra familje me pjestar të varur nga lëndët narkotike, dhe duke shpëtuar qindra jetë njerëzish. Vdekshmëria nga përdorimi i lëndëve narkotike sipas të dhënave nga pikat qëndrore kombëtare tregojnë se ka një ndryshim, ku shihet një rritje e numrit të vdekjeve të lidhura me drogën tek gjinia femërore në vitet e fundit. Nga kjo mund të përfundohet se në Republikën e Maqedonisë lëndët narkotike po fitojnë për cdo ditëmë shumë teren edhe tek pjesa femërore e shoqërisë, si pasjoë e globalizimit, kulturës, mënyrës së jetesës në familje dhe jashtë sajë, vlersoj se të gjithë këto faktor ndikojnë si në përkeqësim ashtu dhe në përmisim të situatës. Rekomadoj se për ta pasur sa më pak vdekje nga lëndët narkotike, sidomos tek gjinia femërore duhet që shoqëria tu japë rëndësi të barabartë dhe femrave, vlersoj se sa më shumë të jetë barra e përgjegjësis aq më pak rritet indeksi i paraqitjes të sjelljeve devijuese, sidomos tek femrat. Problemet shëndetësore dhe ato sociale që janë të lidhura me

varësinë nga substancat narkotike, trajtimit psikologjik të personave në Republikën e Maqedonisëështë e garantuar me ligj. Konsideroj se, edhe pse Republika e Maqedonisëështë firmëtare e konventave evropiane dhe ato ndërkombëtare në lidhje me të drejtën për mjekim të personave të varur nga lëndët narkotike, ekzistojnë pengesa të shumta që pothuajse pamundësojnë realizimin e kësaj të drejte. Në lidhje me këtë problematik mund të përfundohet se: mospërshtaja e orarit të punës të qendrave spitalore qëofrojnë këtë shërbim, pozicioni gjeografik i këtyre qendrave, ku janë largë shumicës së pacientëve që kanë nevojë, hapsirat ku jepet terapia farmaeologjike nuk plotsojnë kushtet minimale të higienës dhe diskrecionit, personeli jo profesional etj. U mor vesh pas gjithë këtyre problemeve të pasqyruara nëpërmjet anketimeve, studimeve dhe vrojtimeve nga afër, konsideroj se Republika e Maqedonisë ka probleme serioze në këtë fushë, vlersoj që nuk është e rëndësishme vetëm frimosja apo ratifikimi i konventave të ndryshme ndërkombëtare për këtë fenomen, por më se e rëndësishme është vet aplikimi në teren e asaj që përmbajnë ato konventa si detyrim apo obligim për shtetin antar.U morë vesh nga sa është thënë dhe analizuar më lartë se Republika e Maqedonisë duhet patjetër ta vendos theksin në dy fusha shumë të rëndësishme në luftën kundër trafikimit dhe uljes së dëmeve nga keqpërdorimi i lëndëve narkotike, dhe atë në: rishikimin e Kodit Penal sa i përket Neneve që penalizojnë keqpërdorimin e lëndëve narkotike, dhe e dyta avancimin, financimin dhe mbështetjen të pakufizuar të programeve nacionale për uljen e dëmeve nga keqpërdorimi i drogave. Ulja e dëmeve nga keqpërdorimi i drogave definohet si : politika dhe programe , ku si primare kanë ti ulin dëmet shëndetsore, sociale dhe ekonomike si pasojë e keqpërdorimit të drogave, të familjeve të tyre dhe shoqërisë. Konstatoj se në këtë drejtim Republika e Maqedonisë dhe institucionet përkatëse duhet që të përmisohen në drejtime sic vijon: Informim më i mirë, komunikim dhe edukim; mundësi për qasje të lehtë deri tek shërbimet sociale; implementimi në teren të aktiviteteve preventive etj. Sipas të dhënave zyrtare nga institucionet përkatëse të pasqyruara më lartë, për veprat penale në lidhje me drogën vërehet një rritje të numrit tërasteve të Drogës të kapur dhe të padive të ngritura pranë gjykatave përkatëse, mund të përfundohet se Reppublikës së Maqedonisë i duhet një përmisim në fushat si : edukim dhe profesionalizim i kuadros policore; përmisim të bashkëpunimit ndërmjet policisë dhe qytetarëve; përmisim të bashkëpunimiit ndërmjet

policisëdhe organeve apo institucioneve të tjera, përfshirë këtu dhe organizatat joqeveritare, dhe organet e vet qeverisjes lokale. Nga sa është shkruar dhe analizuar më lartë, mund të konstatohet se Republika e Maqedonisë nuk është vendi me statistikat më të këqija në rajon dhe më gjërë, sa i përket problematikës tëkeqpërdorimit të drogës dhe veprave penale që dalin nga ajo, mirëpo as dhe nuk mund që të krenohet me masat e ndërrmara për këtë fenomen. Prandaj vlersoj që institucionet përkatëse të Republikës të Maqedonisë duhet të jenë të udhëhequra nga një politikë e cila gjatë aplikimit në jetën reale të politikave të saja të udhëhiqet nga fjalia, më lehtëështë të parandalosh se sa të kurosh, në këtë rast nga një fenomen tejet i rrezikshëm që po i kanoset mbarë shoqërisë.

B I B L I O G R A F I A

I. TEKSTE UNIVERSITARE, PUBLIKIME, STRATEGJI, PLANE DHE RAPORTE

Ademaj Xhemail, “Metodika e hetimit të krimit“, Prishtinë 2006.

Bicaj Kadri, „Drogat, narkmania dhe kriminaliteti në botë“, Prishtinë 2010

Bicaj Kadri, „Aspekti Etiologjik i kriminalitetit“

Begeja Skënder, „Kriminalistika“ Tiranë, 1999

Begeja Skënder, „Kriminalistika“ Tiranë 1997

Dragoti Edmond, „Psiklogjia ligjore e krimit”, Tiranë, 2007

Dekov Vllatko, “Idninata na programite za namaluvane na shteti od upotreba na drogi vo R.Makedonija”, Shkup, 2015

Elezi Alketa, “Droga, një sfidë intelegjence aspektet penalo juridike”, Tiranë, 2012

EU Plan 2000-2004, EU Drugs-Strategy 2005-2012

Ferati Haxhi, „ Planifikimi i ngjarjeve me ndikim të lartë dhe masat e sigurisë”, Prishtinë, 2010

Halilovic Hariz,” E drejta policore“, Sarajevë, Prishtinë , 2007

Haziri Fatos, “ E drejta e policisë“, Prishtinë 2010

Halili Ragip, „ Kriminlogjia“, Prishtinë 2011

Halili Ragip, „ Viktimlogjia“, Prishtinë 2007

Halili Ragip, „ Penologjia“, Prishtinë 2000

Ikonomi V. „ Biometria si metodë identifikimi“ Prishtinë 2005

Instituti Shtetëror i Statistikave Nr 2.1.17.06, Shkup 2017

Jerome Mellom, “Të kuptuarit e shërbimeve informative”, Prishtinë 2006

Knezhevic-Gajdasic Slavica, Acc.dr. Ignjatova Lilijana , Paqoska Natka, “Tretmani dhe parandalimi I dëmeve nga keqpërdorimi i drogave” Shkup, 2005

Kosova Center for Security Studie & FES, “Progresi në evropianizimin e sektorit të sigurisënë Shqiperi, Kosovë dhe Maqedoni” Prishtinë 20013

Krasniqi Kolë, “ Siguria Nacionale“ Prishtinë 2010

Latifi Vesel, “ Kriminalistika”, Prishtinë, 2011

Latifi Vesel, “ Kriminalistika, Prishtinë 2008

Muratbegoviq Elmedin, „ Parandalimi i kriminalitetit” Sarajevë/Prishtinë, 2007

Maslesha Ramo, “ Teoritë dhe sistemet e sigurisë”, Prishtinë, 2008

Netkova B, Zejneli I, “ Trafikimi me njerëz, aspekte juridike”, 2007

National Report, “The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2014” National report on narcotic drugs

Programi Nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë, 2005-2015

Qendra për punë Socilae në Ohër, Ohër 20017

Repubila e Maqedonisë, Ministria e punëve të brendshme, Drejtoria për siguri publike, nr.22.4/875, „ Vlersimi I kërcënimeve nga kriminaliteti I rganizuar dhe serioz “, Shkup 2016

Strategjia Nacionale për drogën e Republikë së Maqedonisë 2014-2020, Shkup 2014

Shekuktoska Slavica, „ Ulogata na socialniot rabontik vo socialnata reintegracija na liceto so problematicnata upotreba na drogi”, Shkup

Tribunë Juridike, “Ekzekutimi I Vendimeve Penale me Burgim”, Viti 2004

Tomovski Boshko, “ Droga bolest na deneshnicata “ Shkup, 1998

United Natins Office and Drugs and Crime, “Ëorld Drug Report”, Neë York, 2016

V.Hysi, “Kriminologjia”, Tiranë 2006

Zejneli I, Kambovski V, Janicievic N, Latifi V, Sulejmanov Z, Netkova B, Milovanovic Z, Kikerekova T, “ Kriminaliteti I rganizuar-aspektet juridike”, Tetovë, 2009

Zejneli I, “Edrejta penale pjesa e posacme”, Tetovë, 2007

II. BURIME JURIDIKE

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë.

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë.

Kodi Evropian i Etikës Policore.

Ligji i Procedurës Penale të Republikës së Maqedonisë.

Ligji për kontroll të drogave narkotike dhe substancave psikotrope.

Ligji për policinë e Republikës së Maqedonisë.

Ligji për punët e brendshme.